

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programet e ciklit të dytë dhe të tretë të studimit:

Diplomë e Nivelit të Dytë (DND)

Master i Nivelit të Parë (MNP)

Master i Nivelit të Dytë (MND)

TIRANË, PRILL - MAJ 2010

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

HYRJE-----	3
MENDIMI ME SHKRIM I REKTORIT TË UNIVERSITETIT -----	4
I. Misioni dhe Objektivat -----	6
Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor-----	6
Strategjia afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për arritjen e objektivave-----	6
Plani i implementimit dhe gjendja e realizimit të strategjisë së zhvillimit-----	7
Si i ndjek UET-i ndryshimet në institucione homologe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar-----	9
Të dhëna të përgjithshme për UET-in-----	9
II. Struktura organizative e UET, njësitë përbërëse dhe menaxhimi i tij 2009 - 2010-----	12
Drejtimi dhe vendimmarrja-----	13
Stafi drejtues, akademik, mbështetës dhe administrativ për çdo njësi -----	14
III. Programet e studimit, organizimi i kurrikulave dhe kreditet -----	16
Diplomat që ofron UET në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve sipas fakulteteve -----	16
Parime të ndërtimit të programit të lëndës -----	16
Të dhëna të përgjithshme për programet e studimit -----	20
Analizë e specifikuar për çdo Program Studimi-----	29
Fakulteti Ekonomik -----	29
Fakulteti i Shkencave Sociale -----	48
Fakulteti Juridik -----	71
IV. Mësimdhënia -----	80
Organizimi dhe format e mësimdhënies: raporti midis tyre-----	80
Përdorimi i teknologjive të reja të mësimdhënies: kompjutera, mjete audiovizive etj.-----	83
V. Kërkimi shkencor -----	87
VI. Studentët -----	97
Politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve dhe pasuniversitarëve -----	97
Ngarkesa mësimore e studentëve në auditor dhe jashtë tij; sistemi i krediteve-----	99
Punimi i diplomës: kriteret, kryerja e tyre, kapaciteti i UET-it -----	99
Aktivitetet studentore -----	100
Punësimi i të diplomuarve: aksesit në tregun e punës dhe përputhja e tyre me këtë treg -----	101
Informimi i studentëve me të drejtat dhe detyrat, programet mësimore, udhëzues të kurseve të studimit etj. -----	102
Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programeve, të procesit të mësimdhënies dhe përfaqësimi i tyre në strukturat qeverisëse të UET-it -----	102
VII. Fasilitetet, burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit -----	104
VIII. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare-----	108
IX. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë -----	111
X. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun e tregun e punës -----	114
XI. Analiza SWOT-----	124

HYRJE

Universiteti Europian i Tiranës – UET është një universitet i akredituar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr, 246, datë 24/07/2009. Ky universitet e ka kaluar si procesin e vlerësimit dhe të akreditimit institucional ashtu edhe atë për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë.

Mbështetur mbi Kërkesën që Rektori, në emër të UET-it, i ka drejtuar Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë – APAAL, me Nr. 490, datë 08/03 2010, grupi i vlerësimit të brendshëm është përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të akreditimit të programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë të studimit, konkretisht MNP, DND dhe MND. Ky proces i rëndësishëm ka kaluar në disa hapa:

§ Takimi i APAAL me stafin e UET-it dhe njohja me afatet dhe detyrimet e vlerësimit.

§ Në përputhje me Udhëzimin e miratuar nga Senati, më datë 02.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe organizimit të sistemit të vlerësimit të brendshëm”, nën përgjegjësinë e Rektorit, me Urdhër të tij datë 12.03.2010 është ngritur Grupi i Vetëvlerësimit.

Në përzgjedhjen e grupit të vetëvlerësimit janë pasur parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria dhe mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit. Brenda grupit janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për çdo anëtar. Në Grupin e Vetëvlerësimit është përfshirë edhe përfaqësuesi i Këshillit Studentor.

§ Grupi i Vetëvlerësimit është trajnuar nga stafi i APAAL dhe i janë vënë në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe të punës në grup, si dhe njohja me procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.

§ Vetëvlerësimi është kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të udhëzimeve të dhëna nga APAAL. Grupi i Vetëvlerësimit ka qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësues dhe specialistë të APAAL dhe ka patur asistencën e tyre sa herë kjo ka qenë e nevojshme.

§ Produkt i këtij procesi të vetëvlerësimit është Raporti i Vetëvlerësimit, i cili është hartuar në përputhje dhe zbatim të udhëzimeve të APAAL dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e UET-it.

Gjatë procesit të përgatitjes së raportit, Grupi i Vetëvlerësimit ka pasur parasysh reflektimin e mendimeve dhe rekomandimeve të stafit akademik dhe atij ndihmës, si dhe të studentëve. Për mbledhjen e mendimeve të stafit dhe studentëve janë organizuar takime formale dhe joformale. Grupi i Vetëvlerësimit ka qenë i hapur ndaj mendimeve të ndryshme dhe ka përfshirë në versionin përfundimtar të raportit mendimet, sugjerimet apo komentet e argumentuara.

MENDIMI ME SHKRIM I REKTORIT TË UNIVERSITETIT

Në mendimin me shkrim të Rektorit të Universitetit European të Tiranës janë dhënë opinionet e tij personale mbi arritjet e UET-it, hapësirat ku mund të bëhen përmirësime të mëtejshme, si dhe vizionin afatgjatë të zhvillimit. Po ashtu, Rektori ka shprehur mendimin e tij rreth programeve të studimit, kurrikulave, si dhe diplomave që lëshon institucioni që ai drejton.

Universiteti European i Tiranës (UET) është hapur dhe ushtron aktivitetin e tij në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 636, datë 20.09.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Private "Universiteti European i Tiranës"; VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, "Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë shkollës së lartë universitare private "Universiteti European i Tiranës" si dhe lejes së posaçme për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, të dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 74, datë 21.1.2009, "Për hapjen e hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë në Shkollën e Lartë Universitare Private "Universiteti Evropian i Tiranës" dhe programet e ciklit të tretë me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 796, datë 22.07.2009.

UET-i është ndërtuar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e "Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", detyrimeve të procesit të Bolonjës dhe sfidave të garantimit të cilësisë në çdo hallkë e aktivitet të tij. UET-i e zhvillon aktivitetin e tij duke u mbështetur në strategjinë e tij të zhvillimit, synimet kryesore të së cilës janë : (1) garantimi i funksionimit të sistemit në përputhje të plotë me «Procesin e Bolonjës» dhe kërkesat e ligjit «Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë», (2) ofrimi i programeve në të tri ciklet e studimit, së bashku me diplomat përkatëse (DNP, DND, MNP, MND, Doktoraturë); (3) konsolidimi i personelit akademik të brendshëm dhe atij ndihmës me pedagogë me tituj dhe grada shkencore; (4) konsolidimi i strukturave pedagogjike, kërkimore-shkencore e administrative; (5) krijimi i kushteve dhe shërbimeve sa më të plota e cilësore për studentët dhe stafin akademik.

Aktualisht, UET-i përbëhet nga tre fakultete dhe konkretisht: Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik në të cilët studiojnë 2954 studentë, shifër kjo 17 herë më e lartë se numri i studentëve në vitin e parë të hapjes së universitetit. UET-i ka 150 pedagogë nga të cilët 95 të brendshëm dhe 55 të jashtëm të ndihmuar nga 41 punonjës të strukturave administrative, ekip që garanton një funksionim mjaft cilësor të institucionit. UET-i ofron 6 programe studimi të ciklit të parë (DNP) dhe 7 programe studimi (të ndarë në 16 profile) të ciklit të dytë (DND) dhe 7 programe Master të nivelit të parë (MNP), të ndarë në 18 profile, dhe 9 programe, me katër profile secili, programe të ciklit të tretë (MND).

Qëllimi kryesor i UET-it është realizimi i një procesi mësimdhënës sa më efektiv duke synuar transmetimin tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor, për t'i bërë ndër të tjera, të diplomuar cilësorë sa më të përshtatur e të kërkuar në tregun e punës. Në funksion të këtij qëllimi, UET-i i kushton një vëmendje të veçantë edhe aftësisë të pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor e botues, si dhe përfshirjen sa më të gjerë të studentëve në këtë proces. Kërkesat ndaj stafit akademik në raport me kualifikimin akademiko-pedagogjik të tyre janë maksimale, ndërkohë që edhe vetë UET-i zhvillon një proces të kualifikimit të vazhdueshëm me stafin akademik dhe atë ndihmës.

Politika e vendim-marrjes në UET është në përputhje me respektimin e të drejtave dhe detyrave të miratuara të të gjithë organeve përbërëse të tij. Procesi plotësimit të strukturave është zhvilluar në një dinamikë intensive, sidomos gjatë dy viteve të fundit, duke arritur që aktualisht UET-i të jetë i kompletuar

në këtë drejtim. Detyrat, të drejtat, fushat e kompetencës dhe mënyrat e funksionimit të organeve vendim-marrëse janë të përcaktuara e miratuara konform kërkesave të “Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore, rregulloreve e udhëzimeve specifike të MASH-it, si dhe statutit, rregulloreve dhe udhëzimeve të veçanta të universitetit. Politikën kryesore të zhvillimit dhe rekomandimet me karakter strategjik i realizon Bordi i Besimit, si organi bazë këshillues i UET-it.

Drejtimi i institucionit dhe vendim-marrja realizohet nga organet drejtuese të tij si: Senati Akademik, Rektorati, Këshillat e Fakulteteve, Këshilli i Etikës, dhe autoritetet drejtuese si Rektori, Zëvendësrektorët, Sekretari i Përgjithshëm, Dekanët, Përgjegjësit e departamenteve dhe Qendrave të kërkimit shkencor. Për sa i përket kërkimit shkencor, vendim-marrja realizohet nga drejtorët e Instituteve të kërkimit dhe përgjegjësit e Qendrave të Kërkimit.

Raporti i vetëvlerësimit mendoj se shpreh në mënyrë të detajuar e reale situatën, ecurinë dhe problematikën e funksionimit të UET-it, me fokus programet e studimit DND, MNP dhe MND. Aty analizohen dhe jepen me detaje të gjitha aspektet akademike, ligjore e organizative, duke filluar nga strategjia e objektivat e UET-it, duke vazhduar me problematikën e përditshme të funksionimit të të gjithë hallkave e strukturave të tij, ecurinë dhe dinamikën gjatë katër viteve të ekzistencës së tij. Në raport janë pasqyruar me vërtetësi si anët pozitive të funksionimit dhe ecurisë së veprimtarisë së UET-it ashtu dhe dobësitë e sfidat kryesore për të ardhmen, duke e bërë atë një dokument real e mjaft të vlefshëm për të gjykuar e vlerësuar stadin aktual të tij, cilësinë dhe dinamikën e ndryshimeve gjatë kësaj periudhe 4 vjeçare të ekzistencës së tij, si dhe mbi të gjitha, evidentimin e dobësive, duke propozuar dhe masat përkatëse për rregullimin e shpejtë e përfundimtar të tyre.

REKTORI

Prof. Asoc. Dr. Adrian CIVICI

I. Misioni dhe Objektivat

Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor

Qëllimi themelor i UET-it *në fushën e mësimdhënies* është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik ose praktik, duke realizuar ciklin «informacion-njohuri-dije-aftësi». Pra, synohet përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e marrin vendime të sakta, si dhe të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.

Ky objektiv realizohet: (1) duke përpunuar e zgjedhur programe disiplinash sa më cilësore për çdo lëndë e që zhvillohet në UET; (2) duke përdorur si literaturë bazë dhe plotësuese libra, autorë dhe shtëpi botuese nga më të spikaturat e fushës, të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar; (3) nëpërmjet zhvillimit të leksioneve dhe seminareve me metoda e forma didaktiko-pedagogjike moderne e interaktive, duke përdorur gjerësisht prezantimet problemore, analizën logjike e sasiore, analizat krahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione e seminare, debatin e improvizuar, etj.

Qëllimi kryesor *i kërkimit shkencor* është pjesëmarrja, inkurajimi dhe motivimi i pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor dhe angazhimi i tyre sa më i gjerë në botime e studime shkencore. Njësitë bazë organizojnë periodikisht konferenca shkencore (lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare), botojnë katër revista shkencore (Polis, Jus & Justicia, Economicus, "Sociological Analysis" (Studime sociologjike, në anglisht), si dhe monografi, tekste mësimore apo studime të realizuara nga pedagogët e UET-it, etj. Në UET funksionojnë gjithashtu qendra të mirëfillta kërkimore-shkencore, disa grupe kërkimore, etj.

Qëllim tjetër i punës shkencore është vënia e rezultateve të kërkimit shkencor në shërbim të studentëve dhe procesit akademik dhe angazhimi dhe përfshirja e studentëve në këtë proces duke synuar përgatitjen sa më të mirë të tyre edhe si kërkues të ardhshëm në fushën e shkencës e dijes.

Strategjia afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për arritjen e objektivave

Për realizimin e objektivave, është ndërtuar një strategji në tre nivele:

Strategjia afatshkurtër (1 – 3 vjeçare) synon: (1) konsolidimin dhe garantimin e funksionimit të gjithë sistemit në përputhje të plotë me «Procesin e Bolonjës» dhe kërkesat e ligjit «Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë», përfshirë këtu dhe udhëzimet dhe urdhëresat e veçanta të MASH-it apo Ministrive të tjera; (2) plotësimin e programeve dhe ofrimin e të tri cikleve të studimit së bashku me diplomat përkatëse (DNP, DND, MNP, MND, Doktoraturë); (3) konsolidimin e personelit akademik dhe atij ndihmës me pedagogë me tituj dhe grada shkencore të fituara në universitete prestigjioze brenda e jashtë vendit; (4) plotësimin dhe konsolidimin e gjithë strukturave pedagogjike, kërkimore-shkencore e administrative; (5) krijimin e kushteve dhe shërbimeve sa më të plota e cilësore për studentët dhe pedagogët.

Strategjia afatmesme (3 – 5 vjeçare) synon: (1) garantimin e një stafi mësimor të qëndrueshëm e cilësor në masën mbi 75% i brendshëm; shtimin e konsiderueshëm dhe përmirësimin cilësor të ambienteve mësimore dhe atyre të shërbimit për studentët dhe pedagogët; (2) realizimin e mbi 10 marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa universitete e institucione të tjera universitare ballkanike, europiane e amerikane prestigjioze dhe realizimin e një sërë aktivitetesh akademike të përbashkëta me këto institucione; (3) pjesëmarrjen në programet europiane të arsimit të lartë si Erasmus, etj., për të realizuar shkëmbimin

reciprok të studentëve e pedagogëve; (4) realizimin e një sërë botimesh akademike - shkencore e monografish nga stafi akademik dhe shtëpia botuese UET – PRESS; (5) organizimin e të paktën 2 masterave të përbashkët me departamente apo universitete evropiane, duke i shoqëruar këto me diploma të përbashkëta evropiane; (6) kompletimin i Bibliotekës së UET-it me mbi 5.000 libra në funksion të drejtimeve të diplomave, me periodikë revistash të specializuara, si dhe garantimin e përdorimit masiv nga ana e studentëve dhe pedagogëve të bibliotekave elektronike, duke vënë në dispozicion të tyre mbi 25.000 tituj specifikë; (7) studimin e mundësive për hapjen e profileve, degëve ose fakulteteve të reja, në përputhje me kërkesat e tregut dhe mundësitë financiare dhe organizative.

Strategjia afatgjatë (6 – 10 vjeçare) synon: profilizimin e universitetit dhe fakulteteve të tij në dy drejtime themelore:

(1) Universitet / fakultet i specializuar në lidhjet me biznesin dhe tregun e punës. Një universitet i këtij tipi nënkupton një profilizim më të ngushtë të diplomave në funksion të llojeve kryesore të degëve të biznesit, apo kërkesave evidente të tregut, nëpërmjet lidhjes më të ngushtë me të gjitha llojet e biznesit. Përfaqësuesit e këtyre bizneseve dhe dhomave të tregtisë do të jenë gjerësisht të përfaqësuar në Bord, Senat, dhe në bashkëpunim të ngushtë me Dekanatet dhe Departamentet e UET-it. Përfaqësuesit e bizneseve dhe shoqatave të tyre do të jenë influencues të fuqishëm në hartimin dhe përmbajtjen e programeve të një pjese të madhe disiplinash, që kanë të bëjnë direkt me funksionimin e bizneseve. Synohet që e gjithë gama e bizneseve që do të kishte marrëdhënie të ngushta me UET-in të bëhet pjesë edhe e financimeve për shërbime të ndryshme që mund të realizonte UET për këto biznese, ose të financonte lëndë apo programe speciale për studentë të seleksionuar paraprakisht nga ana e tyre për t'i punësuar në mbarim të studimeve.

(2) Universitet elitë në fushën akademike dhe shkencore. Një universitet/fakultet i këtij tipi nënkupton një orientim të dukshëm dhe të qartë në elitën akademike dhe shkencore, duke synuar përgatitje dhe diplomim të studentëve në fusha më akademike dhe shkencore. Ky universitet do t'i kushtojë rëndësi themelore formimit të studentëve cilësorë në fushën akademike dhe atë të kërkimit shkencor. Studentët/të diplomuarit e këtij universiteti do të evidentohen në tregun e punës si ekspertë cilësorë të nivelit të lartë. Financimet më të rëndësishme do të vijnë nga "porositë" për shërbime kërkimore-shkencore të institucioneve qendrore kombëtare e ndërkombëtare, si p.sh., UNDP, Banka Botërore, UNICEF, OBSH, OBT, etj.

Plani i implementimit dhe gjendja e realizimit të strategjisë së zhvillimit

Plani i implementimit të strategjisë së zhvillimit, afat-shkurtër, afat-mesëm dhe perspektiv të UET-it është ndërtuar mbi bazën e objektivave kryesore të parashikuara dhe synuara në këto strategji. Në përfundim të çdo viti kalendarik, Rektorati organizon një analizë të detajuar të ecurisë dhe shkallës së realizimit të këtyre objektivave në raport me planin, si dhe evidenton përgjegjësinë dhe detyrat e strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme jep një informacion të përmbledhur në lidhje me realizimet e objektivave deri në fund të vitit 2009¹.

¹ Analiza e realizimit të objektivave për vitin 2010 ende nuk është bërë.

Nr.	Objektivi	Periodha e parashikuar	Gjendja viti 2009	Struktura përgjegjëse
I	Strategjia afat-shkurtër (1-3 vjeçare)			
1.	Konsolidimi dhe garantimi i funksionimit të gjithë sistemit në përputhje të plotë me « Procesin e Bolonjës » dhe kërkesat e ligjit « Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë »	2007-2009	Realizuar plotësisht	Senati Rektorati
2.	Plotësimi i programeve dhe ofrimi i të tre cikleve të studimit së bashku me diplomat përkatëse (DNP, DND, MNP, MND, Doktoraturë)	2008-2010	Realizuar DNP, DND, MNP, MND	Senati Rektorati Dekanatet
3.	Konsolidimi i personelit akademik dhe atij ndihmës me pedagogë me tituj e grada shkencore të fituara në universitete prestigjioze brenda e jashtë vendit	2008-2010	Në vazhdim	Rektorati, Zyra e burimeve njerëzore
4.	Plotësimi dhe konsolidimi i gjithë strukturave pedagogjike, kërkimore-shkencore e administrative	2009-2010	Në vazhdim Realizuar mbi 90%	Rektorati, Zyra e burimeve njerëzore
5.	Krijimi i kushteve dhe shërbimeve sa më të plota e cilësore për studentët dhe pedagogët.	2008-2010	Në vazhdim Realizuar mbi 90%	Administratori Kancelari
	Strategjia afat-mesme (3-5 vjeçare)			
1.	Garantimi i një stafi mësuesor të qëndrueshëm e cilësor në masën mbi 85% i brendshëm; shtimin e përmirësimit cilësor të ambienteve mësimore dhe atyre të shërbimit për studentët dhe pedagogët;	2008-2011	Në vazhdim Realizuar mbi 80%	Rektorati, Zyra e burimeve njerëzore Dekanatet
2.	Realizimi i mbi 10 marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa universitete e institucione të tjera universitare ballkanike, evropiane e amerikane prestigjioze dhe realizimin e një sërë aktiviteteve akademike të përbashkëta me këto institucione	2008-2012	Realizuar	Zv/rektori për marrëdhëniet me jashtë
3.	Pjesëmarrje në programet evropiane të arsimit të lartë si Erasmus, etj., për të realizuar shkëmbimin reciprok të studentëve e pedagogëve	2009-2012	Vendosur kontakte Në proces	Zv/rektori për procesin mësuesor; Sekretari i Përgjithshëm Dekanatet
4.	Realizimi i një sërë botimesh akademike - shkencore e monografish nga stafi akademik dhe shtëpia botuese UET-PRESS	2008-2012	Realizuar mbi 15 botime	UET-press
5.	Organizimi i të paktën 2 masterave të përbashkëta me departamente apo universitete evropiane duke i shoqëruar këto me diploma të përbashkëta evropiane	2009-2012	Vendosur kontakte	Rektorati Dekanatet Zyra e marrëdhënieve me jashtë
6.	Kompletimi i Bibliotekës së UET-it me mbi 5 000 libra në funksion të drejtimeve të diplomave, me periodikë revistash të specializuara	2008-2011	Në proces 2300 libra	Biblioteka Dekanatet Departamentet Kancelari
7.	Garantimi i përdorimit masiv nga ana studentëve dhe pedagogëve të bibliotekave elektronike, duke vënë në dispozicion të tyre mbi 25.000 tituj specifikë	2009-2012	Në proces Questia.com Jstor.com	Biblioteka Kancelari
8.	Studimi e mundësive për hapjen e profileve, degëve ose fakulteteve të reja, në përputhje me kërkesat e tregut dhe mundësitë financiare dhe organizative	2009-2012	Në proces	Rektorati, Dekanatet Departamentet Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave
	Strategjia afat-gjatë (6-10 vjeçare)			

Nr.	Objektivi	Periodha e parashikuar	Gjendja viti 2009	Struktura përgjegjëse
1.	Universitet/fakultet i specializuar në lidhjet me biznesin dhe tregun e punës	2008-2014		Rektorati, Dekanatet Zyra e Karrierës Bordet e Tregut të Punës
2.	Universitet elitë në fushën akademike dhe shkencore	2008-2014		Bordi i Besimit Senati Rektorati Dekanatet

Si i ndjek UET-i ndryshimet në institucione homologe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

UET ndjek me vëmendje e kujdes parësor zhvillimet institucionale, ligjore dhe të zhvillimit në universitetet dhe institucionet arsimore analoge shqiptare, ato të trevave shqiptare në rajon si dhe në universitetet europiane dhe ndërkombëtare.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është përditësimi me zhvillimet pozitive e arritjet e homologëve tanë shqiptarë e të huaj në fushën e përmirësimit të programeve e kurrikulave, metodave të mësimdhënies, kërkimit shkencor, organizimit institucional, botimeve, përshtatjen me tregun e punës, etj.

Ky proces zhvillohet nëpërmjet: (i) pjesëmarrjes në shoqatën e universiteteve të gjithë hapësirës shqiptare në rajon dhe organizimit të rregullt të takimeve dhe aktiviteteve reciproke me to; (ii) pjesëmarrjes aktive në Konferencën e Rektorëve të universiteteve shqiptare, duke synuar një shkëmbim sa më efektiv të eksperiencës dhe zhvillimeve reciproke; (iii) nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe; (iv) nëpërmjet një informacioni të rregullt nga faqet e internetit të universiteteve homologe shqiptare apo të huaja në lidhje me zhvillimet më të fundit të tyre; (v) nëpërmjet ndjekjes dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare e ndërkombëtare mbi problematikën dhe zhvillimin e arsimit të lartë; (vi) nëpërmjet analizës dhe studimit të kujdesshëm të raporteve ndërkombëtare mbi analizat krahasuese dhe zhvillimet në arsimin e lartë në botë, të përgatitura periodikisht nga OECD, Banka Botërore, BE, SHBA, Organizata e frankonisë, etj.; (vii) nëpërmjet abonimit në disa revista e periodikë që trajtojnë çështjet e universiteteve dhe arsimit të lartë në përgjithësi; (viii) nëpërmjet blerjes dhe studimit të hollësishëm të dokumenteve e botimeve specifike mbi ecurinë dhe problematikën e procesit të Bolonjës, reformave në sistemin arsimor europian dhe amerikan, etj.

UET ka qenë dhe vazhdon të jetë aktor i rëndësishëm në procesin e diskutimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor të arsimit të lartë në Shqipëri, pasqyrimin më të mirë të Procesit të Bolonjës në kushtet e vendit tonë dhe në disa raste i ka iniciuar këto debate e procese përmirësuese.

Të dhëna të përgjithshme për UET-in

Ideja për krijimin e Universitetit Europian të Tiranës u ngjiz disa vjet më parë nga një grup pedagogësh. Strukturat e para akademike morën formë të qartë që në fund të vitit 2005. UET-i fillimisht mori licencën si shkollë e lartë për hapjen e Fakultetit Juridik dhe atë të Shkencave Sociale në shtator 2006 dhe filloi veprimtarinë e tij me një numër relativisht të vogël studentësh. Në vitin e tij të dytë UET-i arriti të përshtatë ambicet e zhvillimit me infrastrukturën e nevojshme, si dhe duke plotësuar dhe përmirësuar burimet e tij njerëzore me staf akademik të diplomuar kryesisht në universitete perëndimore. Licencimi i Fakultetit Ekonomik në vitin akademik 2007 – 2008, plotësoi objektivat fillestare për orientimin e studimeve të ofruara. Marrja e licencave fillimisht për studimet e nivelit Master të Nivelit të Parë dhe ato të Diplomës së Nivelit të Dytë në vitin akademik 2008 – 2009 dhe pak më vonë për studimet e nivelit Master i Nivelit të Dytë, i ka dhënë një përmasë të re dhe të rëndësishme strukturimit dhe koherencës së studimeve në UET.

Numri i studentëve në të gjitha ciklet aktualisht është rreth 17 herë më i lartë se ai i vitit të parë. Paralelisht me të është rritur edhe numri i stafit akademik të brendshëm dhe atij administrativ, ndërsa është ulur numri i stafit akademik të jashtëm. Ndërkohë, në veprimtaritë shkencore (dhe jo vetëm) të UET-it angazhohen edhe shumë studentë nga universitete të tjera private e publike, sidomos në konferencat, debatet shkencore dhe tryezat e rrumbullakëta teorike.

Statusi i UET-it në kuadrin kombëtar

Shkolla e Lartë Universitare Private "Universiteti European i Tiranës" është një shkollë e lartë private e nivelit universitar, e krijuar në bazë të Ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i shfuqizuar me Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 22.03.2001, "Për shkollat private në Republikën e Shqipërisë"; lejes së posaçme për hapjen e kësaj shkolle, të dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 636, datë 20.09.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Private "Universiteti European i Tiranës"; VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, "Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë shkollës së lartë universitare private "Universiteti European i Tiranës" dhe lejes së posaçme për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, të dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 74, datë 21.1.2009, "Për hapjen e hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë në Shkollën e Lartë Universitare Private "Universiteti European i Tiranës"; dhe të ciklit të tretë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 22.07.2009.

Shkolla e Lartë Universitare Private "Universiteti European i Tiranës" është person juridik i njohur me Vendimin Nr. 36117, Datë 07.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me Vendimin Nr. 36117/1, Datë 05.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm, Nr. 36117/2, Datë 05.07.2007.

Shkolla ushtron një veprimtari të pavarur ekonomike, e cila rregullohet nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Numri i punonjësve: mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ

Në vitin akademik 2009 – 2010 janë angazhuar në mësimdhënie 150 pedagogë nga të cilët 95 të brendshëm dhe 55 të jashtëm. Nga anëtarët e stafit akademik të brendshëm, 24 janë staf i Fakultetit Juridik, 34 i Fakultetit të Shkencave Sociale dhe 37 i Fakultetit Ekonomik. Sa i takon nivelit të kualifikimit të tyre, 9 janë me titullin Prof. Dr., 11 me titullin Prof. Asoc., 30 me gradën Doktor, dhe të tjerët me Master. Personeli administrativ i punësuar në UET në vitin akademik 2009 – 2010 ka arritur në 41.

Numri i studentëve

Tabela më poshtë tregon totalin e numrit të studentëve të regjistruar sipas vitit akademik dhe Fakultetit. Me një numër modest studentësh (175) në vitin e tij të parë akademik 2006-2007, UET-i sot numëron 2 954 studentë në të gjitha ciklet dhe programet e studimit.

Fakulteti	Viti akademik				Totali
	2006-2007	2007-2008	2008-2009	2009-2010	
Fakulteti Juridik	61	179	177	356	773
Fakulteti i Shkencave Sociale	114	161	181	259	715
Ekonomik	-	74	407	985	1 466
TOTALI	175	414	765	1600	2 954

Numri i kurseve në Diplomën ciklin e parë të studimeve (DNP)

Universiteti European i Tiranës, në bazë të VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, ofron këto programe studimi të ciklit të parë, Diplomë e Nivelit të Parë (DNP):

1. DNP “Jurist i përgjithshëm,” ose i shoqëruar me profilet:
 - a. Juridik biznesi
 - b. Juridik, e drejta publike dhe kushtetuese
 - c. Juridik, e drejta europiane dhe ndërkombëtare
2. DNP “Komunikim – Marrëdhënie publike”
3. DNP “Shkenca politike”
4. DNP “Marrëdhënie ndërkombëtare”

Në bazë të VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, ofrohen këto programe studimi:

5. DNP “Ekonomik” (nuk është aktivizuar)
6. DNP “Financë Bankë”
7. DNP “Menaxhim Biznesi”
8. DNP “Administrim publik.” (nuk është aktivizuar)

Të gjitha këto programe studimi ofrohen me kohë të plotë; me kohëzgjatje normale 3 vite akademike; dhe realizohen me së paku 180 ECTS.

Numri i kurseve në ciklin e dytë të studimeve (MNP & DND)

Universiteti European i Tiranës, bazuar në VKM Nr. 74, datë 21.01.2009, ofron programe studimi: 7 programe Diplomë e Nivelit të Dytë, nga të cilat 2 ofrohen nga Fakulteti Ekonomik, 3 nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe 2 nga Fakulteti Juridik. Këto programe ofrohen me kohë të plotë; kanë kohëzgjatje normale 2 vite akademike; dhe realizohen me së paku 120 ECTS. Gjithashtu UET-i me të njëjtën VKM u licencua për hapjen e 9 programeve Master i Nivelit të Parë, 3 në Fakultetin Juridik, 5 në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe 1 në Fakultetin Juridik. Nga këto programe nuk janë aktivizuar vetëm 2 programe të Fakultetit të Shkencave Sociale, e konkretisht programet MNP në Gazetari dhe ai në Studime Europiane. Programet MNP ofrohen me kohë të plotë; kanë kohëzgjatje normale 1 vit akademik; dhe realizohen me së paku 60 ECTS.

Numri i kurseve në ciklin e tretë të studimeve (MND)

Universiteti European i Tiranës, bazuar në VKM Nr. 796 datë 22/07/2009, ofron 9 programe studimi Master i Nivelit të Dytë, nga të cilat 3 ofrohen nga Fakulteti Ekonomik, 4 nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe 2 nga Fakulteti Juridik. Programet MND ofrohen me kohë të plotë; kanë kohëzgjatje normale 1 vit akademik; dhe realizohen me së paku 60 ECTS.


Vendi i UET-it në kuadrin e shkollave të larta kombëtare

Megjithëse për shkollat e larta në Republikën e Shqipërisë nuk ka një sistem renditjeje, ne synojmë përfshirjen e UET-it ndër shkollat e larta elitare në vend.

Dokumentacioni përkatës:

1. Dosja e trajnimit të APAAL;
2. Urdhri i Rectorit për ngritjen dhe përbërjen e Grupit të Vetëvlerësimit;
3. Udhëzimi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë;
4. Tabela e burimeve njerëzore.

II. Struktura organizative e UET, njësiti përbërëse dhe menaxhimi i tij 2009 - 2010



Drejtimi dhe vendimmarrja

Drejtimi dhe vendim-marrja në UET zhvillohen në përputhje të plotë me respektimin e të drejtave dhe detyrave të miratuara të organeve përbërëse. Të gjitha detyrat, të drejtat, fushat e kompetencës dhe mënyrat e funksionimit të organeve vendim-marrëse janë të përcaktuara qartë e të miratuara në funksion e sipas kërkesave të "Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", akteve nënligjore, rregulloreve e udhëzimeve specifike të MASH-it, statutit, rregulloreve dhe udhëzimeve të veçanta të UET-it, etj.

Politikën kryesore të zhvillimit dhe rekomandimet me karakter strategjik i realizon Bordi i Besimit, si organi bazë këshillues i UET-it.

Drejtimi dhe vendim-marrja realizohet tërësisht nga organet drejtuese të tij si: Senati Akademik, Rektorati, Këshillat e Fakulteteve, Këshilli i Etikës, dhe autoritetet drejtuese si Rektori, Dekanët dhe Përgjegjësit e departamenteve. Për sa i përket kërkimit shkencor, vendim-marrja realizohet duke ndjekur linjën Departament/Qendër – Fakultet – Bordi për financimin veprimtarive shkencore.

Vendimet për funksionimin dhe drejtimin e UET-it në aspektin akademik dhe shkencor merren nga autoritetet dhe organet drejtuese të tij. Administratori i Shoqërisë "U.E.T." shpik gëzon të drejtën e informimit në lidhje me këto vendime. Për vendimet e organeve drejtuese të UET-it me pasoja financiare ose që përfaqësojnë devijim nga misioni, parimet dhe filozofia e UET-it, nevojitet në çdo rast edhe miratimi i Asamblesë së Ortakëve.

Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet

Organet e zgjedhura dhe të emëruara ndërtohen dhe funksionojnë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, aktet nënligjore dhe Statutin e UET-it. Ato ndahen në organe këshilluese, drejtuese, autoritete drejtuese, si dhe autoritete të tjerë. Organe këshilluese janë Bordi i Besimit, Bordet e Tregut të Punës dhe Këshilli i Etikës, organe drejtuese janë Senati Akademik, Rektorati, Këshillat e fakultetit; ndërsa autoritetet drejtuese janë Rektori, Dekanët, Përgjegjësit e Departamenteve dhe të Qendrave kërkimore. Në UET ka dhe autoritete të tjerë si Zëvendësrektorët, Kancelari dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Fakultetet, departamentet, seksionet

Universiteti European i Tiranës është i organizuar në 3 Fakultete, 10 departamente dhe 3 qendra kërkimi, si më poshtë:

1. Fakulteti Juridik
 - a. Departamenti i së Drejtës Private
 - b. Departamenti i së Drejtës Publike
 - c. Qendra e kërkimit "Ligji, Tradita, Norma"
2. Fakulteti i Shkencave Sociale
 - a. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit
 - b. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
 - c. Departamenti i Psikologjisë, Sociologjisë dhe Antropologjisë
 - d. Departamenti i Shkencave të Edukimit
 - e. Qendra Ndërdisciplinore e kërkimeve
3. Fakulteti Ekonomik
 - a. Departamenti i Ekonomisë
 - b. Departamenti i Financës
 - c. Departamenti i Menaxhimit, Administrimit dhe Marketingut
 - d. Departamenti i Matematikës, Statistikës dhe Informatikës
 - e. Qendra e kërkimit "Zhvillimi dhe inovacioni"

Stafi drejtues, akademik, mbështetës dhe administrativ për çdo njësi

Sot UET-i përbëhet nga 3 fakultete, 10 departamente dhe 3 qendra kërkimi. Personeli drejtues aktualisht përbëhet nga Rektori, 3 Zëvendësrektorë, 3 Dekanë, Administratori, Kancelari, Sekretari i Përgjithshëm, 10 Përgjegjës Departamentesh dhe 3 Përgjegjës Qendrash.

Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për çdo njësi

UET-i i ka kushtuar rëndësi të veçantë cilësisë së stafit drejtues mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ. Synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve/klientëve nga të gjitha njësitë përbërëse. Kujdesi fillon me procesin e përzgjedhjes dhe rekrutimit të stafit drejtues mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ. Ndër kriteret bazë të rekrutimit të personelit akademik që zbatohen janë (i) eksperiencia në mësimdhënien universitare, (ii) grada e titulli shkencor i kandidatit për pedagog dhe (iii) aktiviteti kërkimor shkencor e botues i tij.

Në këtë drejtim, është pasur parasysh që stafi drejtues dhe mësimdhënës të plotësojë kriteret e duhura, të karakterizohet nga profesionalizmi dhe të ketë edhe aftësi drejtuese dhe menaxhuese. Stafi drejtues përbëhet nga pedagogë të njohur dhe me eksperiencë, me tituj dhe grada shkencore.

Përbërja e personelit akademik tregon për një angazhim të një stafi të kualifikuar, me eksperiencë veçanërisht në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, si dhe për aktivizimin e pedagogëve të rinj në proces kualifikimi shkencor dhe ngritje profesionale akademike.

Për lehtësimin e koordinimit të punës mes departamenteve, si dhe të departamenteve me dekanin, pranë çdo fakulteti është ngritur edhe pozicioni i koordinatorit të fakultetit. Koordinatori ndihmon dhe mbështet dekanatin në procesin akademik dhe mësimdhënës, si dhe kryen detyra administrative dhe shërbime për studentët e Fakultetit. Në mbështetje të punës së fakulteteve është edhe sekretaria mësimore, ku punët e çdo fakulteti mbulohen nga një sekretare e veçantë. Stafi administrativ në shërbim të njëjësive kryesore dhe bazë është me shkollë të lartë.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontrata e punës me stafin drejtues dhe akademik lidhet nga Administratori, në cilësinë e punëdhënësit dhe miratohet nga dekan i fakultetit përkatës, në funksion të vlerësimit akademik, ose nga Rektori në rastin e kontratës së dekanit dhe drejtorit të instituteve.

Kontrata e punës me personelin mbështetës dhe administrativ lidhet nga Administratori.

Kontrata e punës për gjithë personelin lidhet dhe zgjidhet sipas klauzolave të kontratës, anekseve të saj, si dhe legjislacionit të punës.

Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm përzgjidhen me konkurs në përputhje me kriteret specifike të kualifikimit dhe performancës të publikuara gjatë fazës së konkurrimit.

Kandidati i përzgjedhur merret fillimisht me kontratë pune 1-vjeçare; kontrata nënshkruhet nga Administratori dhe i punësuari, pasi kryhet dhe firmoset një deklaratë vlerësimi akademik nga Dekani ose nga Rektori në rastin e kontratës së dekanëve. Pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj, punonjësit me grada shkencore mund të lidhin kontratë pune me afat ose pa afat.

Për personelin akademik me kohë të pjesshme kontrata e punës është me afat semestral, me të drejtë rinovimi.

Detyrat dhe të drejtat e stafit drejtues, mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ janë përcaktuar në Statutin, rregulloret e institucionit, Kodin e Etikës dhe Kodin e Integritetit akademik, në dokumentet mbështetëse si dhe në kontratat individuale të punës dhe anekseve të kontratave.

Baza e të dhënave, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Baza e të dhënave, si dhe arkivimi apo ruajtja e tyre funksionon bazuar në Ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", në Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave "Për punën me dokumentet administrative në organet shtetërore e joshtetërore", në aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Kompletimi dhe freskimi i vazhdueshëm i të dhënave dhe informacionit për studentët, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor apo personelin administrativ kryhen nga Zyra e Arkiv – Protokoll – Statistikës, nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kancelarit.

Dokumentacioni përkatës:

1. Dosja e dokumenteve themelore të UET-it;
2. Vendimet e Senatit për hapjen e fakulteteve, departamenteve, programeve të studimit, instituteve dhe qendrave;
3. Dosja e rekrutimeve;
4. Dosja e kontratave;
5. Regjistri i amzës;
6. Regjistri themeltar.

III. Programet e studimit, organizimi i kurrikulave dhe kreditet

Diplomat që ofron UET në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve sipas fakulteteve

Fakulteti Juridik:

Diploma të Nivelit të Dytë në: E drejtë private dhe biznesi; E drejtë publike dhe ndërkombëtare;

Diploma Master të Nivelit të Parë në: Drejtësi

Diploma Master të Nivelit të Dytë në: E drejtë private; E drejtë publike

Fakulteti i Shkencave Sociale:

Diploma të Nivelit të Dytë në: Komunikim – Marrëdhënie publike; Shkenca Politike; Marrëdhënie ndërkombëtare.

Diploma Master të Nivelit të Parë në: Gazetari; Marrëdhënie publike; Shkenca politike; Marrëdhënie ndërkombëtare – Diplomaci; Studime Europiane.

Diploma Master të Nivelit të Dytë në: Sociologji; Shkenca komunikimi; Shkenca politike; Marrëdhënie Ndërkombëtare

Fakulteti Ekonomik:

Diploma të Nivelit të Dytë në: Financë Bankë; Administrim biznesi.

Diploma Master të Nivelit të Parë në: Banka dhe sigurime; Marketing; Menaxhim dhe administrim.

Diploma Master të Nivelit të Dytë në: Ekonomi dhe zhvillim i Qëndrueshëm; Menaxhim; Financë

UET synon, në një të ardhme të afërt, hapjen e programeve të Doktoratës.

Parime të ndërtimit të programit të lëndës


Programi i lëndës hartohet në fillim të vitit akademik. Programi i lëndës mund të konsiderohet si një kontratë akademike dhe administrative mes titullarit të lëndës dhe strukturave drejtuese të UET e studentëve. Për këtë arsye programi i lëndës duhet të jetë sa më i plotë dhe të shpjegojë hollësisht përmbajtjen e kursit si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti përgjatë kursit. Më konkretisht programi i lëndës shpjegon lëndën, synimin dhe objektivat e saj, temat përkatëse si dhe literaturën.

Sistemi i ndërtimit të Programit të Lëndës (Parimi i Rrathëve)

Qëllimi i aplikimit të këtij sistemi është shmangia e të mësuarit të bazuar në sistemin e njohurive “të ndara me kate” nga njëri cikël mësimor në tjetrin, lehtësimin e përshtatjes së studentëve me lëndët, kur ata vijnë paralelisht ose nga jashtë sistemit të UET-it në njërin nga ciklet (DND, MNP, MND), plotësimi i njohurive edhe për studentët që i kufizojnë studimet në njërin nga ciklet dhe nuk vazhdojnë më tej studimet e tyre. Nivelet duhet të përfshijnë të gjithë strukturën pedagogjike dhe shkencore të lëndës: (i) Përmbajtjen e njohurive; (ii) Metodën pedagogjike; (iii) Bibliografinë dhe (iv) Kontrollin e njohurive

Për nivelin e DNP (Diplomë e Nivelit të Parë).


Në mënyrë figurative sistemi i rrathëve të prezantimit të njohurive në DNP paraqitet si më poshtë:



Shpjegimi: 70% të programit e zënë njohuritë bazë të lëndës në përputhje me objektivat e ciklit të parë; 15% të programit e zënë njohuritë e thelluara në këtë lëndë në përputhje me informacionin që duhet të jepet në ciklin e dytë; 15% e zënë njohuritë teorike, kritike e krahasuese në përputhje me informacionin e ciklit të tretë; Literatura e lëndëve ka kryesisht karakter gjithëpërfshirës.

Për nivelin e programeve të ciklit të dytë DND (Diplomë e Nivelit të Dytë) dhe MNP (Master i nivelit të Parë) :

Në mënyrë figurative sistemi i rratheve të prezantimit të njohurive në ciklin e dytë të studimeve paraqitet si më poshtë:




Shpjegimi: 15% të programit e zënë njohuritë bazë të lëndës në përputhje me objektivat e ciklit të parë; 70% të programit e zënë njohuritë e thelluara në këtë lëndë në përputhje me informacionin që duhet të jepet në ciklin e dytë; 15% e zënë njohuritë teorike, kritike e krahasuese në përputhje me informacionin e ciklit të tretë. Literatura e lëndëve përveç karakterit gjithëpërfshirës duhet të jetë veçanërisht e fokusuar në prezantimin e shkollave dhe qasjeve të ndryshme të asaj fushe.

Për nivelin e ciklit të tretë MND (Master i Nivelit të Dytë) :

Për rastin e Masterit të nivelit të dytë që ka domosdoshmërisht drejtim formimi universitar të nivelit shumë të lartë profesional, lënda zhvillohet duke e orientuar drejt formimit teoriko-praktik që çon drejt

një profesioni ose game më të gjerë profesionale me nivel shumë të lartë kualifikimi universitar dhe që njihet apo ka prirje të njihet e liçensohet nga tregu i punës lokal apo global.

Në mënyrë figurative sistemi i rrathëve të prezantimit të njohurive në MND paraqitet si më poshtë:



Shpjegim: 15% të programit e zënë njohuritë bazë të lëndës në përputhje me objektivat e ciklit të parë; 15% të programit e zënë njohuritë e thelluara në këtë lëndë në përputhje me informacionin që duhet të jepet në ciklin e dytë; 70% e zënë njohuritë teorike, kritike e krahasuese në përputhje me informacionin e ciklit të tretë (MND). Literatura e lëndëve, përveç karakterit gjithëpërfshirës dhe prezantimit të shkollave e qasjeve të ndryshme të asaj fushe, duhet të jetë veçanërisht e fokusuar në prezantimin e autorëve më në zë të fushës që studiohet.

Përsa i përket mënyrës së organizimit të lëndëve pedagogët kanë si detyrim të hartojnë Programet e lëndëve sipas formatit të propozuar në *Librin e Pedagogut*. Këto Programe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit që kujdeset për menaxhimin e tyre dhe konsultohen nga përgjegjësi i grup-lëndëve me qëllim koordinimin sa më të mirë të lëndëve brenda disiplinave të ngjashme. Në rastin e programeve MNP dhe MND këto programe shqyrtohen edhe nga Komiteti Shkencor i programit dhe miratohen nga Koordinatorin dhe Drejtorin e Shkollës Doktorale në rastin e programeve MND. Programi mësimor i jepet studentit që në fillim të lëndës. Ai mund të konsiderohet si një kontratë mes pedagogut dhe studentit. Për këtë arsye kërkohet të jetë i plotë dhe të shpjegojë hollësisht përmbajtjen e kursit si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti përgjatë tij. Më konkretisht programi mësimor shpjegon lëndën, synimin dhe objektivat e saj, temat që do të zhvillohen për çdo javë, të shoqëruara me literaturën përkatëse.

Cilësia e Literaturës

Literatura e përzgjedhur për programin e studimit bëhet duke u konsultuar gjërësisht me Përgjegjësit e Departamentit dhe kolegët e specializimeve të ngjashme. Çdo program lënde duhet të përmbajë të listuar literaturën bazë që i ofrohet studentit, e cila mbulon mbi 60% të temave të diskutuara gjatë lëndës. Si një ndër kriteret për përzgjedhjen e literaturës shërben përdorimi i saj në universitetet më në zë perëndimore në degë studimi të ngjashme me programin e ofruar në UET. Përveç tekstit bazë, pedagogu rekomandon dhe një ose dy tekste që janë mjaft afër fushës së analizës së tekstit bazë si dhe një mori tekstesh të rekomanduara të cilat prekin tema të ndryshme që trajtohen gjatë lëndës.

Kontrolli i cilësisë së mësimdhënies

Pjesa më e madhe e stafit akademik të angazhuar në këto programe studimi kanë marrë një eksperiencë të gjërë akademike qoftë nga përvoja e tyre profesionale, qoftë nga shkollimi në ambiente

akademike më në zë jashtë vendit. Kjo ka ndikuar në një nivel mjaft të mirë të mësimdhënies gjë e cila është vlerësuar dhe në sajë të formave të ndryshme të vlerësimit të organizuar në UET. Këtu mund të përmendim katër forma kryesore vlerësimi të stafit akademik:

- a) Vetëvlerësimi i cili siguron një panoramë të përgjithshme të pritshmërive dhe objektivave që ka vetë secili pedagog që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi;
- b) Vlerësimi nga eprorët që kryhet nëpërmjet ndjekjes në mënyrë periodike nga Përgjegjësi i Departamentit i një ore mësimore në simestër, gjatë së cilës evidentohen anët pozitive dhe pikat në të cilat kërkohet përmirësim i mëtejshëm nga ana e pedagogut për sa i përket cilësisë së mësimdhënies;
- c) Vlerësimi nga Studentët i cili kryhet në fund të çdo semestri për të matur perceptimin që studentët kanë për pedagogun e tyre të lëndës
- d) Vlerësimi nga Sekretaria e UET i cili kontrollon pedagogët për sa i përket korrektesës dhe përpikmërisë së tyre në zhvillimin e lëndëve

Gjithashtu një formë tjetër kontrolli që kryhet për të garantuar cilësinë e mësimdhënies është dhe intervista që secili pedagog kryen me Komisionin e Vlerësimit të Performancës në fund të çdo viti akademik. Në sajë të kësaj interviste arrihet të bëhet një ballafaqim i angazhimeve të ndërmarra nga pedagogu në fillim të vitit akademik dhe arritjeve të tyre në fund të këtij viti.

Mjetet didaktike që përdoren për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve

Forma më e përdorur dhe më e inkurajuar e leksioneve është ajo e tipit bashkëvepruese ku synohet më shumë diskutimi gjatë orës së leksionit sesa paraqitja në formë tradicionale e leksionit, gjatë së cilës pedagogu flet gjatë gjithë kohës. Në këtë mënyrë studentët nxiten që të vijnë të përgatitur edhe gjatë leksioneve, duke qenë se e dinë që do të pyeten të japin mendime ose t'u përgjigjen pyetjeve në çdo orë mësimi.

Nga ana tjetër seminarët kanë si qëllim kryesor të ndihmojë studentët ta përthithin dijet dhe njohuritë e përfuara gjatë leksionit si dhe për të ndihmuar pedagogun për të kuptuar ecurinë e studentëve dhe të klasës në përgjithësi në lëndën e tij/saj. Për rrjedhojë seminarët gjithashtu zhvillohen në mënyrë interaktive duke inkurajuar studentin të perdore menyra te ndryshme te te menduarit për të qenë në gjendje të:

- Të qartësojë dhe krijojë ide
- Të transferojë të nxënërit nga një fushë në një tjetër
- Të bëjë gjykime të vlefshme
- Të analizojë situata dhe të marrë vendime të arsyeshme
- Të zgjidhë probleme
- Të arsyetojë në mënyrë inteligjente
- Të formulojë dhe realizojë qëllime të caktuara.

Të gjitha këto arrihen nëpërmjet metodave të ndryshme didaktike të cilat, për të përmendur disa variojnë nga puna në grupe, loja me role, simulimet e ndryshme, konkurset, prezantimet e ideve, etj.

Kontrolli i Njohurive

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

- a. Provimit të ndërmjetëm (30%)
- b. Nivelit të diskutimit në seminare (10%)
- c. Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%)
- d. Provimit përfundimtar (40%)

Nga kontrollet që kryhen në mënyrë periodike nga komisione *ad hoc* rezulton se këto forma vlerësimi të dijeve respektohen nga i gjithë stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi.

Të dhëna të përgjithshme për programet e studimit


Programet Master i Nivelit të Parë

Këto programe realizohen nëpërmjet ofrimit të aktiviteteve të ndryshme të formimit në auditor, trajnimit, praktikës profesionale të përcaktuar në programin e studimit, në përputhje me objektivat e programit të studimit. Programi i studimit trajton kryesisht aspektin praktik të trajtimeve teorike të zhvilluara në programet bazë, ose konceptet kryesore të nevojshme për arritjen objektivave profesionale, me qëllim kualifikimin në një drejtim të ngushtë për tregun e punës. Ai parashikon edhe realizimin e një prove finale (punim diplome), e cila provon fitimin e aftësive e kompetencave profesionale, apo njohurive në atë fushë, duke integruar kështu mësimdhënien me kërkimin dhe duke siguruar zhvillimin e aftësive të studentit për punë të pavarur kërkimore.

Këto programe studimi ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale një vit akademik. Ata janë të organizuar në dy semestra. Numri i përgjithshëm i provimeve është 9, nga të cilat 6 janë disiplina të detyrueshme të përbashkëta (përfshirë praktikën profesionale dhe punimin e diplomës), 2 janë të detyrueshme specifike, dhe 1 është me zgjedhje. Çdo program studimi ofron mundësinë e profilizimit në një drejtim të ngushtë. Studenti nuk është i detyruar të profilizohet. Ai mund të marrë diplomë pa profil nëse zgjedhjen e lëndëve nuk e bën të orientuar brenda profilit, por të kombinuar midis profileve të programit të studimit. Studenti realizon së paku 1500 orë punë për fitimin e 60 krediteve dhe është i detyruar të frekuentojë 80% të të gjithë veprimtarisë mësimore në auditor (leksion, seminare, orë praktike).

Me qëllim ruajtjen e karakteristikës së tyre kryesore, atë të formimit të specialistëve të thelluar, programet MNP ofrojnë lëndë me karakter të thelluar aplikativ. Disiplinat e detyrueshme për të gjithë ofrojnë një bazë të përbashkët për studentët e të njëjtit program (24 ECTS ose 57% të krediteve teorike dhe 40% të krediteve totale të masterit). Por gjithashtu vërehet edhe rëndësia që i është dhënë profilizimit me (12 ECTS ose pothuaj 30% të lëndëve teorike dhe 20% të krediteve totale të masterit). Procesi i profilizimit për një master praktik të këtij lloji, plotësohet edhe me praktikën profesionale (8 ECTS) dhe punimin e diplomës, tema e së cilës kërkohet të jetë e një natyre empirike.

Stafi akademik i angazhuar në këto programe studimi përbëhet kryesisht nga staf i brendshëm, në masën 67% për Fakultetin Ekonomik, 76% për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe 75% për atë Juridik.



Nga 47 pedagogët e angazhuar në këto programe studimi, 11 janë angazhuar në 2 lëndë dhe vetëm 1 pedagog në 3 lëndë.

Secili program drejtohet nga Komiteti Shkencor përkatës, i cili përbëhet nga së paku 3 (tre) anëtarë të stafit akademik të brendshëm, me formim profesional më afër fushës së studimit të programit. Për

organizimin dhe administrimin e programit të studimit, Komitetet Shkencore bashkëpunojnë ngushtë me departamentet përkatëse. Komiteti Shkencor koordinon me Zyrën e Karrierës dhe Praktikave për realizimin e praktikës profesionale.

Programet Diplomë e Nivelit të Dytë (DND)


Programet DND kanë karakter të theksuar akademiko-profesional, dhe ofrojnë njohuri bazë për një karrierë të mëtejshme akademike, si dhe për formimin profesional në fushat e përcaktuara, me qëllim që të diplomuarit në këto programe të përballojnë kërkesat e tregut të punës dhe të jenë në gjendje të vazhdojnë kualifikimin e mëtejshëm shkencor në ciklin e tretë të studimeve. Ky mision realizohet nëpërmjet angazhimit të studentëve në studime të thelluara teorike dhe praktike në fushat e zgjedhura prej tyre.

Këto programe realizohen në 2 vite, të ndarë në 4 semestra, gjatë të cilit studenti fiton jo më pak se 120 kredite dhe realizon jo më pak se 3000 orë pune. Forma e studimit është me kohë të plotë. Veprimtaria mësimore si rregull realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit dhe praktikës profesionale. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm në masën 70%. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 60 minuta.

Disiplinat e ofruara në këto programe janë të organizuara në pesë kategori:

- A. Disiplina të formimit të përgjithshëm, të cilat përbëjnë 10% të programit (12 ECTS);
- B. Disiplina të formimit karakterizues të programit, e cila përbëhet nga tre grupe (48 ECTS)
 - i. lëndë të detyrueshme për të gjithë (18 ECTS)
 - ii. lëndë të detyrueshme specifike (18 ECTS)
 - iii. lëndë opsionale të përbashkëta (12 ECTS)
- C. Disiplina të ngjashme formuese të ngjashme ose integruese 10% (12 ECTS);
- D. Disiplina formuese të zgjedhura 7-8% (6 ECTS)
- E. Veprimtari formuese 10% (12 ECTS)
- F. Punimi i diplomës 10-25% (30 ECTS).

Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në këto programe studimi, për secilin Fakultet. Numri më i lartë i pedagogëve për Fakultetin e Shkencave Sociale shpjegohet me numrin e madh të lëndëve që ofron ky Fakultet duke qenë se ka aktivizuar 3 programe studimi DND. Përqindja që zë stafi akademik i jashtëm varion nga 23% për Fakultetin e Shkencave Sociale në 29% për Fakultetin Ekonomik.



Sa i takon shpërndarjes së lëndëve sipas anëtarëve të personelit akademik, vihet re se nga 58 pedagogë të angazhuar në këto programe studimi, 10 prej tyre janë angazhuar në dy lëndë, vetëm 2 në tre lëndë, ndërsa gjithë të tjerët në një lëndë të vetme.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit 2010

Programet MNP (tetor 2009- shtator 2010): Numri i studentëve, cilësia e tyre në hyrje dhe stafi mësimdhënës

N°	Emërtimi i programit të studimit	Profili	Karakteristikat e studentëve				Stafi mësimdhënës		Cilësia e studentëve***	
			n° Aplikantëve	n° pranuarve	Nota mesatare*	n° i studentëve**	I brendëshëm	I jashtëm	Kalueshmëria	Nota mesatare
	Totali për F. Ekonomik		16	16	7.5	16	18	9		7.3
1	Banke dhe Sigurime		4	4		4	8	3		
		Bankë	2	2		2				
		Sigurime	0	0		0				
		Politikat Fiskale	2	2		2				
2	Menaxhim Biznesi		10	10		10	12	5		
		Menaxhim SME-ve	6	6		6				
		Menaxhim i BNJ dhe Karrierës	4	4		4				
		Institucione & administrim publik	0	0		0				
3	Marketing		2	2		2	7	2		
		Inovacione dhe Tregje Strategjike	2	2		2				
		Marketing bankar dhe financiar	0	0		0				
		Shërbime dhe Turizëm	0	0		0				
	Totali për F. Shkenca Sociale		4	4	8.3	4	19	6		8.2
1	Marrëdhënie Publike		2	2		2	6	3		
		MP për Sektorin Komercial	1	1		1				
		MP politike dhe institucionale	1	1		1				
2	Shkenca Politike		1	1		1	11	3		
		Sjellja dhe strategjitë politike	0	0		0				
		Politika Publike	1	1		1				
3	Marrëdhënie Ndërkombëtare - Diplomaci		1	1		1	7	2		
		Çështjet e Ballkanit	0	0		0				
		Studime Amerikane	1	1		1				
	Totali për F. Juridik				0					
1	Drejtësi				0					
		E drejtë administrative			0					
		E drejtë ndërkombëtare			0					
		E drejtë Europiane			0					

UET - Raporti i Vetëvlerësimit 2010

Programet MNP (Mars 2009- Shkurt 2010): Numri i studentëve, cilësia e tyre në hyrje dhe stafi mësimdhënës

N°	Emri i programit të studimit	Karakteristikat e studentëve				Stafi mësimdhënës		Cilësia e studentëve***	
		n° Aplikantëve	n° pranuarve	Nota mesatare*	n° i studentëve**	I brendëshëm	I jashtëm	Kalueshmëria	Nota mesatare
	Totali për Ekonomik	86	75	7.56	75	18	11	98%	7.7
1	Banka dhe Sigurime	36	30	7.5	30	9	7		
2	Menaxhim Biznesi	38	33	7.4	33	10	5		
3	Marketing	12	12	7.8	12	7	4		
	Total Shkenca Sociale	48	44	7.9	44	15	7	99.50%	8.2
1	Marredhenie Publike	20	18	7.9	18	6	4		
2	Shkenca Politike	13	13	7.9	13	10	3		
3	Marredhenie Nderkombetare - Diplomaci	15	13	8	13	7	2		
	Total F. Juridik	20	18	8.58	18	6	3	100%	9.1
1	Drejtësi	20	18	8.58	18	6	3		9.1

* Nota mesatare e diplomës me të cilën janë pranuar studentët në programin mësimor përkatës

** Numri aktual i studentëve

*** Cilësia e studentëve do të plotësohet vetëm për programet mësimore në të cilat kanë përfunduar studimet të paktën një brez studentësh.

Programet DND: studentët, stafi mësimdhënës dhe cilësia në hyrje e studentëve

Emërtimi i programit			Karakteristikat e studentëve				Stafi mësimdhënës		Cilësia e studentëve***	
N°	Emri i programit të studimit	Profili	n° Aplikantëve	n° pranuarve	Nota mesatare*	n° i studentëve**	I brendëshëm	I jashtëm	Kalueshmëria	Nota mesatare
	Totali për F. Ekonomik		83	82		82	15	6		6.5
1	Financë Bankë		66	65	7.4	65	8	4		
		Ekonomi financë	58	57		57				
		Banka dhe tregjet financiare	8	8		8				
2	Administrim Biznesi		17	17	8	17	11	2		
		Biznes Marketing	12	12		12				
		Administrim Publik	5	5		5				
		Ekonomi Europiane	0	0		0				
	Totali për F. Shkencave Sociale		42	42		42	24	7		7.8
1	Komunikim – Marrëdhënie Publike		16	16	7.21	16	15	3		
		Marredhenie publike	12	12		12				
		Studime dhe teoritë e komunikimit	4	4		4				
2	Shkenca politike		10	10	8.4	10	12	3		
		Teoritë politike	9	9		9				
		Politikë e krahasuar	1	1		1				
3	Marrëdhënie Ndërkombëtare		16	16	8.4	16	12	4		
		Organizata Ndërkombëtare	5	5		5				
		Studime Strategjike	11	11		11				
	Totali për Fakultetin Juridik		58	56		56	14	5		7.2
1	E Drejte private dhe biznesi		33	33	8.3	33	11	5		
		E drejtë private	16	16		16				
		E drejtë biznesi	17	17		17				
2	E Drejte publike dhe ndërkombëtare		25	23	7.76	23	10	5		
		E drejtë publike dhe kushtetuese	14	12		12				
		E drejtë penale	9	9		9				
		E drejtë ndërkombëtare dhe europiane	2	2		2				

Programet Master i Nivelit të Dytë


Programet e studimit Master i Nivelit të Dytë ofrohen me kohë të plotë dhe kanë një kohëzgjatje normale 1 vit. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këto programe studimi janë të organizuara në 2 grupe, lëndë bazë dhe të profilit, si dhe punimi i diplomës. Disiplinat mësimore të ofruara në grupin e lëndëve bazë janë kurse të detyrueshme, dy prej tyre me karakter metodik, njëra me karakter teorik dhe tjetra me karakter aplikativ. Programi ofron 4 (katër) mundësi profilizimi. Secili profil përbëhet nga dy lëndë. Për plotësimin e krediteve studenti duhet të zgjedhë edhe një lëndë opsionale, të ofruar në profilet e tjera të programit të studimit.

Studenti merr 60 ECTS, nga të cilat 24 ECTS në kategorinë e disiplinave të formimit bazë; 12 ECTS përmes lëndëve të profilit të zgjedhur; 6 ECTS përmes zgjedhjes së lëndës opsionale të ofruar në profilet e tjera të programit të studimit dhe 18 ECTS për punimin e diplomës, nga të cilat 4 ECTS merren përmes frekuentimit të seminareve metodologjike të diplomës dhe 14 ECTS për vetë punimin. Studenti realizon jo më pak se 1500 orë punë.

Një nga veçoritë e mënyrës së organizimit të këtyre programeve është procesi i temës ose mikrotezës. Pasi studentët plotësojnë formularët përkatës me kërkesën për mikrotezën, komitetet e masterave u mbledhën për t'i shqyrtuar dhe për të përcaktuar pedagogët udhëheqës të përshtatshëm sipas fushës së ekspertizës. Duke qenë se numri i studentëve ishte i konsiderueshëm, disa pedagogë kanë marrë një numër të lartë studentësh duke u detyruar që seancat t'i ndajnë në dy grupe. Seancat metodologjike janë një komponent i rëndësishëm i mikrotezës. Pasi iu shpërnda pedagogëve dhe studentëve një program orientues për zhvillimin e këtyre seancave dhe regjistrat përkatës për monitorimin e tyre, këto seminare filluan në muajin shkurt me një periodicitet takimesh dy herë në muaj.

UET-i ka aktivizuar të 9-të programet MND. Shihet qartë se programet e Fakultetit Ekonomik kanë qenë më të kërkuarit dhe kanë numrin më të madh të studentëve. Ajo që u vu re gjatë procesit të regjistrimit ishte një paqartësi e një numri të konsiderueshëm studentësh, mbi profilin më të përshtatshëm për ta. Ndërkohë që pjesa dërrmuese e tyre ishte e sigurt për programin e zgjedhur, katër profilet që i shtroheshin si alternativë ishin shpesh jo shumë të qarta dhe jo të lidhura me interes e tyre profesionale apo akademike. Kjo lidhej shpesh me emërtimin e profilit, sesa me përmbajtjen.

Grafiku më poshtë tregon prejardhjen e studentëve të regjistruar në këto programe, punësimit të tyre. Kështu studentët që janë të punësuar në sektorin privat dhe ata në sektorin shtetëror zënë një përqindje të përafërt. Shumë pak vijnë nga OJF dhe institucione të tjera të pavarura. Një pjesë e konsiderueshme gjithashtu është e papunë ose nuk ka deklaruar të dhënat specifike mbi punësimin.




Nëse i hedhim një sy shpërndarjes gjeografike të studentëve, shikojmë se studentët që vijnë nga Tirana përbëjnë pjesën dominuese. Kështu, nga studentët që ndjekin programet Master të Nivelit të Dytë në Fakultetin Ekonomik, 83% kanë vendbanimin në Tiranë dhe vetëm 17 % janë nga rrethet. Shpërndarja dhe pesha që zënë studentët nga Tirana ndryshon në fakultetet e tjera. Studentët nga Tirana që ndjekin dy programet Master të Fakultetit Juridik, përbëjnë vetëm 68% të totalit të studentëve. Pjesa tjetër përbëhet nga studentë me banim në rrethe të tjera. E njëjta situatë paraqitet edhe në Fakultetin e Shkencave Sociale, ku mbi 66% e studentëve janë me vendbanim në Tiranë dhe 34% në rrethet e ndryshme. Nëse mund ta detajojmë më tej analizën e shpërndarjeve nëpër rrethe, na rezulton që qytetet më të përfaqësuar janë kryesisht Shkodra, Vlora dhe Elbasani. Më pak Korça, Fieri, Berati dhe Saranda.

Nëse analizojmë grup moshat e studentëve sipas Fakulteteve dhe ndarjen e tyre sipas gjinisë do të shohim si më poshtë:

Fakulteti		Ekonomik	Shkenca Sociale	Juridik
Gjinia	F	68%	79%	63%
	M	32%	21%	37%
% e studentëve sipas grupmoshës	20-30 vjec	50%	47%	72%
	30-40 vjec	37%	41%	21%
	40-50 vjec	10%	11%	6%
	50-60 vjec	3%	1%	1%
	Mbi 60 vjec	0%	0%	0%

Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në këto programe studimi, për secilin Fakultet. Numri më i lartë i pedagogëve për Fakultetin Ekonomik shpjegohet me numrin e madh të studentëve që ndjekin programet MND të këtij Fakulteti. Përqindja që zë stafi akademik i jashtëm varion nga 28% për Fakultetin e Shkencave Sociale në 46% për Fakultetin Ekonomik.



Sa i takon shpërndarjes së lëndëve sipas anëtarëve të personelit akademik, vihet re se nga 58 pedagogë të angazhuar në këto programe studimi, 8 prej tyre janë angazhuar në dy lëndë, vetëm 1 në tre lëndë, ndërsa gjithë të tjerët në një lëndë të vetme.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit 2010

Emërtimi i programit të studimit			Karakteristikat e studentëve				Stafi mësimdhënës		Cilësia e studentëve***	
N°	Programi	Profili	n° Aplikantëve	n° pranuarve	Nota mesatare*	n° i studentëve**	I brendshëm	I jashtëm	Kalueshmëria	Nota mesatare
	Totali për F. Ekonomik		356	353	7.6	353	20	17		7.1
1	Financë		152	152	7.7	152	8	7		
		Tregje financiare dhe menaxhimi bankar	65	65		65				
		E drejte financiare fiskale dhe bankare	39	39		39				
		Finacat publike	21	21		21				
		Qeverisja e korporatave	27	27		27				
2	Menaxhim		162	159	7.6	159	8	10		
		Biznes dhe marketing nderkombetar	82	80		80				
		E drejta ekonomike	4	4		4				
		Komunikim ne biznes	12	12		12				
		Lidership dhe menaxhim i karrieres	64	63		63				
3	Ekonomi dhe Zhvillim i qëndrueshem		42	42	7.6	42	9	6		
		Administrata dhe politikat publike	34	34		34				
		Urbanizimi dhe zhvillimi territorial	4	4		4				
		Politika shoqeria dhe demokratizimi	1	1		1				
		Globalizimi dhe zhvillimi	3	3		3				
	Totali për F. Shkencave Sociale		148	143	8.1	143	18	7		7.5
1	Shkenca Politike		36	35	8.08	35	8	3		
		Adnistrata dhe politikat publike	16	16		16				
		Globalizimi dhe zhvillimi	3	3		3				
		Komunikimi sjelljet politike	5	5		5				
		Politika shoqeria dhe demokratizimi	12	11		11				
2	Shkenca Komunikimi		73	73	8.2	73	10	4		
		Komunikimi dhe sjelljet politike	16	16		16				
		Komunikimi ne biznes	14	14		14				
		Lidershipi dhe menaxhimi i karrieres	22	22		22				
		Teori dhe modele komunikimi	21	21		21				

UET - Raporti i Vetëvlerësimit 2010

Emërtimi i programit të studimit			Karakteristikat e studentëve				Stafi mësimdhënës		Cilësia e studentëve***	
N°	Programi	Profili	n° Aplikantëve	n° pranuarve	Nota mesatare*	n° i studentëve**	I brendëshëm	I jashtëm	Kalueshmëria	Nota mesatare
3	Sociologji		12	11	8.11	11	8	3		
		Kriminalogji	7	6		6				
		Plotika shoqëria dhe demokratizimi	5	5		5				
4	Marrëdhënie Ndërkombëtare		27	24	7.9	24	8	2		
		E drejte europiane dhe nderkombetare	11	9		9				
		Globalizim dhe zhvillimi	2	2		2				
		Politika shoqëria dhe demokratizimi	4	4		4				
		Studime te sigurise dhe gjeopolitikes	10	9		9				
Totali për F. Juridik			188	184	8.37	184	12	8		7.8
1	E drejtë private		71	70	8.4	70	6	5		
		E drejte Civile	37	36		36				
		Qeverisja e korporatave	9	9		9				
		E Drejte financiare, fisklae, bankare	19	19		19				
		E Drejta ekonomike	6	6		6				
2	E drejtë publike		117	114	8.35	114	8	4		
		E drejte europiane nderkombetare	25	25		25				
		E drejte penale	35	33		33				
		E drejte kushtetuese administrative	57	56		56				

* Nota mesatare e diplomës me të cilën janë pranuar studentët në programin mësimor përkatës

** Numri aktual i studentëve

*** Cilësia e studentëve do të plotësohet vetëm për programet mësimore në të cilat kanë përfunduar studimet të paktën një brez studentësh.

Analizë e specifikuar për çdo Program Studimi

Fakulteti Ekonomik

Programet e studimit Master i Nivelit të Parë

Ky fakultet ofron 3 programe studimi Masteri i nivelit të parë (MNP): i) Banka dhe sigurime, ii) Marketing dhe iii) Menaxhim Biznesi. Të tre këto drejtime, shoqërohen gjithashtu edhe nga tre drejtime për secilin prej tyre që e bën edhe më të gjerë mundësinë e zgjedhjes për të interesuarit për këtë tip diplome kështu profilet për secilin prej drejtimeve janë:

1. Banka dhe sigurime; ose e shoqëruar me një nga profilet:

- a) Banka;
- b) Sigurime;
- c) Politika fiskale;

2. Menaxhim Biznesi ose e shoqëruar me një nga profilet:


- a) Menaxhim i SME-ve;
- b) Menaxhim i burimeve njerëzore dhe karrierës;
- c) Institucione dhe administrim publik.

3. Marketing; ose e shoqëruar me një nga profilet:

- a) Shërbime dhe turizëm;
- b) Inovacion dhe tregje strategjike;
- c) Marketing bankar dhe financiar;

Në vitin akademik 2009-2010, në këto programe janë regjistruar 16 studentë, një numër mjaft i ulët krahasuar me studentët e brezit të parë që u regjistruan dhe nisën studimet në mars 2009, 75 të tillë në total. Sa i takon notës mesatare në hyrje ajo ka qenë pothuajse konstante, rreth 7.5. Interesi më i madh ka qenë për programet Banka dhe Sigurime, e Menaxhim Biznesi. Grafiku i mëposhtëm tregon shpërndarjen e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2009-2010 sipas profileve të ofruara, në tre programet e Fakultetit të Ekonomik.

Grafik 1 Shpërndarja e studentëve të MNP sipas profileve për vitin 2009-2010




Burimi: Sekretaria UET

Siç shihet qartë profili më i preferuar është ai i Menaxhimit të SME-ve, megjithëse po të nisemi nga numri fillestar i regjistrimeve, dallimet janë të ulëta midis profileve.

Pjesa dërmuese e mësimit në këto programe mbulohet nga pedagogë të brendshëm, të cilët përbëjnë 67% të personelit akademik të angazhuar. Sa i takon nivelit të kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këto programe, shihet se rreth 75% e tyre janë me grada e tituj. Në total, si asistentë të

pedagogëve me grada e tituj janë angazhuar edhe 5 pedagogë me Master, të cilët e kanë zhvilluar mësimin nën kujdesin dhe përgjegjësinë e titullarëve të lëndëve.



Programi “Banka dhe Sigurime”

Ky program është ofruar për herë të parë në UET në mars të vitit 2009. Objektivi kryesor i tij është formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike aplikative në fushën e bankave, sigurimeve dhe politikave e sistemeve fiskale. Pajisja e tyre me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare në fushën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të bankave, bursave dhe tregjeve financiare, shoqërive të sigurimit, fondeve specifike të investimeve apo pensione, institucioneve e strukturave të specializuara në sferën e politikave fiskale, tatimore e doganore, etj.

Në përfundim të studimeve, pritet që studenti të jetë pajisur me njohuritë dhe aftësitë e duhura për menaxhimin e suksesshëm të bankave, shoqërive të sigurimit dhe tregjeve financiare në tërësi apo sektorëve specifikë të tyre në veçanti. Programi ofron kompetenca të orientuara dhe specializuara në sferën e instrumenteve dhe politikave monetare, kontabilitetit bankar, marketingut bankar dhe sigurimeve, analizës së riskut dhe investimeve, tregjet e kapitaleve dhe bursat, standardet ndërkombëtare financiare dhe bankare, analizë dhe menaxhim i buxhetit qendror dhe atyre lokale apo të organizatave e institucioneve të ndryshme, politikat dhe paketat fiskale, sistemin e taksave dhe tatimeve dhe menaxhimin e tij, funksionimin dhe specifikat e doganave, sistemet dhe funksionimi i auditit të brendshëm dhe të jashtëm, etj.

Ky program është ndërtuar për t'i ardhur në ndihmë të gjithë të interesuarve, të cilët kërkojnë që të përmirësojnë njohuritë e tyre në fushën e teknikave bankare dhe të atyre të sigurimeve. Profilizimi i studentëve në drejtimin “Bankë” kryhet nëpërmjet lëndëve të Banka dhe menaxhim financiar dhe Strategji dhe politika financiare. Nëpërmjet këtyre dy lëndëve studentit i ofrohet një informacion më i detajuar dhe praktik për sa i përket teknikave bankare, dhe lidhjes që ekziston midis sektorit bankar dhe politikave financiare. Profili i dytë “Sigurime”, realizohet nëpërmjet lëndëve a) Menaxhim i sigurimeve dhe b) Analizë financiare e avancuar, nëpërmjet të cilave synohet të thellohen dijet dhe aftësitë në dy prej pikave më të rëndësishme të sektorit të sigurimeve: në ndërtimin në mënyrë sa më të saktë të një portofoli sigurimesh, i cili të ofrojë një siguri të lartë dhe qëndrueshmëri, dhe nga ana tjetër, në analizën financiare që përbën një ndër format kryesore të analizës në këtë fushë. Profili i tretë, ai i politikave fiskale, kërkon që të thellojë nivelin e përgatitjes së specialistëve që kërkojnë të punësohen në sektorin publik, si në atë qendror ashtu edhe në atë lokal. Është shumë e rëndësishme të theksohet kjo e fundit

për vetë rëndësinë që merr përgatitja e specialistëve fiskalë të administratës lokale, në kuadër të decentralizimit të kompetencave të pushtetit qendror drejt atij vendor. Në këto kushte, nevoja për specialistë të këtij niveli është më shumë se e domosdoshme. Profili i tretë ofron si lëndë specifike: Analizë buxheti (nacional dhe lokal) dhe Politikat dhe sistemet fiskale dhe tatimore. Të tre këta profile i drejtohen sektorëve të cilët kanë një nevojë të rëndësishme për staf të specializuar, dhe të përditësuar me teknikat e reja të punës. Përzgjedhja e lëndëve të profilit, besojmë se e mundëson tërësisht këtë. Të diplomuarit në këtë drejtim mundën që të punësohen në fusha të ndryshme të sektorit financiar dhe atij bankar (Banka Qendrore, banka të nivelit të dytë, institucione financiare jo bankë), institucionet financiare qendrore dhe lokale (Ministria e financave, administrata lokale,) në fushën e sigurimeve, në administrimin e marrëdhënieve privat –institucione tatimore etj., duke ofruar ekspertizë të specializuar dhe një nivel të lartë njohurish praktike.

MNP: BANKA DHE SIGURIME

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	BANKA DHE SIGURIME	ECTS
1	Kontabiliteti nacional	6

B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 5 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	BANKA DHE SIGURIME	ECTS
1	Investimet dhe menaxhimi i portofolit	6
2	Institucionet financiare dhe tregjet e kapitaleve	6
3	Standardet ndërkombëtare financiare dhe bankare	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	BANKA	SIGURIME	POLITIKAT FISKALE	ECTS
1	Bankat dhe menaxhimi bankar	Menaxhimi i Sigurimeve	Analizë Buxheti (nacional dhe lokal)	6
2	Strategji dhe politika financiare	Analizë financiare e avancuar	Politikat dhe sistemet fiskale e tatimore	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	BANKA DHE SIGURIME	ECTS
1	Marketingu bankar dhe i sigurimeve	6
2	Auditi financiar dhe bankar	6
3	E drejta bankare dhe e sigurimeve	6
4	Ekonometri	6
5	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	6
6	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	6
7	Debate ekonomike bashkëkohore	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	8
---	-----------------------	---

F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

Plani mësimor i programit bën një ndarje të barabartë të lëndëve të detyrueshme, 3 për çdo semestër. Studenti ka të drejtë ta ndjekë lëndën opsionale semestrin e parë ose të dytë, në varësi interesave të tij.

Procedura për zgjedhjen dhe miratimin e temës së diplomës nis që semestrin e parë, në mënyrë që studenti të ketë kohën e mjaftueshme për të bërë punë kërkimore. Ndërsa, praktika profesionale zhvillohet gjatë semestrit të dytë.

I gjithë stafi akademik i angazhuar për mësimdhënie në këtë program ka të paktën gradën shkencore “Doktor”, ndërsa 3 prej tyre titullin shkencor “Profesor i asocuar”, dhe një titullin shkencor “Profesor”. Për tema të caktuara, në një nga lëndët është angazhuar 1 asistent me Master, por nën drejtimin dhe kujdesin e veçantë të një pedagogu me titull. Raporti pedagogë të brendshëm me të jashtëm është 8 me 3.

Programi “Menaxhim Biznesi”

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë me njohuri të plota në aspektet teorike edhe veçanërisht në aftësitë praktike aplikative në fushën e menaxhimit të bizneseve të vogla, të mesme e të mëdha; njërive të ndryshme të shërbimit si agjenci turizmi e transporti, institucioneve arsimore e shëndetësore, të medias së shkruar e asaj televizive; menaxhimit dhe analizës së politikave publike të institucioneve publike qendrore e lokale, OJF-ve, etj. Një objektiv i veçantë i është dhe kompletimi i njohurive në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, karrierës, legjislacionit të punës dhe sjelljes organizative.

Programi ofron kompetenca në menaxhimin e sektorëve të marketingut dhe shitjeve në biznese të ndryshme prodhuese apo shërbimesh, financiare e bankare, turizmit, transportit, kozmetikës, sektorit agro-ushqimor, veshjeve, artikujve industrialë, sektorit të automobilave, elektro-shtëpiakeve, etj. Kompetenca të orientuara dhe specializuara në sferën e marketingut të turizmit dhe shërbimeve; tregjeve strategjike dhe inovacioneve; si dhe marketingut bankar, sigurimeve dhe financiar në përgjithësi.

Ky programi studimi vjen si një përgjigje e kërkesës e fushës së administrimit të sipërmarrjes sot në Shqipëri. Si një prej degëve kryesore të ekonomisë, administrimi i ndërmarrjeve, sot përballë me sfida të reja, që lidhen me karakteristikat e sipërmarrjeve shqiptare si edhe me problemet me të cilat përballen këto të fundit. Përgatitja e specialistëve të aftë për t’ju përgjigjur dhe për të qenë aktivë në përballje me këto sfida është edhe objektivi i këtij drejtimi. Karakteri praktik në këtë drejtim është edhe thelbi i tij. Lëndët bazë të këtij programi, synojnë që të thellojnë njohuritë e studentëve në fushën e menaxhimit në tre komponentë të saj: strategjik, financiar dhe operacional. Secili prej profileve sigurohet nëpërmjet dy lëndëve të menduara në mënyrë të veçantë që synojnë të rritin aftësitë praktike të studentëve, për të mundur përballje të suksesshme të tyre me problemet reale. Profilizimi në “Menaxhim i SME-ve”, arrihet nëpërmjet dy lëndëve : i) Menaxhim i cilësisë, dhe ii) Teori dhe modele të sipërmarrjes. Këto lëndë i drejtohen dy prej problemeve kryesore të një ndërmarrjeje të vogël apo të mesme, atij të përzgjedhjes së mënyrës më të mirë për të zhvilluar biznesin dhe ruajtjes në mënyrë të vazhdueshme të cilësisë së produktit final nëpërmjet sigurimit të cilësisë së lëndës së parë dhe përgjatë procesit të prodhimit. Lëndët specifike në profilin “Menaxhim i Burimeve njerëzore dhe karrierës”, janë i) Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës, dhe ii) Sociologji e organizatave. Duhet theksuar se ky profil ka një fushë të gjerë interesi si për sa i përket firmave të vogla apo të mesme ashtu edhe kompanive të mëdha, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Si një drejtim i cili akoma lë shumë për të dëshiruar, specialistët e kësaj fushe plotësojnë një nevojë të ekonomisë së vendit. Profili i fundit “Institucione dhe administrim publik” mundësohet nëpërmjet lëndëve i) Menaxhimi i sektorit publik dhe administrata dhe ii) Vlerësim i politikave publike. Është momenti që në Shqipëri të fitojë qytetari koncepti i administratorit publik i cili është i specializuar në karakteristikat e veçanta të administratës publike (qoftë kjo qendrore apo lokale). Të tre profilet e këtij drejtimi ofrojnë një gamë të gjerë punësimi për të diplomuarit në sektorin privat si administratorë të firmave të vogla dhe të mesme, në

departamentet apo drejtoritë e burimeve njerëzore të të gjithë njësive qofshin këto publike apo private, prodhuese apo social-kulturore, në nivel qendror apo në atë lokal dhe si specialistë në administratën publike.

MNP: MENAXHIM BIZNESI

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	MENAXHIM BIZNESI	ECTS
1	Menaxhim financiar	6

B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 5 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	MENAXHIM BIZNESI	ECTS
1	Menaxhimi operacional	6
2	Menaxhimi strategjik	6
3	Menaxhimi i sistemeve të informacionit	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	MENAXHIM I SME-ve	MENAXHIMI I BNJ & KARRIERES	INSTITUCIONE & ADMINISTRIM PUBLIK	ECTS
1	Menaxhim cilësie	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	Menaxhimi i sektorit publik dhe administrata	6
2	Teori dhe modele të sipërmarrjes	Sociologji e organizatave	Vlerësimi i Politikave Publike	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	MENAXHIM BIZNESI	ECTS
1	Reklama dhe promovimi	6
2	Ekonomia dhe menaxhimi inovacioneve	6
3	MP biznesi	6
4	Etika e biznesit	6
5	E drejta e biznesit, norma dhe praktika	6
6	Teknikat e advokimit dhe lobimit	6
7	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	8
---	-----------------------	---

F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

Plani mësimor i programit bën një ndarje të barabartë të lëndëve të detyrueshme, 3 për çdo semestër. Studenti ka të drejtë ta ndjekë lëndën opsionale semestrin e parë ose të dytë, në varësi interesave të tij. Procedura për zgjedhjen dhe miratimin e temës së diplomës nis që semestrin e parë, në mënyrë që studentit të ketë kohën e mjaftueshme për të bërë punë kërkimore. Ndërsa, praktika profesionale zhvillohet gjatë semestrit të dytë.

Në këtë program 5 prej pedagogëve të angazhuar nuk kanë gradë shkencore (dy janë doktorantë dhe dy Master dhe 1 Magjistër), elementi i cili duhet të mbahet në vëmendje për tu përmirësuar. 10 prej pedagogëve janë doktorë, dhe 2 kanë titullin Profesor i asociuar. Raporti staf i brendshëm me stafi i jashtëm është 12 me 5.

Programi “Marketing”

Objekti kryesor i programit është formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë në aspektet teorike edhe veçanërisht në aftësitë praktike aplikative në fushën e tregjeve, standardeve, marketingut, reklamës dhe promocionit, çmimeve, etj. Pajisja e tyre me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare në fushën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të strukturave të specializuara në fushën e marketingut, promocionit dhe reklamave në sektorë të ndryshëm të biznesit dhe ekonomisë në përgjithësi, analizës dhe funksionimit të tregjeve specifike, psikologjinë e marketingut dhe negociatat në marketing, etj.

MNP: MARKETING

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	MARKETING	ECTS
1	Reklama dhe promocioni	6

B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 5 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	MARKETING	ECTS
1	Psikologji marketingu	6
2	Marketing strategjik	6
3	Ekonomia dhe menaxhimi inovacioneve	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	SHËRBIME & TURIZËM	INOVACION & TREGJE STRATEGJIKE	MARKETING BANKAR DHE FINANCIAR	ECTS
1	MP biznesi	Strategjitë e E-marketingut	Strategji dhe politika financiare	6
2	Tregje dhe strategji turizmi	Marketingu ndërkombëtar	Marketingu bankar dhe i sigurimeve	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	MARKETING	ECTS
1	Menaxhimi i sistemeve të informacionit	6
2	Teknikat e advokimit dhe lobimit	6
3	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	6
4	Praktikum i marrëdhënieve publike	6
5	Debate ekonomike bashkëkohore	6
6	Etika e biznesit	6
7	Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	8
---	-----------------------	---

F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

Programi ofron kompetenca në menaxhimin e sektorëve të marketingut dhe shitjeve në biznese të ndryshme prodhuese apo shërbimesh, financiare e bankare, turizmit, transportit, kozmetikës, sektorit agro-ushqimor, veshjeve, artikujve industrialë, sektorit të automobilave, elektro-shtëpiakeve, etj. Kompetenca të orientuara dhe specializuara në sferën e marketingut të turizmit dhe shërbimeve;

tregjeve strategjike dhe inovacioneve; si dhe marketingut bankar, sigurimeve dhe financiar në përgjithësi.

Ky program kërkon që të plotësojë kërkesën gjithmonë në rritje për ekonomistë të specializuar në fushën e marketingut, në drejtimet kryesore që gjykohen edhe si prioritare për Shqipërinë. Zhvillimi i ekonomisë, i sektorit të mediave, sektorit turistik, apo integrimi i ekonomisë së vendit në atë globale, kërkon nevojën e specialistëve të këtyre fushave. Në profilin “Shërbime financiare dhe Turizëm, specializimi nëpërmjet lëndëve a) MP biznesi dhe b) Tregje dhe strategji turizmi, kërkon që të formojë specialistë të cilët janë të përgatitur për të analizuar dhe administruar në mënyrë të qëndrueshme ofertën turistike. Tregjet turistike për vetë karakteristikat e veçanta që kanë, kërkojnë edhe strategji të mirë përcaktuara ndaj edhe këta specialistë do të ofrojnë një ekspertizë praktike më të thelluar në këtë sektor. Profili i dytë “Inovacione dhe tregje strategjike” i drejtohet kryesisht tregjeve të reja (teknologjisë), apo mënyrave të reja të bërit biznes nëpërmjet internetit, si një degë e re me zhvillim të vullshëm, kjo ofron mundësi për firmat të cilat duan të rekrutojnë specialistë të këtij profili për tregjet elektronike. Profilizimi në “Marketingu bankar dhe financiar” sigurohet nëpërmjet lëndëve a) Strategji dhe politika financiare dhe fiskale dhe b) Marketingu bankar dhe i sigurimeve. Ky i drejtohet një sektori me zhvillim të rëndësishëm, sidomos pas zgjerimit në mënyrë të konsiderueshme të institucioneve financiare të nivelit të dytë (banka, jo banka etj.) të cilët hedhin në treg një gamë të gjerë produktesh financiare. Të diplomuarit në këtë drejtim, kanë një mundësi të gjerë punësimi në sektorin publik (në institucionet publike që merren me nxitjen e turizmit në vend), në sektorin privat (ndërmarrjet turistike, ndërmarrjet prodhuese, institucionet financiare etj.)

Ajo që bie në sy është mungesa e interesit të studentëve për dy nga profilet e këtij programi. Si rezultat është hapur vetëm profili Inovacion dhe Tregje strategjike. Ndarja e ngarkesës mësimore midis semestrit të parë dhe atij të dytë rezulton e rregullt. Kështu, brezit të parë të studentëve që filluan mësimin në mars 2009 iu ofruan 24 kredite semestrin e parë kundrejt 36 krediteve të semestrit të dytë. I njëjti raport vlen edhe për studentët që nisën studimet në tetor 2009, nëse lëndën opsionale e kanë zgjedhur semestrin e parë. Puna për punimin e diplomës nis që semestrin e parë në mënyrë që studenti të ketë kohën e mjaftueshme për përgatitjen e një punimi sa më cilësor.


Në këtë program 6 prej pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie janë doktorë, 1 ka titullin Profesor i Asociuar dhe 1 titullin Profesor. Vetëm një nga pedagogët e angazhuar është ende në proces të përfundimit të studimeve të doktoratës. Sa i takon raportit pedagogë të brendshëm me pedagogë të jashtë ai është në nivelin 7 me 2.

Programet e studimit Diplomë e Nivelit të Dytë



Duke filluar nga viti akademik 2009-2010 Fakulteti Ekonomik ofron dy programe DND, të shoqëruar me profilet përkatëse si më poshtë:

1. Financë Bankë
 - a. Banka dhe Tregje financiare
 - b. Ekonomi Financë
2. Administrim Biznesi
 - a. Biznes marketing
 - b. Administrim publik
 - c. Ekonomi europiane.

Në këto programe janë regjistruar 82 studentë, nga të cilët 65 në programin “Financë Bankë,” me notë mesatare në hyrje prej 7.4, dhe 17 në programin “Administrim Biznesi,” me notë mesatare në hyrje 8.




Siç mund të shihet edhe nga grafiku preferencat kryesore janë për programin Financë-Bankë. Më poshtë një ndarje më e detajuar sipas profileve të programeve.



Shohim se kemi një dominim të përzgjedhjes së profileve Ekonomi – Financë dhe Biznes Marketing me respektivisht 88% dhe 71%.

Stafi akademik i angazhuar në këto programe është kryesisht i brendshëm në masën 71%. Sa i takon kualifikimit të stafit akademik, 24% e tij përbëhet nga pedagogë me tituj Profesor dhe Profesor i Asocuar dhe 42% ka gradën shkencore Doktor. Raporti pedagog-studentë për këto programe është në nivelin 1 pedagog për afërsisht 4 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 5.5 studentë.



Programi i studimit Financë Banka

Ky program synon të formojë ekspertë dhe specialistë cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e financave publike; hartimit, analizës dhe menaxhimit të buxhetit; menaxhimi i bankave, sigurimeve dhe tregjeve financiare; qeverisjen e korporatave, etj. T'i pajisë ata me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar e debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencën shqiptare në fushën e financave publike; qeverisjen e korporatave; në sferën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të bankave, bursave dhe tregjeve financiare, shoqërive të sigurimit, fondeve specifike të investimeve apo pensione, institucioneve e strukturave të specializuara në sferën e politikave fiskale, tatimore e doganore; njohuri të qëndrueshme në fushën e të drejtës bankare, financiare e fiskale, etj. Në mënyrë më specifike, studentët, në varësi me preferencat dhe strategjinë e karrierës së tyre kanë mundësi të zgjedhin e të orientohen në një drejtim më të specializuar në fushat "Banka dhe tregje financiare" ose "Ekonomi-financë".

Kompetencat profesionale që ofron ky program për të diplomuarit janë: njohja dhe menaxhimi i suksesshëm i strukturave apo institucioneve të sistemit ekonomik e financiar në përgjithësi, bankës qendrore dhe bankave tregtare e atyre të zhvillimit, shoqërive të sigurimit dhe tregjeve financiare në tërësi apo sektorëve specifikë të tyre në veçanti. Kompetenca teorike e praktike të orientuara dhe specializuara në sferën e politikave ekonomike e financiare, financave publike, strategjive të zhvillimit ekonomik e social, zhvillimit territorial, instrumenteve dhe politikave monetare, kontabilitetit bankar, marketingut bankar dhe sigurimeve, analizës së riskut dhe investimeve, tregjet e kapitaleve dhe bursat, standardet ndërkombëtare financiare dhe bankare, analizë dhe menaxhim i buxhetit qendror dhe atyre lokale apo të organizatave e institucioneve të ndryshme, politikat dhe paketat fiskale, sistemin e taksave dhe tatimeve dhe menaxhimit të tij, funksionimin dhe specifikat e doganave, sistemet dhe funksionimi i auditit të brendshëm dhe të jashtëm, etj.

Programi është i organizuar në funksion të objektivit për të krijuar financierë me dije të forta shkencore, të aftë për të përballuar një vendimmarrje kompetente në menaxhimin e sistemit bankar. Lëndët që përbëjnë disiplinat e detyrueshme janë vendosur në një rend akademik i cili krijon një bazë shumë të mirë për dije të qëndrueshme dhe të gjera si në fushën e mikro financës edhe në atë të makro financës. Në përfundim të këtij programi studentët janë në gjendje të kuptojnë, shpjegojnë dhe vlerësojnë ndryshimet që ndodhin sistemin financiar.

Në profilin "Banka dhe Tregje Financiare" studentet aftësohen me dije specifike në funksionimin e institucioneve financiare dhe në vlerësimin e teknikave të menaxhimit të tyre. Në përfundim të lëndëve të detyrueshme specifike studentët janë të aftë të marrin vendime në çdo situatë të zhvillimit të bankave apo të institucioneve të tjera financiare. Në profilin "Ekonomi-Financë" studentët me anë të lëndëve të detyrueshme specifike aftësohen në vendimmarrjen makroekonomike. Ata profilizohen në dizajnimin dhe vlerësimin e politikave makroekonomike që lidhen me tregjet financiare dhe ndikimin që ato kanë në zhvillimin ekonomik, si në rrafshin kombëtar edhe në atë rajonal apo evropian.

Një rol të rëndësishëm në formim kanë edhe disiplinat me zgjedhje apo formuese të ngjashme, të cilat duke u zgjedhur nën një këshillim intensiv nga pedagogët i shtojnë vlerë njohurive të studentëve sipas profileve.

Raporti pedagog-studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezulton se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 12, prej të cilëve 4 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 65. Këto shifra rezultojnë në afërsisht 1 pedagog për 5.4 student të regjistruar, ose rreth një pedagog i brendshëm për 8 student të

DND FINANCË BANKA

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË) 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

Nr.	Viti	FINANCË BANKA	ECTS
1	I	Mikroekonomi e avancuar & Makroekonomi e avancuar	12

B - DISIPLINA TE FORMIMIT KARAKTERIZUES TE PROGRAMIT 40% / 48 ECTS / 8 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	Viti	FINANCË BANKA	ECTS
1	I	Debate ekonomike bashkëkohore	6
2		Kontabiliteti nacional	6
3	II	Ekonometri	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Nr.	Viti	BANKA DHE TREGJE FINANCIARE	EKONOMI - FINANCË	ECTS
1	I	Bankat dhe institucionet financiare	Teori dhe modele zhvillimi	6
2		Standardet ndërkombëtare financiare dhe bankare	Strategji dhe politika financiare	6
3	II	Investimet dhe menaxhimi i portofolit	Europa monetare & fiskaliteti në BE	6

III -LËNDË OPSIONALE TË PËRBASHKËTA / 2 lëndë

Nr.	Viti	FINANCË BANKA	ECTS
1	II	Analizë buxheti (nacional & lokal)	6
2		Marketingu bankar dhe i sigurimeve	6
3		Institucionet financiare dhe tregjet e kapitaleve	6
4		Analizë financiare e avancuar	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE 10% / 12 ECTS / 2 lëndë

1	I	Menaxhim dhe vlerësim projektesh	6
2		Auditi financiar dhe bankar	6
3		Menaxhimi i sigurimeve	6
4	II	Vlerësimi i Politikave Publike	6
5		E drejta bankare dhe e sigurimeve	6
6		Menaxhimi i sistemeve të informacionit	6

D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TE LIRA 7-8% 6 ECTS / 1 lëndë

1	II	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	6
2		Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6
3		Organizatrat dhe institucionet ndërkombëtare	6
4		E drejta e biznesit, norma dhe praktika	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

1	II	Praktikë / stazh 3 mujor	12
---	----	--------------------------	----

F - PUNIMI I DIPLOMËS 10-25% /30 ECTS

1	II	Punimi i diplomës	30
---	----	-------------------	----

regjistruar. Për sa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 7.4, duke paraqitur kështu një nivel relativisht të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program përbëhet nga pedagogë me grada e tituj (1 Prof. Dr., 3 Prof. Asoc., 4 Doktorë dhe 1 Magjistër). Në program janë angazhuar si asistentë 3 pedagogë me Master, por edhe këta nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e pedagogëve me grada e tituj.

Programi i studimit në Administrim Biznesi

Ky program ka për qëllim të formojë ekspertë dhe specialistë cilësorë në aspektet teorike edhe aftësitë praktike aplikative në fushën e menaxhimit e administrimit të biznesit. Pajisja e tyre me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare në fushën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të bizneseve të vogla, mesme dhe të mëdha, rregullat dhe mënyrat e funksionimit të biznesit ndërkombëtar, menaxhimit të projekteve dhe investimeve, vlerësimit të kapaciteteve prodhuese e financiare të bizneseve, zgjerimit dhe thellimit të kompetencave në sferën e marketingut dhe shitjeve, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe karrierës, mirë orientimit në tregjet strategjike brenda dhe jashtë vendit, drejtimin të institucioneve publike si Ministri, departamente apo drejtori brenda tyre, menaxhimi i Bashkive dhe Komunave, OJF-ve, etj. Në mënyrë më specifike, studentët, në varësi me preferencat dhe strategjinë e karrierës së tyre kanë mundësi të zgjedhin e të orientohen në një drejtim më të specializuar në fushat Biznes-marketing”, “Administrim Publik” ose “Ekonomi Europiane”.

Ndër kompetencat profesionale që programi ofron për të diplomuarit përmendim: njohja dhe menaxhimi i suksesshëm i bizneseve të llojeve të ndryshme në fushën prodhuese, shërbimeve, turizmit, financiare, shitjeve e tregtisë, etj. Kompetenca teorike e praktike të orientuara dhe specializuara në sferën e politikave ekonomike e financiare, financave publike, strategjive të zhvillimit ekonomik e social, administrimit të SME-ve, njësive të institucioneve publike të të gjitha niveleve, analizës së riskut dhe investimeve në biznes, tregjet e kapitaleve, standardet ndërkombëtare të cilësisë, teknikat e lobimit dhe avokatisë, politikat dhe paketat fiskale, sistemin e taksave dhe tatimeve dhe menaxhimit të tij, funksionimin dhe specifikat e doganave, sistemet dhe funksionimi i auditit të brendshëm dhe të jashtëm, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe karrierës, specifikat dhe kërkesat e ekonomisë evropiane, etj.

Ky program është i organizuar në funksion të objektivit për të krijuar ekonomistë me njohuri të forta shkencore në fushën e menaxhimit, të aftë për të përballuar një vendimarrje kompetente në menaxhimin e sektorit privat e publik, si në kushtet e një ekonomie kombëtare edhe në ato të një ekonomie të integruar në BE.

Lëndët që përbejnë disiplinat e detyrueshme ndihmojnë menaxherët për të vlerësuar në mënyrë shumë shkencore çdo problem që i shtrihet veprimtaria ekonomike dhe për të gjetur zgjidhjet më të mira që ofron teoria dhe praktika bashkëkohore.

Në profilin “Biznes Marketing” studentët aftësohen me dije specifike të funksionimit të kompanive në kushtet e një mjedisi ekonomik dinamik ku vendimet ekonomike të biznesit privat ndikohen nga kushtet e tregut dhe konkurrenca kombëtare dhe ndërkombëtare në rritje.

Në profilin “Administrim Publik” studentët me anë të lendeve të detyrueshme specifike aftësohen në vendimarrjen publike. Ata profilizohen jo vetëm duke njohur specifikat e funksionimit të administratës publike, por ata pajisen me njohuri të plota për të financuar dhe vlerësuar politikat publike.

Profili “Ekonomia Europiane” synon të përgatisë menaxherë me njohuri të gjera edhe për tregjet e tjera sidomos ato evropiane. Programi arrin të pajisë studentët jo vetëm me njohuritë e vendimarrjes ekonomike në sektorët e biznesit dhe tregut të punës, por edhe t’iu japë atyre njohuri të plota për

DND ADMINISTRIM BIZNESI

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË) 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

Nr.	Viti	ADMINISTRIM BIZNESI	ECTS
1	I	Menaxhim operacional & Menaxhim cilësie	12

B - DISIPLINA TE FORMIMIT KARAKTERIZUES TE PROGRAMIT 40% / 48 ECTS / 8 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	Viti	ADMINISTRIM BIZNESI	ECTS
1	I	Debate ekonomike bashkëkohore	6
2		Menaxhim dhe vlerësim projektsh	6
3		Menaxhim financiar	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Nr.	Viti	BIZNES- MARKETING	ADMINISTRIM PUBLIK	EKONOMIA EUROPIANE	ECTS
1	I	Menaxhim strategjik	Menaxhimi i sektorit publik dhe administrata	Analizë e ekonomisë së sektorëve dhe konkurrenca në BE	6
2		Marketing strategjik	Vlerësimi i politikave publike	Europa monetare & fiskaliteti në BE	6
3	II	Marketing ndërkombëtar	Analizë buxheti (nacional & lokal)	Tregu i punës & Politikat sociale në BE	6

III - LËNDË OPSIONALE TË PËRBASHKËTA / 2 lëndë

Nr.	Viti	ADMINISTRIM BIZNESI	ECTS
1	II	Ekonomia dhe menaxhimi inovacioneve	6
2		Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	6
3		Etika e biznesit	6
4		Politika agro-ushqimore dhe mjedisore e BE-së	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE 10% / 12 ECTS / 2 lëndë

1	I	Teori dhe modele zhvillimi	6
2		Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare	6
3		E drejta e biznesit, noma dhe praktika	6
4	II	Sociologji e organizatave	6
5		Qeverisja dhe demokracia lokale e krahasuar	6
6		Menaxhimi i sistemeve të informacionit	6

D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TE LIRA 7-8% / 6 ECTS / 1 lëndë

1	II	Teknikat e advokimit dhe lobimit	6
2		Praktikum i marrëdhënieve publike	6
3		Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6
4		Studime të avancuara në të drejtën administrative	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

1	II	Praktikë / stazh 3 mujor	12
---	----	--------------------------	----

F - PUNIMI I DIPLOMËS 10-25% /30 ECTS

1	II	Punimi i diplomës	30
---	----	-------------------	----

marrëdhëniet që krijohen gjatë biznesit edhe me sektorët financiarë e fiskalë. Fokusi i këtyre njohurive mbetet tregu i BE-së që është tregu me i madh ku ne synojmë të operojmë në të ardhmen.

Një rol të rëndësishëm në formim kanë edhe disiplinat me zgjedhje apo formuese të ngjashme, të cilat duke u zgjedhur nën një këshillim intensiv nga pedagogët, i shtojnë vlerë njohurive të studentëve sipas profileve.

Raporti pedagog-studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezulton se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 13, prej të cilëve 2 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 17. Këto shifra rezultojnë në afërsisht 1 pedagog për 1.3 studentë të regjistruar, ose rreth një pedagog i brendshëm për 1.5 studentë të regjistruar. Për sa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 8, duke paraqitur kështu një nivel relativisht të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program përbëhet nga pedagogë me grada e tituj (2 Prof. Asoc., 7 Doktorë dhe 1 Magjistër). Në program janë angazhuar si asistentë 3 pedagogë me Master, nga të cilët njëri në proces doktorature, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e pedagogëve me grada e tituj.

Programet e studimit Master i Nivelit të Dytë

Programet MND u hapën në tetor 2009. Fakulteti Ekonomik i ka aktivizuar të tre programet e licencuara në këtë cikël studimi:

1. MENAXHIM, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. Lidershipi dhe menaxhimi i karrierës
 - b. Biznes dhe marketing ndërkombëtar
 - c. Komunikimi në biznes
 - d. E drejtë ekonomike
2. FINANCË, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. Financat publike
 - b. Qeverisja e korporatave
 - c. Tregjet financiare dhe menaxhimi bankar
 - d. E drejtë financiare, fiskale dhe bankare
3. EKONOMI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. Administrata dhe politikat publike
 - b. Urbanizimi, zhvillimi territorial dhe politikat mjedisore
 - c. Politika, shoqëria dhe demokratizimi
 - d. Globalizimi dhe zhvillimi

Qëllimi i këtyre programeve është thellimi i aftësive profesionale të studentëve në fushën e zgjedhur të studimit, për të përgatitur kërkues shkencorë dhe profesionistë të kualifikuar, të aftë për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të punës ose për të vazhduar studimet në programet e doktoratës.


Këto programe janë hartuar mbi bazën e identifikimit të nevojave të tregut të punës, si atij lokal ashtu edhe ndërkombëtar. Duhet thënë se elementet bazë të programeve janë bazuar në një konceptim didaktik i cili lejon fleksibilitet nga ana akademike. Kështu struktura e çdo programi krijon mundësi të mjaftueshme për studim të pavarur mbi bazën e leksioneve dhe literaturës, reflektim me anë të eseve të ndryshme apo detyrave të kursit, si edhe analizë të pavarur nga ana e studentit.

Për sa i përket përmbajtjes së programit të studimit, strukturimi i lëndëve është bërë në përputhje me objektivat formuese dhe emërtimin e diplomës. Në të njëjtën mënyrë, janë përcaktuar qartë dhe ngarkesa specifike për çdo lëndë, gjë që i lejon studentit të krijojë një ide të qartë të ngarkesës

mësimore që duhet të përballojë në auditor dhe jashtë tij. Vëmendje e veçantë i është kushtuar formave të mësimdhënies duke u bazuar në eksperiencën dhe praktikën më të mirë kombëtare dhe ndërkombëtare për çdo program studimi.


Një komponent me rëndësi të veçantë i programit është përgatitja e mikrotezës, e cila zë një peshë të konsiderueshme të ngarkesës së programit, thuajse 1/3 e tij (18 ECTS). Në funksion të këtij procesi nga të gjithë pedagogët udhëheqës u zhvilluan seancat metodologjike, për të asistuar hap pas hapi studentët gjatë punës kërkimore. Ndërkohë karakteri akademik e kërkimor i programeve është theksuar nga fakti që krahas rëndësisë që i është dhënë punimit të mikrotezës, edhe esetë e përgatitura për lëndët e programit, të ishin të lidhura me tematikën e mikrotezës. Në këtë mënyrë studenti do të kishte mundësi të hulumtonte në thellësi çështjen e tij të studimit.

Vihet re që këto programe kanë qenë më të kërkuarit dhe kanë numrin më të madh të studentëve (pak më shumë se ½ e studentëve të regjistruar), krahasuar me programet e Fakulteteve të tjera. Nota mesatare në hyrje është 7,6. Grafiku më poshtë shpreh numrin e studentëve të regjistruar në programet e Fakultetit Ekonomik, në përqindje ndaj totalit për këtë Fakultet.



Masteri në Financë ka patur profilet më të suksesshme në terma shpërndarjeje, duke qenë se të katër alternativat janë zgjedhur nga një numër i konsiderueshëm studentësh. Masteri në Menaxhim ka shfaqur probleme në profilet e Drejtë Ekonomike dhe Komunikim në Biznes. Nga komunikimet e ndryshme me studentët, rezulton se profili E Drejtë Ekonomike, është perceptuar si profil strikt juridik. Duke qenë se shumica e studentëve vijnë nga fusha studimi të ekonomisë, kanë preferuar të mos kalojnë në një fushë që e konsideronin jo të tyre, siç është e drejta. Për sa i përket profilin Komunikimi në Biznes, argumentat kanë qenë të ndryshëm, por përshtypja e përgjithshme ka qenë që studentët nuk e kanë zgjedhur kryesisht prej mospërputhjes me profilin e tyre të punës. Programi “më pak i suksesshëm” nga pikëpamja e fluksit të studentëve ka qenë Masteri në Ekonomi dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Përveç profilin të Administratës Publike, të huazuar nga Shkencat Politike, të gjithë profilet e tjerë kanë patur një numër shumë të vogël studentësh. Mendohet se këtu ka ndikuar emërtimi dhe fokusi relativisht më i gjerë i profileve të këtij programi. Pra, koncepti i profilizimit nuk materializohet në aplikimin e këtyre alternativave.

Në total, në programet MND të Fakultetit Ekonomik janë angazhuar 37 pedagogë, nga të cilët 20 të brendshëm dhe 17 të jashtëm. Kjo bën që raporti pedagog/student për këtë Fakultet të jetë 1 me 9.5. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këto programe studimi është me grada dhe tituj, ku pjesën më të madhe në përqindje, rreth 60% e përbëjnë anëtarët me gradën PhD ose Dr. Në programe janë angazhuar si asistentë edhe 4 pedagogë në përfundim të studimeve të doktoratës dhe 3 pedagogë me master, nën kujdesin dhe përgjegjësinë e titullarëve me grada e tituj.



MND Manaxhim

- *Objektivat Formuese* Ky program synon :

- Ø formimin e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë me njohuri të plota në aspektet teorike edhe veçanërisht në aftësitë praktike aplikative në fushën e menaxhimit të bizneseve të vogla, të mesme e të mëdha në të gjithë sektorët e ekonomisë; njësive të ndryshme të shërbimit si agjenci turizmi e transporti, institucioneve arsimore e shëndetësore, struktura të medias së shkruar e asaj televizive; menaxhimit dhe analizës së politikave publike të institucioneve publike qendrore e lokale, OJF-ve, etj.
- Ø kompletimin e njohurive në lidhje me teoritë dhe praktikatat e lidhshme të menaxhimit dhe menaxhimit të tij; menaxhimit të burimeve njerëzore, analizës dhe menaxhimit të karrierës, njohjes së plotë të legjislacionit të punës dhe sjelljes organizative, përvetësimit të elementeve themelore të komunikimit në biznes dhe marrëdhënieve publike për korporatat; elementët themelorë të së drejtës ekonomike, etj.

Nr.	MND - MENAXHIM				ECTS
1	Metoda kërkimi 1				6
2	Metoda sasiore në ekonomi (Ekonometri e aplikuar)				6
3	Teori të avancuara të menaxhimit				6
4	Modele të krahasuara të menaxhimit				6
Profili	LIDERSHIPI DHE MENAXHIMI I KARRIERËS	BIZNES DHE MARKETING NDËRKOMBËTAR	KOMUNIKIMI NË BIZNES	E DREJTË EKONOMIKE	ECTS
5	Teoritë e lidhshme	Biznes ndërkombëtar	Praktikum i komunikimit në biznes	E drejta ndërkombëtare tregtare	6
6	Modele të menaxhimit të karrierës	Kërkime në marketing	Marrëdhënie publike për korporatat (raste studimore)	Çështje të së drejtës ekonomike	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

Ky program mundëson dhënie të kompetencave në menaxhimin ekonomik e financiar të bizneseve të të gjitha llojeve; administrimin e sektorëve të marketingut dhe shitjeve në biznese të ndryshme prodhuese apo shërbimesh, financiare e bankare, turizmit, transportit, kozmetikës, sektorit agro-ushqimor, veshjeve, artikujve industrialë, sektorit të automobilave, elektro-shtëpiakeve, etj. Kompetenca

të orientuara dhe specializuara në sferën e marketingut dhe biznesit ndërkombëtar; të llojeve të ndryshme të turizmit dhe shërbimeve; të njohjes dhe menaxhimit të tregjeve strategjike dhe përfshirjen e inovacioneve; si dhe njohurive të avancuara të marketingut bankar, sigurimeve dhe tregjeve financiare në përgjithësi.; thellimi i njohurive në fushën e instrumenteve dhe modeleve të komunikimit në biznes; i marrëdhënieve publike për korporatat; njohje e thelluar e të drejtës ekonomike, etj.

Programi i studimit është i ndërtuar mbi një strukturë teorike e cila synon të krijojë dije shkencore të një niveli të avancuar. Duke studiuar në këtë program studentët të njohin teoritë dhe modelet më të avancuara të drejtimit të prodhimit.

Lëndët që përbëjnë disiplinat e detyrueshme u krijojnë studentëve një bazë shumë të mirë metodologjike për të zhvilluar kërkime shkencore në fushën e menaxhimit dhe për t'i vlerësuar përfundimet e tyre edhe nga pikëpamja sasiore. Dy lëndët e tjera të detyrueshme i ndihmojnë të thellojnë njohuritë teorike duke krahasuar e ballafaquar edhe arritjet më të fundit në fushën e menaxhimit.

Në profilin "Lidershipi dhe Menaxhimi i Karrierës" studentët aftësohen në lidhje me rolin që ka menaxhimi i burimeve njerëzore në një ekonomi, si dhe me teoritë dhe modelet bazë me anën e të cilave kompanitë krijojnë nxitje për avancimin e tyre në karrierë.

Profili "Biznes dhe Marketing Ndërkombëtar" i jep studentëve njohuri për një fushë mjaft të avancuar të menaxhimit. Problemet me të cilat përballen një korporatë janë gjithnjë e më shumë globale për shkak të hapjes e integritetit të tregjeve. Ky profil i pajis studentet me dije për të ndërtuar biznese të suksesshme në kushtet e një konkurrence ndërkombëtare gjithnjë në rritje.

Profili "Komunikimi në Biznes" është një drejtim i ri i shkencës së menaxhimit. Ky profil ndihmon në përgatitjen e menaxherëve me njohuri të gjera jo vetëm në ligjësitë që drejtojnë biznesin brenda një korporate, por edhe në mënyrën që ato ndërveprojnë me korporatat e tjera për të rritur eficiencën ekonomike. Lëndët e propozuara në këtë profil pasqyrojnë një kombinim të mire të teorisë me raste më të avancuara të praktikës më të mirë ndërkombëtare.

Profili "E Drejtë Ekonomike" është ndërtuar mbi bazën e kryqëzimit të njohurive të avancuara ekonomike dhe ligjore që lidhen me menaxhimin e një biznesi. Ky profil është në gjendje të thellojë njohuritë e të gjithë të interesuarve, ekonomistë apo juristë, që punojnë në menaxhim të kompanive dhe që operojnë në sektorë ku vendimet ekonomike e ligjore janë të ndërvarura.

Studenti i një profili mund të plotësojë interesat e tij të veçanta duke zgjedhur edhe një nga lëndët e ofruara për profilet e tjera.

Shihet se aspektet teorike bazë të menaxhimit, trajtohen në katër lëndë bazë, ku studenti njihet me konceptet bazë dhe metodat aplikative të kërimit shkencor në fushën e menaxhimit. Organizimi është bërë në mënyrë të tillë që dy lëndë bazë dhe një lende profili, secila me nga 6 ECTS të zhvillohen në një semestër, dhe lëndët e tjera në dy semestra të tjerë. Kjo lejon si fleksibilitet nga ana didaktike ashtu edhe mundësi për punë të pavarur të studentit.

Mësimdhënia në këtë program studimi zhvillohet nga 18 pedagogë, prej të cilëve 10 janë të jashtëm. Sa i përket kualifikimit të këtij stafi, 2 prej pedagogëve janë me titull Prof. Dr, 12 pedagogë me gradën Dr. dhe 3 pedagogë në përfundim të studimeve të doktoratës (kandidatë për PHD) e një me Master, të cilët kanë asistuar titullarët e lëndëve për një pjesë të seancave mësimore. Raporti pedagog-student është në nivelin 1 pedagog për 8.8 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për rreth 19 studentë.

MND – Financë

- *Objektivat Formuese* Ky program synon:

- Ø Formimin e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e financave publike; hartimit, analizës dhe menaxhimit të buxhetit; menaxhimi i bankave, sigurimeve dhe tregjeve financiare; qeverisjen e korporatave, etj.

- Ø Pajisjen e tyre me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar e debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencën shqiptare në fushën e financave publike; qeverisjen e korporatave; në sferën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të bankave, bursave dhe tregjeve financiare, shoqërive të sigurimit, fondeve specifike të investimeve apo pensione, institucioneve e strukturave të specializuara në sferën e politikave fiskale, tatimore e doganore;; njohuri të qëndrueshme në fushën e të drejtës bankare, financiare e fiskale, etj.

Nr.	MND -FINANCË				ECTS
1	Metoda kërkimi				6
2	Metoda sasiore në ekonomi (Ekonometri e aplikuar)				6
3	Makroekonomi financiare dhe monetare				6
4	Debatet bashkëkohore mbi financat ndërkombëtare				6
Profil	FINANCAT PUBLIKE	QEVERISJA E KORPORATAVE	TREGJET FINANCIARE DHE MENAXHIMI BANKAR	E DREJTË FINANCIARE, FISKALE, BANKARE	ECTS
5	Teori dhe strategji buxhetimi	E drejta e korporatave	Teoritë e tregjeve të kapitaleve	E drejta financiare dhe fiskale	6
6	Financat publike (kurs i avancuar)	Analiza financiare e korporatave	Modele të menaxhimit bankar	E drejta e tregjeve dhe ndërmjetësimit financiar	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

Kompetencat profesionale që ofron ky program janë: njohja dhe menaxhimi i suksesshëm i bankave Qendrore dhe atyre tregtare; shoqërive të sigurimit dhe tregjeve financiare në tërësi apo sektorëve specifikë të tyre në veçanti; hartimi, analiza dhe menaxhimi i financave publike dhe buxhetit; planifikimi dhe menaxhimi në sektorin e tatimeve dhe doganave. Kompetenca të orientuara dhe specializuara në sferën e instrumenteve dhe politikave monetare, kontabilitetit bankar, marketingut bankar dhe sigurimeve, analizës së riskut dhe investimeve, tregjet e kapitaleve dhe bursat, standardet ndërkombëtare financiare dhe bankare, analizë dhe menaxhim i buxhetit qendror dhe atyre lokale apo të organizatave e institucioneve të ndryshme, politikat dhe paketat fiskale, sistemin e taksave dhe tatimeve dhe menaxhimit të tij, funksionimit dhe specifikat e doganave, sistemet dhe funksionimi i auditit të brendshëm dhe të jashtëm, qeverisjen financiare të korporatave, legjislacionin specifik financiar, bankar e fiskal, etj.

Programi i studimit është i ndërtuar mbi një strukturë teorike e cila synon krijon dije shkencore të një niveli të avancuar. Duke studiuar në këtë program studentët arrijnë të njohin ligjësitë themelore që drejtojnë sistemin financiar në kushtet e ekonomisë së tregut.

Lëndët që përbejnë disiplinat e detyrueshme i krijojnë studentëve një bazë shumë të mirë metodologjike për të zhvilluar kërkime shkencore në fushën e makro financave dhe për t'i vlerësuar përfundimet e tyre edhe nga pikëpamja sasiore. Ndërsa dy lëndët e tjera të detyrueshme të profilit përkatës i ndihmojnë të thellojnë njohuritë teorike në financë.

Në profilin "Financa Publike" studentët aftësohen me dije specifike për rolin që kanë financat publike në sistemin financiar të një ekonomie, si dhe me teoritë dhe modelet bazë me anë të të cilave buxheti ndikon në zhvillimin të një vendi.

Profili "Qeverisja e Korporatave" i jep studenteve njohuri për një fushë mjaft të avancuar të menaxhimit financiar. Problemet me të cilat përballen korporatat janë ligjore dhe financiare kështu që lëndët e profilit janë zgjedhur të tilla për t'i dhënë njohuri në vendimarrjen financiare në çdo rrethanë.

Profili "Tregjet Financiare dhe Menaxhimi Bankar" synon të përgatisë menaxherë me njohuri të gjera edhe për tregjet financiare. Programi arrin të pajisë studentët jo vetëm me njohuritë e vendimarrjes

ekonomike në sektorët e biznesit bankar të nivelit të dytë, por edhe t'iu propozojë teori e modele të menaxhimit të integruar të sistemit bankar në të dy nivelet e tij.

Profili "E drejte Financiare Fiskale dhe Bankare" është ndërtuar mbi bazën e kryqëzimit të njohurive të avancuara ekonomike dhe ligjore që lidhen me funksionimin e sistemit financiar. Ky profil është në gjendje të thellojë njohuritë e të gjithë të interesuarve, ekonomistë apo juristë, që punojnë në sistemin financiar dhe që operojnë në sektorë ku vendimet ekonomike e ligjore janë të ndërvlarura.

Studenti i një profili mund të plotësojë interesat e tij të veçanta duke zgjedhur edhe një nga lëndët e ofruara për profilet e tjera.

Mësimdhënia është zhvilluar nga 15 pedagogë, prej të cilëve 7 të jashtëm. Sa i takon kualifikimit të këtij stafi, 2 prej pedagogëve janë me titullin Prof. Dr, 3 me titullin Prof. Asoc. 3 me gradën Dr., 2 me gradën PhD, 2 Kandidatë për PHD dhe 3 pedagogë me Master. Për shkak të natyrës së tij specifike, vetëm profili " E drejtë financiare, fiskale dhe bankare" nuk është arritur të mbulohet me personel akademik me grada dhe tituj. Raporti pedagog-studentë është në nivelin 1 pedagog për rreth 10 studentë ose 1 pedagog i brendshëm për 19 studentë.

MND - Ekonomi dhe Zhvillim i Qëndrueshëm

- *Objektivat Formuese* Ky program synon :

- Ø Formimin e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë në aspektet teorike edhe aftësitë praktike aplikative në fushën e teorive të rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, modelevë të krahasuara të zhvillimit ekonomiko-social; teoritë, politikat dhe instrumentet kryesore të zhvillimit mjedisor; administrimin dhe menaxhimin e institucioneve publike;
- Ø ndërtimin dhe menaxhimin e administratës publike dhe sektorëve të veçantë saj;
- Ø hartimin, aplikimin dhe analizën e politikave publike dhe menaxhimin e riskut publik; zhvillimin urban dhe territorial; politikat dhe mekanizmat e menaxhimit të qyteteve dhe njësive administrative; politikën evropiane të kohezionit territorial, të zhvillimit të integruar rural, të mjedisit; platformat dhe instrumentet kryesore ndërkombëtare të zhvillimit, etj.

Nr.	MND -EKONOMI DHE ZHVILLIM I QENDRUESHËM				ECTS
1	Metoda kërkimi 1				6
2	Metoda sasore në ekonomi (Ekonometri e aplikuar)				6
3	Makroekonomia e zhvillimit				6
4	Modele zhvillimi të krahasuara				6
Profili	ADMINISTRATA DHE POLITIKAT PUBLIKE*	URBANIZIM, ZHVILLIMI TERRITORIAL DHE POLITIKA MJEDISORE	POLITIKA, SHOQËRIA DHE DEMOKRATIZIMI*	GLOBALIZIMI DHE ZHVILLIMI**	ECTS
5	Institucionet e administratës publike të krahasuara	Zhvillimi urban dhe menaxhimi i territorit	Sociologji politike e demokratizimit	Regjimet dhe institucionet ndërkombëtare	6
6	Politikat publike dhe risku publik	Ekonomia dhe politikat mjedisore	Teoritë e demokratizimit dhe probleme të tranzicionit	Modernizimi, zhvillimi dhe globalizimi	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

Ky program ofron kompetenca në ndërtimin, menaxhimin dhe funksionimin e institucioneve publike të tilla si Ministri, Bashki, Komuna, njësi bashkiake, qarqe, etj.; kompetenca në teoritë dhe politikat e zhvillimit ekonomik e social, mjedisor e territorial; kompetenca në hartimin dhe aplikimin e strategjive të zhvillimit sektorial e territorial, të qarqeve, Bashkive e Komunave; kompetenca në fushën e *acquis communitaires* të BE në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm, kohezionit social e territorial, zhvillimit të

integruar rural, etj.; kompetenca në fushën e politikave ekonomike dhe modeleve të zhvillimit; kompetenca në fushën e politikave të integritit rajonal, evropian dhe global.

Programi i studimit është i ndërtuar mbi një strukturë teorike e cila synon krijon njohuri të avancuara në teoritë e rritjes dhe zhvillimit ekonomik në një spektër të gjerë. Duke studiuar në këtë program studentët arrijnë të njohin teoritë dhe modelet më të avancuara të zhvillimit ekonomik, si dhe të njohin politikatat me anë të të cilave arrihet barazia ekonomike, demokratizimi dhe globalizimi.

Disiplinat e detyrueshme i krijojnë studentëve një bazë shumë të mirë metodologjike për të zhvilluar kërkime shkencore në fushën e ekonomisë dhe për t'i vlerësuar përfundimet e tyre edhe nga pikëpamja sasiore. Dy lëndet e tjera të detyrueshme i ndihmojnë të thellojnë njohuritë teorike në fushën e teorisë makroekonomike të zhvillimit, si dhe të modeleve më të suksesshme të arritjes së një rritjeje ekonomike të qëndrueshme.

Në profilin "Administrata dhe Politikat Publike" studentët aftësohen me dije specifike për rolin që kanë politikatat publike në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e mirëqenies shoqërore. Cilësia e politikave publike varet nga struktura e administratës publike dhe roli i saj në shoqëri.

Profili "Urbanizim, zhvillimi territorial dhe politikat mjedisore" i jep studenteve njohuri për një fushë mjaft të rëndësishme në zhvillimet bashkëkohore. Lëndët e këtij profili i pajisin studentët me një aparat mjaft cilësor të realizimit të analizave të politikave të urbanizimit dhe ruajtjes së mjedisit.

Profili "Politika shoqëria dhe demokratizimi" i orienton studentët në një trajtim sociologjik të problemeve të pabarazisë shoqërore dhe zhvillimit ekonomik. Ky profil ndihmon në kuptimin e lidhjes së domosdoshme midis demokratizimit dhe shoqëror dhe zhvillimit ekonomik.

Profili "Globalizimi dhe Zhvillimi" është ndërtuar mbi bazën e kryqëzimit të njohurive të avancuara ekonomike dhe të shkencave politike, për të ndihmuar studentët në kuptimin e njërës prej dukurive ekonomike më komplekse, globalizimit ekonomik. Lidhja modernizim-inovacion-globalizim është trajtuar në shumë këndvështrim për të kuptuar rolin e këtyre proceseve në zhvillimin ekonomik.

Studenti i një profili mund të plotësojë interesat e tij të veçanta duke zgjedhur edhe një nga lëndët e ofruara për profilet e tjera.


Për mësimdhënien në këtë program studimi janë angazhuar 15 pedagogë, prej të cilëve 6 të jashtëm. Sa i përket kualifikimit të tyre, 2 me titull Prof. Dr, 3 me titull Prof. Asoc., 4 pedagogë me gradën PhD dhe 4 me gradën Dr, si edhe 2 asistentë pa gradë nën drejtimin e anëtarëve të stafit me grada e tituj. Raporti pedagog-student është në nivel mjaft të mirë, 1 pedagog për rreth 3 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 4.6 studentë.

Fakulteti i Shkencave Sociale

Programet e studimit Master i Nivelit të Parë

Ky fakultet, duke filluar nga marsi 2009, ofron diploma Master të Nivelit të Parë në:


1. MARRËDHËNIE PUBLIKE; ose shoqëruar me një nga profilet:
 - a. MP për sektorin komercial
 - b. MP politike dhe institucionale
2. SHKENCA POLITIKE; ose shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Sjellja dhe strategjitë politike
 - b. Politika publike
3. MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE – DIPLOMACI; ose shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Çështjet e Ballkanit
 - b. Studime amerikane



Sikurse shihet edhe nga grafiku, programi më i preferuar, ndonëse jo me një diferencë të konsiderueshme është ai për Marrëdhënie Publike. Sa i takon vitit akademik që nisi në tetor 2009, pati vetëm 4 studentë të regjistruar, 2 për Marrëdhënie publike dhe nga 1 për dy programet e tjera. Mendohet se rënia e interesit për këto programe ka ardhur si rezultat i hapjes së programeve Master i Nivelit të Dytë, duke qenë se kryesisht kërkesat vinin nga studentë që kanë përfunduar sistemin e vjetër 4-vjeçar, të cilët preferonin të ndiqnin një program të ciklit të tretë. Kostoja për hapjen e këtyre programeve për këtë vit akademik, pavarësisht numrit të vogël të studentëve të regjistruar, u mor përsipër edhe si rezultat i faktit që semestri i parë i vitit 2009-2010 do të mbivendosej me semestrin e dytë të studimeve për studentët që nisën studimet në mars 2009.

Nota mesatare në hyrje për studentët që filluan studimet në mars 2009 është 7.9, ndërsa për ata që filluan studimet në tetor është 8.3.

Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këto programe studimi është kryesisht i brendshëm, në masën 76%. Sa i përket cilësisë, ai përbëhet kryesisht nga pedagogë me grada dhe tituj, në masën 76%. Në këto programe janë angazhuar edhe 2 pedagogë ende në proces të studimeve të doktoratës dhe 4 me Master, nën përgjegjësinë dhe drejtimin e anëtarëve të stafit me grada e tituj. Sa i takon raportit pedagogë/studentë, nëse llogaritet për totalin e studentëve të regjistruar në këto programe që nga marsi 2009, është afërsisht 1 me 2.



Programi i studimit Marrëdhënie Publike

Ky master ka për objektiv të formojë specialistë në fushën e marrëdhënieve publike, të aftë për të ndërmjetësuar aksionin e aktorëve të ndryshëm shoqërorë, të biznesit, të politikës apo të sektorit të shoqërisë civile me publikun dhe median, në funksion të prezantimit apo reklamimit të produktit të tyre në tregun e mallrave, shërbimeve apo të hapësirës publike. Ky Master i aftëson studentët lidhur me nocionet bazë dhe të thelluara të profesionit të komunikimit dhe të marrëdhënieve publike. Studenti përmes programit kupton sistemet aktuale të komunikimit dhe të medias dhe aftësohet të përdorë me efikasitet teknikat e duhura për të ndërmjetësuar shërbimet dhe produktet me publikun dhe median. Nëpërmjet njohurive të marra në këtë program studimi studentët mund të realizojnë në mënyrë të specializuar kontaktin produkt- treg apo publik. Objektivat e këtij programi studimi veçohen më tej sipas profileve të mëposhtme:

Profili Marrëdhënie Publike për Sektorin Komercial: Studentët që zgjedhin këtë profil përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike për sektorin e biznesit të prodhimit dhe të shërbimeve. Ky profil specializon dhe i jep një kompetencë të shtuar studentit, krahas aftësive të përgjithshme në marrëdhëniet publike, edhe ndaj produktit të biznesit.

Profili Marrëdhënie Publike Politike dhe Institucionale. Studentët që zgjedhin këtë profil përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike dhe politike, të partive politike, të institucioneve shtetërore, të organizatave jofitimprurëse, të institucioneve të sektorit të tretë, humanitar, etj. Ky profil specializon dhe i jep një kompetencë të shtuar studentit, krahas aftësive të përgjithshme në marrëdhëniet publike, edhe ndaj produktit jokomercial, përqendruar tek politika dhe institucionet.

Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Kështu të gjithë studentët e këtij programi marrin fillimisht lëndët e detyrueshme për të gjithë të cilat shërbejnë për dhënien e një baze të mirë konceptuale, me anë të së cilës mund të kuptohen më mirë qasjet aplikative të ofruara në lëndët e kategorive të tjera. Dy profilet e këtij programi studimi më pas fokusohen në lëndë specifike që lidhen më në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilet e zgjedhura. Kështu në profilin *Marrëdhënie Publike për Sektorin Komercial* me lëndët Marrëdhënie Publike Biznesi dhe Reklama dhe promocioni studentët përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike për sektorin e biznesit të prodhimit dhe të shërbimeve. Nëpërmjet këtyre lëndëve studentët e këtij profili specializohen dhe marrin një kompetencë të shtuar, krahas aftësive të përgjithshme në marrëdhëniet publike, edhe ndaj produktit të biznesit. Ndërsa në profilin *Marrëdhënie Publike Politike dhe Institucionale* studentët

përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike dhe politike, të partive politike, të institucioneve shtetërore, të organizatave jofitimprurëse, të institucioneve të sektorit të tretë, humanitar, etj. Nëpërmjet këtyre lëndëve studentët e këtij profili specializohen dhe marrin një kompetencë të shtuar, krahas aftësive të përgjithshme në marrëdhëniet publike, edhe ndaj produktit jokomercial, përqendruar tek politika dhe institucionet.

MNP: MARRËDHËNIE PUBLIKE

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE PUBLIKE (MP)	ECTS
1	Statistikë Sociale	6

B - DISIPLINA TE FORMIMIT KARAKTERIZUES TE PROGRAMIT / 5 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE PUBLIKE	ECTS
1	Konceptim dhe menaxhim fushatash	6
2	Komunikimi masiv bashkëkohor	6
3	Praktikum i marrëdhënieve publike	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Nr.	MP PËR SEKTORIN KOMERCIAL	MP POLITIKE DHE INSTITUCIONALE	ECTS
1	MP biznesi	MP të organizatave	6
2	Reklama dhe promovimi	MP politike	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE PUBLIKE	ECTS
1	Sociologji e komunikimit dhe TIK (teknologjitë e informacionit dhe komunikimit)	6
2	Komunikimi viziv (TV, foto)	6
3	Produksioni në media (print, audio, video, media, multimedia)	6
4	Teknikat e advokimit dhe lobimit	6
5	Antropologji social-kulturore dhe politike	6
6	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6
7	Psikologji marketingu	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	8
---	-----------------------	---

F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezultojn se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2009-2010 është 9, prej të cilëve 3 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program, në total është 20. Këto shifra rezultojnë në afërsisht 1 pedagog për 2 studentë të regjistruar, ose një pedagog i brendshëm për 3 studentë të regjistruar.

Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit MNP Marrëdhënie Publike është një staf mjaft i kualifikuar i përbërë nga pedagogë me grada e tituj, nga të cilët 2 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. 4 me gradën

doktor. Asistentët me master, rezultojnë vetëm dy të tillë (njëri prej të cilëve në proces doktorature), janë angazhuar në procesin e mësimdhënies vetëm nën mbikëqyrjen e një pedagogu me gradë Doktor e sipër.

Programi i studimit Shkenca Politike

Ky master ka për objektiv të formojë politologë, të cilët kanë kryer një fakultet të parë dhe janë angazhuar ose duan të angazhohen në fushën e politikës, administrimit të çështjeve publike apo në fushën e kërkimeve politike. Masteri ka karakter të fortë profesional për të krijuar në harkun e 12 muajve njohuritë bazë dhe të aplikuara të profesionit të politologut apo të kërkuesit politik.

Masteri i aftëson studentët lidhur me nocionet bazë dhe të thelluara të profesionit të politologut, për analizimin dhe interpretimin e çështjeve politike, për pjesëmarrjen në organizmin e fushatave elektorale apo për angazhimin në funksionimin e sektorit publik. Ky program synon që duke theksuar lëndët me karakter praktik të aftësojë studentët për t'u përfshirë në aktivitete konkrete të administrimit politik dhe publik. Objektivat e këtij programi studimi veçohen më tej sipas profileve të mëposhtme:

MNP: SHKENCA POLITIKE

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	SHKENCA POLITIKE	ECTS
1	Statistikë Sociale	6

B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 5 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	SHKENCA POLITIKE	ECTS
1	Politika dhe sistemet e qeverisjes të krahasuara	6
2	Sociologji politike	6
3	Qeverisja dhe demokracia lokale e krahasuar	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	SJELLJA DHE STRATEGJITË POLITIKE	POLITIKA PUBLIKE	ECTS
1	MP politike	Vlerësimi i politikave publike	6
2	Konceptim dhe menaxhim fushatash	Menaxhimi i sektorit publik dhe administrata	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	SHKENCA POLITIKE	ECTS
1	Ideologjitë dhe lëvizjet e reja politike	6
2	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6
3	Politikat e identitetit	6
4	Teoritë e nacionalizmit	6
5	Teknikat e advokimit dhe lobimit	6
6	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	6
7	Antropologji social-kulturore dhe politike	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	8
---	-----------------------	---

F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

Profili Sjellja dhe Strategjitë Politike: Studentët që do të zgjedhin këtë profil do të përqendrohen në njohjen dhe vlerësimin e thelluar të sjelljes politike të elektoratit dhe do të aftësohen në organizmin dhe administrimin e fushatave konkrete politike, private apo administrative.

Profili Politika Publike: Studentët që do të zgjedhin këtë profil do të kenë një kompetencë të shtuar në mbulimin dhe menaxhimin e çështjeve publike. Më konkretisht ata do të jenë të aftë të vlerësojnë dhe ideojnë politikatat publike dhe më pas t'i zbatojnë ato në praktikë. Në këtë mënyrë ata do të jenë të aftë të angazhohen me sukses në sektorin publik dhe në administratë.

Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Kështu të gjithë studentët e këtij programi marrin fillimisht lëndët e detyrueshme për të gjithë të cilat shërbejnë për dhënien e një baze të mirë konceptuale, me anë të së cilës mund të kuptohen më mirë qasjet aplikative të ofruara në lëndët e kategorive të tjera. Dy profilet e këtij programi studimi më pas fokusohen në lëndë specifike që lidhen më në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilet e zgjedhura. Kështu në profilin *SJELLJA DHE STRATEGJITË POLITIKE* me lëndën Marrëdhënie Publike Politike dhe Konceptim dhe menaxhim fushatash studentët do të përqendrohen në njohjen dhe vlerësimin e thelluar të sjelljes politike të elektoratit dhe do të aftësohen në organizmin dhe administrimin e fushatave konkrete politike, private apo administrative. Ndërsa në profilin *POLITIKA PUBLIKE* nëpërmjet lëndëve Vlerësimi i Politikave Publike dhe Menaxhimi i Sektorit Publik dhe Administrata studentët përftojnë një kompetencë të shtuar në mbulimin dhe menaxhimin e çështjeve publike. Më konkretisht ata do të jenë të aftë të vlerësojnë dhe ideojnë politikatat publike dhe më pas t'i zbatojnë ato në praktikë. Në këtë mënyrë ata do të jenë të aftë të angazhohen me sukses në sektorin publik dhe në administratë.

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezultojnë se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 14, prej të cilëve 3 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program, në total, është 14. Këto shifra rezultojnë në 1 pedagog për 1 student të regjistruar, ose një pedagog i brendshëm për 1.3 studentë të regjistruar.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është mjaft i kualifikuar, i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 8 me gradën doktor). Asistentët me Master, 4 të tillë, nga të cilët njëri në proces doktorature, janë angazhuar në procesin e mësimdhënies vetëm nën mbikëqyrjen e një pedagogu me gradë Doktor e sipër.

Programi i studimit Marrëdhënie Ndërkombëtare – Diplomaci

Ky program studimi synon formimin profesional të specialistëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë konvencionale dhe asaj publike. Kjo do të arrihet përmes studimit të teorive kryesore mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe njohjes me zhvillimet më të rëndësishme politike, diplomatike dhe ekonomike në marrëdhëniet midis shteteve në plan global dhe rajonal si edhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare e rajonale. Studentët do të specializohen në dy profile të veçantë, çdonjëri prej të cilëve është i fokusuar në një rajon gjeopolitik shumë të rëndësishëm për interesat kombëtare të vendit tonë: Ballkani, dhe Shtetet e Bashkuara. Profilet quhen përkatësisht Çështjet e Ballkanit, dhe Studime Amerikane. Ky i fundit bëhet pjesë e një programi universitar në Shqipëri për herë të parë.

Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Kështu të gjithë studentët e këtij programi marrin fillimisht lëndët e

detyrueshme për të gjithë të cilat shërbejnë për dhënien e një baze të mirë konceptuale, me anë të së cilës mund të kuptohen më mirë qasjet aplikative të ofruara në lëndët e kategorive të tjera. Dy profilet e këtij programi studimi më pas fokusohen në lëndë specifike që lidhen më në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilet e zgjedhura. Kështu në profilin **ÇËSHTJET E BALLKANIT** me lëndët Historia Moderne dhe Bashkëkohore e Ballkanit dhe Gjeopolitika Aktuale e Ballkanit studentët do të thellojnë njohuritë e tyre në lidhje me zhvillimet më të rëndësishme politike, diplomatike dhe ekonomike në rajonin e Ballkanit si një rajon gjeopolitik shumë i rëndësishëm për interesat kombëtare të vendit tonë. Ndërsa në profilin **STUDIME AMERIKANE** studentët do të thellojnë njohuritë e tyre në lidhje me zhvillimet më të rëndësishme politike, diplomatike dhe ekonomike në plan global, duke u fokusuar në politikat ndërkombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, politika të cilat kanë një ndikim dhe paraqesin një interes mjaft të madh për vendin dhe për rajonin tonë.

MNP: MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI	ECTS
1	Statistikë Sociale	6

B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI	ECTS
1	Politika e jashtme e krahasuar	6
2	Diplomaci publike dhe ekonomike	6
3	E drejta diplomatike dhe protokoll diplomatik	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	ÇËSHTJET E BALLKANIT	STUDIME AMERIKANE	ECTS
1	Historia moderne dhe bashkëkohore e Ballkanit	Politika dhe shoqëria në SHBA	6
2	Gjeopolitika aktuale e Ballkanit	Analiza e politikës së jashtme të SHBA-së	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI	ECTS
1	Teknika të negocimit ndërkombëtar	6
2	Marrëdhëniet transatlantike	6
3	Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare	6
4	Politikat e identitetit	6
5	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6
6	Teoritë e nacionalizmit	6
7	Antropologji social-kulturore dhe politike	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	8
---	-----------------------	---

F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezultojn se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 10, prej të cilëve 3 janë të jashtëm,


ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program, në total, është 14. Këto shifra rezultojnë në afërsisht 1 pedagog për 1.4 student të regjistruar, ose një pedagog i brendshëm për 2 studentë të regjistruar.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është mjaft i kualifikuar, i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (2 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 5 me gradën doktor). Asistentët me Master, 2 të tillë, janë angazhuar në procesin e mësimdhënies vetëm nën mbikëqyrjen e një pedagogëve me grada e tituj.


Programet e studimit Diplomë e Nivelit të Dytë

Fakulteti i Shkencave Sociale ofroj këto programe studimi DND:

1. KOMUNIKIM – MARRËDHËNIE PUBLIKE; ose shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Studime dhe teoritë e komunikimit
 - b. Marrëdhënie Publike
2. SHKENCA POLITIKE; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Politikë e krahasuar
 - b. Teoritë politike
3. MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. Organizatat ndërkombëtare
 - b. Studime strategjike



Sikurse shihet edhe nga grafiku më sipër, numri i studentëve të regjistruar në këto programe është pothuaj në të njëjtat nivele, me një diferencë të vogël sa i takon programit në Shkenca Politike ku ka vetëm 10 studentë të regjistruar. Sa i takon profileve, më të preferuarit kanë rezultuar profili Marrëdhënie publike me 12 studentë, Teoritë politike me 9 studentë dhe Studimet strategjike me 11 studentë.



Stafi akademik i angazhuar në këto programe përbëhet nga staf i brendshëm në masën 77%. Ndërkohë, për sa i përket kualifikimit të këtij stafi, 81% e tij është me grada e tituj, nga të cilët 26% janë me tituj profesor ose profesor i asocuar dhe 55% me gradën shkencore Doktor. Raporti staf akademik – student për programet DND të Fakultetit të Shkencave Sociale është 1 pedagog për 1.35 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 1.75 studentë.

Programi i studimit Komunikim – Marrëdhënie Publike

Programi i studimeve Diplomë e Nivelit të Dytë në Komunikim – Marrëdhënie Publike ka për objektiv të formojë specialistë me dije të thelluara në fushën shkencave të komunikimit, të aftë të studiojnë fenomenet mediatike dhe dinamikat e reja të shoqërisë së komunikimit. Krahas dijeve teorike programi ka për qëllime aftësimin praktik në sektorin e marrëdhënieve publike të specialistëve të aftë për të ndërmjetësuar aksionin e aktorëve të ndryshëm shoqërorë, të biznesit, të politikës ose të sektorit të shoqërisë civile me publikun dhe median, në funksion të prezantimit ose të reklamimit të produktit të tyre në tregun e mallrave, të shërbimeve ose të hapësirës publike. Objektivat e këtij programi studimi veçohen më tej sipas profileve të mëposhtme:

Profili STUDIME DHE TEORITË E KOMUNIKIMIT: Studentët që zgjedhin këtë profil përqendrohen në njohjen më të thelluar të teorive dhe fenomeneve më bashkëkohore të komunikimit. Ata do të jenë të aftë që të mund të aplikojnë për median shqiptare dhe sektorin e komunikimit, teoritë bashkëkohore të komunikimit duke formuluar zgjidhjet për problemet e shoqërisë së komunikimit.

Profili MARRËDHËNIE PUBLIKE: Studentët që zgjedhin këtë profil përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike politike, të partive politike, të institucioneve shtetërore, të organizatave jofitimprurëse, të institucioneve të sektorit të tretë, humanitar, etj. Ky profil specializon dhe i jep studentit një kompetencë të shtuar, krahas aftësive të përgjithshme në marrëdhëniet publike dhe ndaj produktit jokomercial, përqendruar tek politika dhe institucionet. Krahas kësaj studentët do të aftësohen të përballen dhe me sektorin komercial.

Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të tretë të studimeve. Në përputhje dhe me objektivat e programit të studimit DND në Marrëdhënie Publike - Komunikim lëndët e ofruara mundësojnë një ndërthurje të mirë të dijeve teorike me ato praktike. Kështu të gjithë studentët e këtij programi marrin fillimisht lëndët e detyrueshme për të gjithë në kategoritë A dhe B të cilat shërbejnë për dhënien e një baze të mirë konceptuale, me anë të së cilës mund të kuptohen më mirë qasjet aplikative të ofruara në lëndët e kategorive të tjera. Dy profilet e këtij programi studimi më pas fokusohen në lëndë specifike që lidhen më në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilet e zgjedhura. Kështu në profilin *Studime dhe Teoritë e Komunikimit* nëpërmjet lëndëve Komunikimi Masiv Bashkëkohor, Sociologji e komunikimit dhe TIK dhe Studime Semiotike studentët përqendrohen në njohjen më të thelluar të teorive dhe fenomeneve më bashkëkohore të komunikimit. Nëpërmjet këtyre lëndëve studentët aftësohen që të mund të aplikojnë për median shqiptare dhe sektorin e komunikimit, teoritë bashkëkohore të komunikimit duke formuluar zgjidhjet për problemet e shoqërisë së komunikimit. Ndërsa në profilin *Marrëdhënie Publike* nëpërmjet lëndëve Marrëdhënie Publike Biznesi, Marrëdhënie Publike të Organizatave dhe Marrëdhënie Publike Politike studentët përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike politike, të partive politike, të institucioneve shtetërore, të organizatave jofitimprurëse, të institucioneve të sektorit të tretë, humanitar, etj. Nëpërmjet këtyre lëndëve ky profil specializon dhe i jep studentit një kompetencë të shtuar, krahas aftësive të përgjithshme në marrëdhëniet publike, dhe ndaj produktit jokomercial, përqendruar tek politika dhe institucionet. Krahas kësaj studentët aftësohen të përballen dhe me sektorin komercial.

DND KOMUNIKIM - MARRËDHËNIE PUBLIKE

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË) 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

Nr.	Viti	KOMUNIKIM - MARRËDHËNIE PUBLIKE	ECTS
1	I	Metoda kërkimi të avancuara & Statistikë sociale	12

B - DISIPLINA TE FORMIMIT KARAKTERIZUES TE PROGRAMIT 40% /48 ECTS/8 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	Viti	KOMUNIKIM MP	ECTS
1	I	Debate bashkëkohore	6
2		Teoritë e aplikuara të komunikimit	6
3		Konceptim dhe menaxhim fushatash	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Nr.	Viti	Studime dhe teoritë e komunikimit	Marrëdhënie publike	ECTS
1	I	Sociologji e komunikimit dhe TIK (teknologjitë e informacionit dhe komunikimit)	MP biznesi	6
2		Studime Semiotike	MP të organizatave	6
3	II	Komunikimi masiv bashkëkohor	MP politike	6

III -LËNDË OPSIONALE TË PËRBASHKËTA / 2 lëndë

Nr.	Viti	KOMUNIKIM MP	ECTS
1	II	Reklama dhe promovimi	6
2		Komunikimi viziv (TV, foto)	6
3		Praktikum i marrëdhënieve publike	6
4		Produksioni media (print, audio, video, media, multimedia)	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE 10% /12 ECTS/2 lëndë

1	I	Sociologji e organizatave	6
2		Antropologji social-kulturore dhe politike	6
3		Sociologji politike	6
4		Psikologji marketingu	6
5	II	Diplomaci publike dhe ekonomike	6
6		Marketing	6

D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TE LIRA 7-8% /6 ECTS/ 1 lëndë

1	II	Teknikat e advokimit dhe lobimit	6
2		Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	6
3		Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6
4		Ideologjitë dhe lëvizjet e reja politike	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE 10% /12 ECTS/1 lëndë

1	II	Praktikë / internship	12
---	----	-----------------------	----

F - PUNIMI I DIPLOMËS 10-25%/30 ECTS

1	II	Punimi i diplomës	30
---	----	-------------------	----

Gjithashtu si pjesë e veprimtarive mësimore gjatë zhvillimit të programit është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës në vitin e dytë.

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezultojnë se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 18, prej të cilëve 3 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 16. Këto shifra rezultojnë në afërsisht 1 pedagog për 0.88 student të regjistruar, ose rreth një pedagog i brendshëm për 1 student të regjistruar. Për sa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 7.21, duke paraqitur kështu një nivel relativisht të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është mjaft i kualifikuar i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (3 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc., 10 Doktorë). Në program janë angazhuar vetëm 2 pedagogë me Master dhe 1 pedagog ende në proces doktorature, por edhe këta nën mbikëqyrjen e pedagogëve me grada e tituj.

Programi i studimit në Shkenca Politike

Kjo diplomë synon të formojë politologë duke tërhequr ata individë që kanë kryer diplomën e nivelit të parë në fushën e shkencave sociale apo drejtësi. Ky program synon një thellim edhe më të madh të njohurive në fushën e shkencave politike me theks të shtuar në dimensionin akademik. Objektivat e këtij programi studimi veçohen më tej sipas profileve të mëposhtme:

Profili Politikë e krahasuar: Studentët që zgjedhin këtë profil përqendrohen në dimensionin institucional dhe aplikativ të procesit politik. Ata aftësohen në njohjen dhe vlerësimin e thelluar të sistemeve të ndryshme të qeverisjes, të politikës së jashtme si dhe të institucioneve të ndryshme politiko-administrative.

Profili Teoritë politike: Studentët që zgjedhin këtë profil përqendrohen më shumë në dimensionin teorik të procesit politik dhe të shkencave politike në përgjithësi. Ata aftësohen në analizën e ideologjive të ndryshme politike dhe të sistemeve të ndryshme demokratike.

Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të tretë të studimeve. Në përputhje dhe me objektivat e programit të studimit DND në Shkenca Politike lëndët e ofruara mundësojnë një ndërthurje të mirë të dijeve teorike me ato praktike. Kështu të gjithë studentët e këtij programi marrin fillimisht lëndët e detyrueshme për të gjithë në kategoritë A dhe B1 të cilat shërbejnë për dhënien e një baze të mirë konceptuale, me anë të së cilës mund të kuptohen më mirë qasjet aplikative të ofruara në lëndët e kategorive të tjera. Dy profilet e këtij programi studimi më pas fokusohen në lëndë specifike që lidhen më në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilet e zgjedhura. Kështu në profilin *Politikë e Krahasuar* me lëndën Teori dhe Modele Zhvillimi studentët përqendrohen në dimensionin institucional dhe aplikativ të procesit politik. Nëpërmjet lëndëve Politika e Jashtme e Krahasuar dhe Qeverisja dhe Demokracia Lokale e Krahasuar studentët aftësohen në njohjen dhe vlerësimin e thelluar të sistemeve të ndryshme të qeverisjes, të politikës së jashtme si dhe të institucioneve të ndryshme politiko-administrative. Ndërsa në profilin *Teoritë Politike* nëpërmjet lëndës Teoritë Politike Bashkëkohore përqendrohen më shumë në dimensionin teorik të procesit politik dhe të shkencave politike në përgjithësi. Ndërkohë nëpërmjet lëndëve Ideologjitë dhe Lëvizjet e Rreja Politike dhe Sociologji Politike studentët aftësohen në analizën e ideologjive të ndryshme politike dhe të sistemeve të ndryshme demokratike.

DND SHKENCA POLITIKE

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË) 10% / 12 ECTS/ 1 lëndë

Nr.	Viti	SHKENCA POLITIKE	ECTS
1	I	Metoda kërkimi të avancuara & Statistikë sociale	12

B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT 40% /48 ECTS/8 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	Viti	SHKENCA POLITIKE	ECTS
1	I	Debate bashkëkohore	6
2		Politika dhe sistemet e qeverisjes të krahasuara	6
3		Filozofi politike	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Nr.	Viti	Politikë e krahasuar	Teoritë politike	ECTS
1	I	Teori dhe modele zhvillimi	Ideologjitë dhe lëvizjet e reja politike	6
2		Qeverisja dhe demokracia lokale e krahasuar	Sociologji politike	6
3	II	Politika e jashtme e krahasuar	Teoritë politike bashkëkohore	6

III -LËNDË OPSIONALE TË PËRBASHKËTA / 2 lëndë

Nr.	Viti	SHKENCA POLITIKE	ECTS
1	II	MP politike	6
2		Teorite e nacionalizmit	6
3		Të drejtat e njeriut (jurisprudenca & debati bashkëkohor)	6
4		Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE 10% /12 ECTS/ 2 lëndë

1	I	Konceptim dhe menaxhim fushatash	6
2		Marrëdhëniet transatlantike	6
3		Antropologji social-kulturore dhe politike	6
4	II	Europianizimi dhe përshtatja e të drejtave kombëtare	6
5		Analizë e teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare	6
6		Politikat e identitetit	6

D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA 7-8% /6 ECTS/ 1 lëndë

1	II	Teknikat e advokimit dhe lobimit	6
2		Menaxhim dhe vlerësim projektesh	6
3		Praktikum i marrëdhënieve publike	6
4		Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

1	II	Praktikë / internship	12
---	----	-----------------------	----

F - PUNIMI I DIPLOMËS 10-25%/ 30 ECTS

1	II	Punimi i diplomës	30
---	----	-------------------	----

Gjithashtu si pjesë e veprimtarive mësimore gjatë zhvillimit të programit është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet

përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës në vitin e dytë.

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezultojnë se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 15, prej të cilëve 3 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 10. Këto shifra rezultojnë në afërsisht 1 pedagog për 0.7 student të regjistruar, ose një pedagog i brendshëm për 0.83 studentë të regjistruar. Për sa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 8.4, duke paraqitur kështu një nivel relativisht të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit DND Shkenca Politike është një staf mjaft i kualifikuar i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (2 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. 9 me gradën Doktor). Në program janë angazhuar vetëm 3 asistentë që nuk e plotësojnë këtë kriter, 2 prej të cilëve me master dhe tjetri në përfundim të studimeve të doktoratës, por gjithmonë nën mbikëqyrjen e pedagogëve me grada e tituj.

Programi i studimit në Marrëdhënie Ndërkombëtare

Ky program synon formimin kulturor dhe profesional të specialistëve në fushën e marrëdhënieve dhe të politikës ndërkombëtare përmes studimit intensiv të teorive kryesore mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe njohjes me zhvillimet më të rëndësishme politike, diplomatike dhe ekonomike në marrëdhëniet midis shteteve në plan global dhe rajonal, apo në kuadër të organizatave ndërkombëtare, si edhe përmes analizës së faktorëve gjeopolitikë dhe gjeoekonomikë, të cilët do të përcaktojnë fatet e shekullit të 21-të në kushtet e një shoqërie njerëzore gjithnjë e më të globalizuar.

Studentët do të marrin njohuri dhe do të fitojnë kompetencë teorike dhe profesionale për një varg çështjesh të rëndësishme të politikës globale dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në kohën tonë, siç janë: gjeoekonomia dhe gjeopolitika e shekullit të 21-të, marrëdhëniet transatlantike, politika e jashtme e Shteteve të Bashkuara, integrimi dhe zgjerimi i Bashkimit Europian, proceset globalizuese dhe efektet politike, ekonomike dhe sociale të tyre, dalja në skenën botërore e fuqive të reja të mëdha si Kina, India, Rusia dhe Brazili dhe implikimet e kësaj dukurie në politikën ndërkombëtare, roli i organizatave dhe i institucioneve ndërkombëtare në kohën tonë si edhe politika e jashtme e Shqipërisë në rrethanat e sotme në kontekst rajonal dhe më gjerë. Në bazë të këtyre njohurive ky program ofron mundësinë e profilizimit në dy drejtime: Organizatat Ndërkombëtare dhe Studimet Strategjike.

Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të tretë të studimeve. Në përputhje dhe me objektivat e programit të studimit DND në Marrëdhënie Ndërkombëtare lëndët e ofruara mundësojnë një ndërthurje të mirë të dijeve teorike me ato praktike. Kështu të gjithë studentët e këtij programi marrin fillimisht lëndët e detyrueshme për të gjithë në kategoritë A dhe B të cilat shërbejnë për dhënie të një baze të mirë konceptuale, me anë të së cilës mund të kuptohen më mirë qasjet aplikative të ofruara në lëndët e kategorive të tjera. Dy profilet e këtij programi studimi më pas fokusohen në lëndë specifike që lidhen më në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilet e zgjedhura. Kështu në profilin *Organizatave Ndërkombëtare* me lëndët Organizatat dhe Institucionet Ndërkombëtare dhe Gjakatat Ndërkombëtare studentët marrin njohuri rreth rolit të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare në kohën tonë në çështje të ndryshme me ndikim në arenën ndërkombëtare. Ndërkohë nëpërmjet lëndës Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së studentët fitojnë kompetencë teorike dhe profesionale për një varg çështjesh të rëndësishme që lidhen me procesin e integritit dhe zgjerimit të bashkimit Europian. Ndërsa në profilin *Studime Strategjike* nëpërmjet lëndëve si Analizë strategjike dhe Marrëdhëniet transatlantike studentët fitojnë njohuri të thelluara për një varg çështjesh të rëndësishme të politikës globale dhe të

DND MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË) 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

Nr.	Viti	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	ECTS
1	I	Metoda kërkimi të avancuara & Statistikë sociale	12

B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT 40% / 48 ECTS /8 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	Viti	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	ECTS
1	I	Debate bashkëkohore	6
2		Analizë e teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare	6
3		Politika e jashtme e krahasuar	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Nr.	Viti	ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE	STUDIME STRATEGJIKE	ECTS
1	I	Organizatrat dhe institucionet ndërkombëtare	Çështje të sigurisë ndërkombëtare	6
2		Gjykatat ndërkombëtare	Analizë strategjike	6
3	II	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	Marrëdhëniet transatlantike	6

III -LËNDË OPSIONALE TË PËRBASHKËTA / 2 lëndë

Nr.	Viti	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	ECTS
1	II	Teoritë e nacionalizmit	6
2		Analiza e politikës së jashtme të SHBA-së	6
3		E drejta diplomatike dhe protokoli diplomatik	6
4		Teknika të negociimit ndërkombëtar	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE 10% / 12 ECTS / 2 lëndë

1	I	Historia moderne dhe bashkëkohore e Ballkanit	6
2		Teori zhvillimi dhe politika ekonomike	6
3		Gjeopolitika aktuale e Ballkanit	6
4	II	Të drejtat e njeriut (jurisprudenca & debati bashkëkohor)	6
5		Politika dhe shoqëria në SHBA	6
6		Europeanizimi dhe përshtatja e të drejtave kombëtare	6

D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA 7-8% 6 ECTS / 1 lëndë

1	II	Antropologji social-kulturore dhe politike	6
2		Praktikum i marrëdhënieve publike	6
3		Menaxhim dhe vlerësim projektesh	6
4		E drejta e migracionit dhe refugjatit	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

1	II	Praktikë / internship	12
---	----	-----------------------	----

F - PUNIMI I DIPLOMËS 10-25% /30 ECTS

1	II	Punimi i diplomës	30
---	----	-------------------	----

marrëdhënieve ndërkombëtare në kohën tonë, siç janë gjeoekonomia dhe gjeopolitika e shekullit të 21-të, proceset globalizuese dhe efektet politike, ekonomike dhe sociale të tyre, dalja në skenën botërore e fuqive të reja të mëdha si Kina, India, Rusia dhe Brazili dhe implikimet e kësaj dukurie në politikën ndërkombëtare. Ndërkohë nëpërmjet lëndës Çështje të sigurisë ndërkombëtare studentët thellojnë njohuritë rreth marrëdhëniet transatlantike dhe rolit të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në ruajtjen e rendit global. Gjithashtu si pjesë e veprimtarive mësimore gjatë zhvillimit të programit është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës në vitin e dytë.

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezultojnë se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 16, prej të cilëve 4 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 16. Këto shifra rezultojnë në afërsisht 1 pedagog për 1 student të regjistruar, ose një pedagog i brendshëm për 1.3 studentë të regjistruar. Për sa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 8.4, duke paraqitur kështu një nivel relativisht të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është mjaft i kualifikuar i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (4 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 8 me gradën Doktor). Në program janë angazhuar vetëm 3 asistentë me Master, por nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e pedagogëve me grada e tituj.


Programet e studimit Master i Nivelit të Dytë

Fakulteti i Shkencave Sociale, në vitin akademik 2009-2010 ka ofruar 4 programe studimi Master i Nivelit të Dytë, si më poshtë:

1. SOCIOLOGJI, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. Politika, shoqëria dhe demokratizimi
 - b. Kriminalogji
 - c. Globalizimi dhe zhvillimi
 - d. Komunikimi dhe sjelljet politike
2. SHKENCA KOMUNIKIMI, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. Komunikimi dhe sjelljet politike
 - b. Komunikimi në biznes
 - c. Liderhipi dhe menaxhimi i karrierës
 - d. Teori dhe modele komunikimi
3. SHKENCA POLITIKE, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. Globalizimi dhe zhvillimi
 - b. Politika, shoqëria dhe demokratizimi
 - c. Administrata dhe politikat publike
 - d. Komunikimi dhe sjelljet politike
4. MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. Globalizimi dhe zhvillimi
 - b. Studime të sigurisë dhe të gjeopolitikës
 - c. Politika, shoqëria dhe demokratizimi
 - d. E drejtë europiane dhe ndërkombëtare.


Ndonëse ky Fakultet ofron numrin më të madh të programeve në këtë cikël studimesh, për nga numri i studentëve të regjistruar qëndron pas dy Fakulteteve të tjera, me një total prej 143 studentësh, të cilët

përbëjnë 21% të të gjithë studentëve të regjistruar në programet MND në nivel universiteti. Nota mesatare në hyrje e studentëve është 8.1.



Masteri në Shkenca Komunikimi, ka rezultuar më i preferuari. Jo vetëm, por edhe shpërndarja sipas profileve ka qenë e barabartë, duke mundësuar krijimin e klasave optimale. Masteri në Shkenca Politike ka shfaqur disa anomali nga pikëpamja e shpërndarjes sipas profileve. Profili Komunikim dhe Sjelljet Politike dhe Globalizimi dhe Zhvillimi kanë patur një numër minimal studentësh. Të dy këto profile janë aktivizuar vetëm falë faktit që ofrohen në programe të tjera. E njëjta gjë vlen edhe për Masterin në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Dy profilet që janë konsideruar si kryekëput të fushës së kësaj disipline, janë përzgjedhur nga shumica e studentëve, pra E drejtë europiane dhe ndërkombëtare dhe Studime të Sigurisë dhe Gjeopolitikës. Është interesante për t'u theksuar se studentët e profilit të së drejtës europiane dhe ndërkombëtare, kanë një formim akademik që nuk lidhet me fushën juridike. Masteri në Sociologji ishte i vetmi program që fillimisht pati probleme me numrin e kërkesave, aq sa u mendua që nuk do të aktivizohej këtë vit. Nga profilet e këtij programi u zgjodhën vetëm dy, me natyrë kryekëput sociologjike.

Mësimdhënia në këto programe është mbuluar kryesisht me staf të brendshëm akademik, të cilët përbëjnë 72% të totalit të stafit të angazhuar. Grafiku i mëposhtëm jep të dhëna të hollësishme për shpërndarjen e këtij stafi sipas gradave dhe titujve. Vihet re se 80% e stafit të angazhuar është me grada e tituj. Në programe janë angazhuar si asistentë 5 pedagogë me Master, nga të cilët 3 në proces doktore, nën drejtimin e pedagogëve me grada e tituj.



Raporti staf akademik – studentë në nivel Fakulteti është 1 pedagog për 5.7 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 7.9 studentë.

Programi i studimit në Shkenca politike

Ky master synon të përforcojë përgatitjen e studentëve në identifikimin dhe analizimin e problematikës themelore bashkëkohore të shkencave politike në nivelin teorik dhe praktik. Masteri ofrohet për studentë të nivelit të përparuar që zotërojnë një Diplomë të Nivelit të Dytë në të njëjtën fushë ose në fusha të përafërta sipas parashikimeve ligjore. Programet e mëposhtëm të Masterit të Nivelit të Dytë zhvillojnë bagazhin profesional të studentit duke i mundësuar të zgjerojë horizontin teorik dhe konceptual si dhe duke thelluar analizën e dukurive kryesore të konstatuara nga kërkimet bashkëkohore në shkencat politike në fushat përkatëse. Ato i mundësojnë studentit të identifikojë jo vetëm problemet, por edhe të identifikojë përgjigje të mundshme ndaj tyre. Objektivat e këtij programi studimi veçohen më tej sipas profileve të mëposhtme:

Globalizimi dhe zhvillimi: Ky profil fokusohet në studimin e thelluar të teorive të zhvillimit ekonomik, social e kulturor dhe të problemeve të lidhura me modernizimin e shoqërisë në shkallë globale e rajonale. Ai ofron një këndvështrim ndërdisiplinor mbi dukuri e procese që kanë të bëjnë me tendenca të përgjithshme të zhvillimit shoqëror, si për shembull, zhvillimet demografike, tranzicionet në mënyrën e organizimit ekonomik dhe politik të shoqërisë, industrializimi, urbanizimi, racionalizimi dhe burokratizimi i mëtejshëm i shoqërisë, etj. Rëndësi e veçantë u kushtohet problemeve që lidhen me zhvillimin e teknologjive të reja të informacionit dhe globalizimin e shoqërisë së sotme dhe efektet e këtij procesi në nivel makro- dhe mikrosocial.

Politika, shoqëria, demokratizimi: Ky profil fokusohet në veçimin, studimin dhe analizimin e problemeve themelore të tranzicionit post-totalitar në vende të ndryshme, me një fokus të veçantë për rastin e Shqipërisë. Ai synon të aftësojë studentin në analizimin e rolit të faktorëve të ndryshëm të përfshirë në studimin e ecurisë së këtij tranzicioni: elitat, kultura politike, dizajni institucional dhe strategjitë politike.

Administrata dhe politikat publike: Ky profil synon të aftësojë studentin në studimin e thelluar të funksionimit të administratës publike si dhe në analizimin e mundësive, modeleve dhe efekteve të politikave të ndryshme publike në fushat kryesore. Ai synon gjithashtu të aftësojë studentin në analizimin e problemeve të administratës publike shqiptare dhe identifikimin e zgjidhjeve të përshtatshme për to.

Komunikimi politik dhe sjelljet politike: Ky profil synon studimin e modeleve kryesore të komunikimit politik, strategjive të aktorëve të ndryshëm si dhe sjelljeve politike të qytetarit në nivel individual dhe grupor. Entitetet në fokus do jenë: partitë politike, qeveria dhe administrata publike, organizata të shoqërisë civile, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, grupet e interesit si dhe votuesit. Një theks i veçantë do t'i kushtohet studimit të funksionimit, strukturimit dhe organizimit të fushatave elektorale.

Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve doktorale. Në përputhje dhe me objektivat e programit të studimit MND në Shkenca Politike lëndët e ofruara mundësojnë një ndërthurje të mirë të dijeve teorike me ato praktike. Në kuadrin e specializimit në *Komunikim politik dhe sjellje politike* studentët do të njihen dhe do të analizojnë modelat kryesore të komunikimit politik, strategjitë e aktorëve të ndryshëm si dhe sjelljet politike të qytetarit në nivel individual dhe grupor. Entitetet në fokus do jenë: partitë politike, qeveria dhe administrata publike, organizata të shoqërisë civile, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, grupet e interesit si dhe votuesit. Një theks i veçantë do t'i kushtohet studimit të funksionimit, strukturimit dhe organizimit të fushatave elektorale.

Në kuadrin e specializimit “Globalizim dhe Zhvillim” studentët do të thellohen në proceset integruese dhe të zhvillimit në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Në veçanti do të diskutohen çështje të ekonomisë dhe integritit global, rolit të organizatave ndërkombëtare-kryesisht ato të Bretton Woods dhe regjimeve, çështjet e borxhit të jashtëm dhe ndihmës së huaj në funksion të zhdukjes së marginalizimit të rajoneve dhe komuniteteve. Në të dy specializimet studentët do të angazhohen në studimet tradicionale dhe ato të kërkimit më të avancuar bashkëkohor. Këto profile bëhen pjesë e një programi universitar në Shqipëri për herë të parë.

Nr.	M2 / SHKENCA POLITIKE				ECTS
1	Metoda kërkimi (1)				6
2	Metoda kërkimi në shkencat sociale				6
3	Teori bashkëkohore sociale dhe politike				6
4	Debate bashkëkohore në shkencat politike				6
PROFILI	Aplikativ	Aplikativ/Kërkimor	Aplikativ	Kërkimor	ECTS
	GLOBALIZIMI DHE ZHVILLIMI*	POLITIKA, SHOQËRIA DHE DEMOKRATIZIMI	ADMINISTRATA DHE POLITIKAT PUBLIKE	KOMUNIKIMI DHE SJELLJET POLITIKE	
5	Regjimet dhe institucionet ndërkombëtare	Sociologji politike e demokratizimit	Institucionet e administratës publike të krahasuara	Sociologji politike e demokratizimit	6
6	Modernizimi, zhvillimi dhe globalizimi	Teoritë e demokratizimit dhe probleme të tranzicionit	Politikat publike dhe risku publik	Teori dhe strategji të komunikimit politik	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

Profili *Politika, shoqëria, demokratizimi* fokusohet në veçimin, studimin dhe analizimin e problemeve themelore të tranzicionit post-totalitar në vende të ndryshme, me një fokus të veçantë për rastin e Shqipërisë. Ai synon të aftësojë studentin në analizimin e rolit të faktorëve të ndryshëm të përfshirë në studimin e ecursisë së këtij tranzicioni: elitat, kultura politike, dizajni institucional dhe strategjitë politike.

Ata që do të zgjedhin profilin *Administrata dhe politikat publike* do të aftësohen në studimin e thelluar të funksionimit të administratës publike si dhe në analizimin e mundësive, modeleve dhe efekteve të politikave të ndryshme publike në fushat kryesore. Ai synon gjithashtu të aftësojë studentin në analizimin e problemeve të administratës publike shqiptare dhe identifikimin e zgjidhjeve të përshtatshme për to.

Gjithashtu si pjesë e veprimtarive mësimore gjatë zhvillimit të programit është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës.

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezulton se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 11, prej të cilëve 3 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 35, pra 1 pedagog për 3.2 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 4.4 studentë. Për sa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 8.08, duke paraqitur kështu një nivel të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është një staf mjaft i kualifikuar i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (2 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc., 6 me gradën Doktor). Në program është angazhuar vetëm një asistent me Master nën drejtimin e një profesori.

Programi i studimit Shkenca Komunikimi

Ky master synon të aftësojë studentët në studimin e thelluar të teorive dhe modeleve bashkëkohore të komunikimit, të ndara sipas disa prej fushave kryesore të zbatimit të tyre në politikë, shoqërinë civile, biznes, etj. Masteri synon gjithashtu të përgatisë ekspertë komunikimi të aftë për t'u angazhuar në menaxhimin e marrëdhënieve publike në sektorë të ndryshëm. Programet e MND-së të përshkruara më poshtë do të ofrojnë kompetenca të thelluara profesionale. Ato janë fokusuar në ato fusha që kërkojnë specialistë të komunikimit të aftë për të nxitur komunikimin efikas të palëve të ndryshme në politikë, biznes dhe shoqëri civile. Në këtë master theks i veçantë i vihet forcimit të aftësive konkrete profesionale përmes studimit të strategjive bashkëkohore si dhe modeleve më të suksesshme të komunikimit publik. Objektivat e këtij programi studimi veçohen më tej sipas profileve të mëposhtme:

Komunikimi dhe sjelljet politike: Ky profil synon studimin e modeleve kryesore të komunikimit politik, strategjive të aktorëve të ndryshëm si dhe sjelljeve politike të qytetarit në nivel individual dhe grupor. Entitetet në fokus do jenë: partitë politike, qeveria dhe administrata publike, organizata të shoqërisë civile, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, grupet e interesit si dhe votuesit. Një theks i veçantë do t'i kushtohet studimit të funksionimit, strukturimit dhe organizimit të fushatave elektorale.

Komunikimi në biznes : Synon formimin e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë me njohuri të plota në aspektet teorike edhe veçanërisht në aftësitë praktike aplikative në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun në aktivitetin e bizneseve të vogla, të mesme e të mëdha në të gjithë sektorët e ekonomisë; njësive të ndryshme të shërbimit si agjenci turizmi e transporti, institucioneve arsimore e shëndetësore, struktura të medias së shkruar e asaj televizive; menaxhimit dhe analizës së politikave publike të institucioneve publike qendrore e lokale, OJF-ve, etj.

Lidershipi dhe menaxhimi i karrierës: Synon kompletimin e njohurive në lidhje me teoritë dhe praktikat e lidshme të komunikimit dhe menaxhimit të tij; menaxhimin e burimeve njerëzore, analizës dhe menaxhimit të karrierës, njohjes së plotë të legjislacionit të punës dhe sjelljes organizative, përvetësimin e elementeve themelore të komunikimit në biznes dhe marrëdhënieve publike për të gjitha llojet e biznesit dhe korporatat; elementët themelore të së drejtës ekonomike, etj.

Teori dhe modele komunikimi: Ky drejtim synon thellimin e studimeve në teoritë dhe modelet e ndryshme të komunikimit, përmes një këndvështrimi të integruar të tyre, duke u ndalur më në veçanti tek dallimet mes komunikimit njerëzor/masiv, qasjet e ndryshme të teorive të integrimit dhe studimeve në fusha të ndryshme të komunikimit. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet mediave të reja, duke ofruar një kuptim multidimensional të pushtetit të tyre, në veçanti në kuadër të informacionit dhe çështjeve publike.

Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve doktorale. Në përputhje dhe me objektivat e programit të studimit MND në Shkenca Komunikimi lëndët e ofruara mundësojnë një ndërthurje të mirë të dijeve teorike me ato praktike. Në kuadrin e specializimit në *Komunikimin në biznes* studentët do të aftësohen dhe formohen si ekspertë dhe specialistë cilësorë me njohuri të plota në aspektet teorike edhe veçanërisht në aftësitë praktike aplikative në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun në aktivitetin e bizneseve të vogla, të mesme e të mëdha në të gjithë sektorët e ekonomisë; njësive të ndryshme të shërbimit si agjenci turizmi e transporti, institucioneve arsimore e shëndetësore, struktura të medias së shkruar e asaj televizive; menaxhimit dhe analizës së politikave publike të institucioneve publike qendrore e lokale, OJF-ve, etj.

Studentët që do të zgjedhin profilin e *Lidershipit dhe menaxhimi i karrierës* do të kompletojnë njohuritë tyre në lidhje me teoritë dhe praktikën e lidërsipit dhe menaxhimit të tij; menaxhimit të burimeve njerëzore, analizës dhe menaxhimit të karrierës, njohjes së plotë të legjislacionit të punës dhe sjelljes organizative, përvetësimin e elementeve themelore të komunikimit në biznes dhe marrëdhënieve publike për të gjitha llojet e biznesit dhe korporatat; elementët themelorë të së drejtës ekonomike, etj.

Ata që do të zgjedhin profilin *Komunikimi dhe sjelljet politike* do të aftësohen në studimin e modeleve kryesore të komunikimit politik, strategjive të aktorëve të ndryshëm si dhe sjelljeve politike të qytetarit në nivel individual dhe grupor. Entitetet në fokus do jenë: partitë politike, qeveria dhe administrata publike, organizata të shoqërisë civile, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, grupet e interesit si dhe votuesit. Një theks i veçantë do t'i kushtohet studimit të funksionimit, strukturimit dhe organizimit të fushatave elektorale.

Nr.	M2 / SHKENCA KOMUNIKIMI				ECTS
1	Metoda kërkimi (1)				6
2	Metoda kërkimi në shkencat sociale				6
3	Teori bashkëkohore të komunikimit				6
4	Çështje bashkëkohore në shkencat e komunikimit				6
PROFILI	Kërkimor	Aplikativ	Aplikativ	Kërkimor	ECTS
	KOMUNIKIMI DHE SJELLJET POLITIKE	KOMUNIKIMI NË BIZNES	LIDERSHIPI DHE MENAXHIMI I KARRIERËS*	TEORI DHE MODELE KOMUNIKIMI	
5	Sociologji politike e demokratizimit	Praktikum i komunikimit në biznes	Teoritë e lidërsipit	Sociolinguistikë	6
6	Teori dhe strategji të komunikimit politik	Marrëdhënie publike për korporatat (raste studimore)	Modele të menaxhimit të karrierës	Mediat e reja, teknologjitë e komunikimit dhe konsumatori	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

Për ata studentë që do të zgjedhin profilin e *Teorive dhe modele komunikimi*, ky drejtim synon thellimin e studimeve në teoritë dhe modelet e ndryshme të komunikimit, përmes një këndvështrimi të integruar të tyre, duke u ndalur më në veçanti tek dallimet mes komunikimit njerëzor/masiv, qasjet e ndryshme të teorisë të integritetit dhe studimeve në fusha të ndryshme të komunikimit. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet mediave të reja, duke ofruar një kuptim multidimensional të pushtetit të tyre, në veçanti në kuadër të informacionit dhe çështjeve publike.

Gjithashtu si pjesë e veprimtarive mësimore gjatë zhvillimit të programit është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës.

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezultojnë se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 14, prej të cilëve 4 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 73, pra 1 pedagog për 5.2 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 7.3 studentë. Përsa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 8.2, duke paraqitur kështu një nivel relativisht të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është mjaft i kualifikuar i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 8 me gradën Doktor). Në program janë angazhuar si asistentë 4 pedagogë me Master, nga të cilët 3 në proces të studimeve të doktoratës, nën drejtimin e pedagogëve me grada e tituj.

Programi i studimit në Sociologji

Ky program Master synon të përgatisë sociologë me një formim të thelluar dhe të avancuar në teoritë sociologjike dhe me aftësitë e nevojshme për të njohur e përdorur metodat statistikore bashkëkohore të hulumtimit sociologjik në tre profile kryesore: (1) Politika, shoqëria dhe demokratizimi; (2) Kriminologji; (3) Globalizimi dhe zhvillimi; (4) Komunikimi dhe sjelljet politike. Programi do të fokusohet në disiplina dhe fusha të tilla si: sociologjia politike dhe problemet e tranzicionit e të konsolidimit demokratik, sociologjia urbane, problemet e zhvillimit ekonomik, social e kulturor, sociologjia e sjelljes deviante dhe e krimit, sociologjia e globalizimit, etj. Synimi është që studentët të kualifikohen në dy role kryesorë: (a) në rolin akademik, si studiues të dukurive dhe problemeve shoqërore dhe (b) në rolin e praktikuesit të dijes sociologjike, pra në fushën e sociologjisë së aplikuar.

PROFILI: Politika, Shoqëria, Demokratizimi: Ky profil fokusohet në veçimin, studimin dhe analizimin e problemeve themelore të tranzicionit post-totalitar në vende të ndryshme, me një fokus të vecantë për rastin e Shqipërisë. Ai synon të aftësojë studentin në analizimin e rolit të faktorëve të ndryshëm të përfshirë në studimin e ecurisë së këtij tranzicioni: elitat, kultura politike, dizajni institucional dhe strategjitë politike.

PROFILI: Kriminologji: Ky profil fokusohet në studimin e thelluar të faktorëve ekonomikë, socialë, kulturorë dhe politikë që prodhojnë sjellje devijante dhe kriminale në shoqëri si edhe në mundësitë e parandalimit dhe luftës efektive ndaj tyre. Studimi në këtë fushë është i një rëndësie të veçantë për një rreth të gjerë njerëzish që kanë si sferë të angazhimit të tyre akademik ose profesional problemet e politikave publike, të ruajtjes së rendit, punën sociale, punën me rininë apo grupe të tjera shoqërore, proceset e zhvillimit urban, veprimtarinë kërkimore në këto sfera, etj. Kurrikulum i programit Master në këtë profil mundëson marrjen e njohurive të thelluara bashkëkohore ndërdisiplinore në fusha të tilla si sociologjia e sjelljes deviante, kriminologjia dhe çështje të së drejtësisë penale, antropologjia, psikologjia sociale, problemet sociale. Synimi i këtij programi është që të përgatisë studiues dhe punonjës të kualifikuar me njohuri dhe ekspertizë, të cilat mungojnë në institucionet e administratës publike, në institucionet që merren me veprimtari studimore në fushën e problemeve sociale dhe ato të ruajtjes së rendit.

Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve doktorale. Në përputhje dhe me objektivat e programit të studimit MND në Sociologji lëndët e ofruara mundësojnë një ndërthurje të mirë të dijeve teorike me ato praktike. Në kuadrin e specializimit në *Kriminologji* studentët do të fokusohen në studimin e thelluar të faktorëve ekonomikë, socialë, kulturorë dhe politikë që prodhojnë sjellje deviante dhe kriminale në shoqëri si edhe në mundësitë e parandalimit dhe luftës efektive ndaj tyre. Studimi në këtë fushë është i një rëndësie të veçantë për një rreth të gjerë njerëzish që kanë si sferë të angazhimit të tyre akademik ose profesional problemet e politikave publike, të ruajtjes së rendit, punën sociale, punën me rininë apo grupe të tjera shoqërore, proceset e zhvillimit urban, veprimtarinë kërkimore në këto sfera, etj. Kurrikulum i programit Master në këtë profil mundëson marrjen e njohurive të thelluara bashkëkohore ndërdisiplinore në fusha të tilla si sociologjia e sjelljes deviante, kriminologjia dhe çështje të së drejtësisë penale, antropologjia, psikologjia sociale, problemet sociale. Synimi i këtij programi është që të përgatisë studiues dhe punonjës të kualifikuar me njohuri dhe ekspertizë, të cilat mungojnë në institucionet e administratës publike, në institucionet që merren me veprimtari studimore në fushën e problemeve sociale dhe ato të ruajtjes së rendit.

Në kuadrin e specializimit "*Globalizim dhe Zhvillim*" studentët do të thellohen në proceset integruese dhe të zhvillimit në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Në veçanti do të diskutohen çështje të ekonomisë dhe integritit global, rolit të organizatave ndërkombëtare-kryesisht ato të Bretton Woods dhe regjimeve, çështjet e borxhit të jashtëm dhe ndihmës së huaj në funksion të zhdukjes së marginalizimit të rajoneve

dhe komuniteteve. Në të dy specializimet studentët do të angazhohen në studimet tradicionale dhe ato të kërkimit më të avancuar bashkëkohor. Këto profile bëhen pjesë e një programi universitar në Shqipëri për herë të parë.

Profili *Politika, shoqëria, demokratizimi* fokusohet në veçimin, studimin dhe analizimin e problemeve themelore të tranzicionit post-totalitar në vende të ndryshme, me një fokus të veçantë për rastin e Shqipërisë. Ai synon të aftësojë studentin në analizimin e rolit të faktorëve të ndryshëm të përfshirë në studimin e ecursisë së këtij tranzicioni: elitat, kultura politike, dizajni institucional dhe strategjitë politike.

Nr.	M2 / SOCIOLOGJI				ECTS
1	Metoda kërkimi (1)				6
2	Metoda kërkimi në shkencat sociale				6
3	Teori bashkëkohore sociale dhe politike				6
4	Debate bashkëkohore në sociologji				6
PROFILI	Aplikativ/Kërkimor	Kërkimor	Aplikativ	Kërkimor	ECTS
	POLITIKA, SHOQËRIA DHE DEMOKRATIZIMI*	KRIMINALOGJI	GLOBALIZIMI DHE ZHVILLIMI	KOMUNIKIMI DHE SJELLJET POLITIKE	
5	Sociologji politike e demokratizimit	Sociologji e sjelljes deviante dhe krimi	Regjimet dhe institucionet ndërkombëtare	Sociologji politike e demokratizimit	6
6	Teoritë e demokratizimit dhe probleme të tranzicionit	Antropologji juridike	Modernizimi, zhvillimi dhe globalizimi	Teori dhe strategji të komunikimit politik	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

Ata që do të zgjedhin profilin *Komunikimi dhe sjelljet politike* do të aftësohen në studimin e modeleve kryesore të komunikimit politik, strategjive të aktorëve të ndryshëm si dhe sjelljeve politike të qytetarit në nivel individual dhe grupor. Entitetet në fokus do jenë: partitë politike, qeveria dhe administrata publike, organizata të shoqërisë civile, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, grupet e interesit si dhe votuesit. Një theks i veçantë do t'i kushtohet studimit të funksionimit, strukturimit dhe organizimit të fushatave elektorale.

Gjithashtu si pjesë e veprimtarive mësimore gjatë zhvillimit të programit është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës.

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel mjaft të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezultojnë se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 11, prej të cilëve 3 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 11, pra 1 pedagog për 1 student, ose 1 pedagog i brendshëm për 1.4 studentë. Për sa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 8.11, duke paraqitur kështu një nivel relativisht të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është mjaft i kualifikuar i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (2 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc., 5 me gradën Doktor). Në program janë angazhuar 2 asistentë me Master, nën drejtimin e pedagogëve me grada e tituj.

Programi i studimit në Marrëdhënie Ndërkombëtare

Ky program synon formimin akademik dhe profesional të specialistëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë tradicionale dhe asaj publike. Kjo do të arrihet përmes një formimi

metodologjike të thelluar që do t'i pajisë studentët me instrumentet, metodat dhe modelet e nevojshme për një studim të thelluar akademik, shkencor dhe profesional në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe thellimit në teoritë dhe debatet bashkëkohore të disiplinës në përgjithësi dhe për çështje të caktuara në veçanti. Studentët do të kenë mundësinë të specializohen në dy profile të veçanta për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe globalizimin e zhvillimit. Profilet do të quhen përkatësisht: “Studime të Sigurisë dhe Gjeopolitikës” dhe “Globalizimi dhe Zhvillimi”. Gjithashtu do të ofrohen edhe dy profile ndërdisiplinore, njëri në bashkëpunim me Fakultetin Juridik. Përkatësisht profilet janë: Politika, shoqëria dhe demokratizimi dhe E drejtë ndërkombëtare dhe evropiane. Objektivat e këtij programi studimi veçohen më tej sipas profileve të mëposhtme:

Profili Studime të Sigurisë dhe Gjeopolitikës ofron një thellim në çështjet bashkëkohore të problemeve të sigurisë si dhe implikimeve të tyre në sistemin politik ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërshtetërore në rajone të caktuara të botës. Specializimi do të synojë të zhvillojë një kuptim empirik të çështjeve të brendshme dhe të jashtme të sigurisë nëpërmjet ekzaminimit të strategjive ushtarake dhe policore.

Globalizimi dhe zhvillimi: Ky profil fokusohet në studimin e thelluar të teorive të zhvillimit ekonomik, social e kulturor dhe të problemeve të lidhura me modernizimin e shoqërisë në shkallë globale e rajonale. Ai ofron një këndvështrim ndërdisiplinor mbi dukuri e procese që kanë të bëjnë me tendenca të përgjithshme të zhvillimit shoqëror, si për shembull, zhvillimet demografike, tranzicionet në mënyrën e organizimit ekonomik dhe politik të shoqërisë, industrializimi, urbanizimi, racionalizimi dhe burokratizimi i mëtejshëm i shoqërisë, etj. Rëndësi e veçantë u kushtohet problemeve që lidhen me zhvillimin e teknologjive të reja të informacionit dhe globalizimin e shoqërisë së sotme dhe efektet e këtij procesi në nivel makro- dhe mikrosocial.

Politika, shoqëria, demokratizimi: Ky profil fokusohet në veçimin, studimin dhe analizimin e problemeve themelore të tranzicionit post-totalitar në vende të ndryshme, me një fokus të veçantë për rastin e Shqipërisë. Ai synon të aftësojë studentin në analizimin e rolit të faktorëve të ndryshëm të përfshirë në studimin e ecursisë së këtij tranzicioni: elitat, kultura politike, dizajni institucional dhe strategjitë politike.

E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare e vendos theksin në mbulimin e çështjeve të së drejtës evropiane e ndërkombëtare. Ata do të përgatiten gjithashtu për të përballuar angazhime profesionale jo vetëm në organe që mbulojnë fushën e marrëdhënieve me jashtë në administratën vendase, por edhe në struktura të ndryshme të organizatave ndërkombëtare apo të përfaqësive të tyre në vendin tonë.

Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve doktorale. Në përputhje dhe me objektivat e programit të studimit MND në Marrëdhënie Ndërkombëtare lëndët e ofruara mundësojnë një ndërthurje të mirë të dijeve teorike me ato praktike. Në kuadrin e specializimit në *Studime të Sigurisë dhe Gjeopolitikës* studentet do të thellohen në çështjet bashkëkohore të problemeve të sigurisë si dhe implikimeve të tyre në sistemin politik ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërshtetërore në rajone të caktuara të botës. Specializimi do të synojë të zhvillojë një kuptim empirik të çështjeve të brendshme dhe të jashtme të sigurisë nëpërmjet ekzaminimit të strategjive ushtarake dhe policore.

Në kuadrin e specializimit “*Globalizim dhe Zhvillim*” studentët do të thellohen në proceset integruese dhe të zhvillimit në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Në veçanti do të diskutohen çështje të ekonomisë dhe integritetit global, rolit të organizatave ndërkombëtare-kryesisht ato të Bretton Woods dhe regjimeve, çështjet e borxhit të jashtëm dhe ndihmës së huaj në funksion të zhdukjes së marginalizimit të rajoneve dhe komuniteteve. Në të dy specializimet studentët do të angazhohen në studimet tradicionale dhe ato të kërkimit më të avancuar bashkëkohor. Këto profile bëhen pjesë e një programi universitar në Shqipëri për herë të parë.

Profili *Politika, shoqëria, demokratizimi* fokusohet në veçimin, studimin dhe analizimin e problemeve themelore të tranzicionit post-totalitar në vende të ndryshme, me një fokus të veçantë për rastin e Shqipërisë. Ai synon të aftësojë studentin në analizimin e rolit të faktorëve të ndryshëm të përfshirë në studimin e ecursisë së këtij tranzicioni: elitat, kultura politike, dizajni institucional dhe strategjitë politike.

Nr.	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE				ECTS
1	Metoda kërkimi (1)				6
2	Metoda kërkimi në shkencat sociale				6
3	Teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare (kurs i avancuar)				6
4	Debatet bashkëkohore të marrëdhënieve ndërkombëtare				6
PROFILI	Aplikativ	Kërkimor	Aplikativ/Kërkimor	Aplikativ	ECTS
	GLOBALIZIMI DHE ZHVILLIMI	STUDIME TË SIGURISË DHE GJEOPOLITIKËS	POLITIKA, SHOQËRIA DHE DEMOKRATIZIMI*	E DREJTË EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE**	
5	Regjimet dhe institucionet ndërkombëtare	Debatet bashkëkohore të sigurisë dhe gjeopolitikës	Sociologji politike e demokratizimit	Zhvillime aktuale në të drejtën ndërkombëtare	6
6	Zhvillimi, modernizimi dhe globalizimi	Çështje të strategjisë ndërkombëtare	Teoritë e demokratizimit dhe probleme të tranzicionit	Zhvillime aktuale në të drejtën europiane	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

Ata që do të zgjedhin profilin *E drejtë europiane dhe ndërkombëtare* do të kenë një përgatitje dhe kualifikim të shtuar profesional në mbulimin e çështjeve të së drejtës europiane e ndërkombëtare. Ata do të përgatiten gjithashtu për të përballuar angazhime profesionale jo vetëm në organe që mbulojnë fushën e marrëdhënieve me jashtë në administratën vendase, por edhe në struktura të ndryshme të organizatave ndërkombëtare apo të përfaqësive të tyre në vendin tonë.

Gjithashtu si pjesë e veprimtarive mësimore gjatë zhvillimit të programit është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës.

Raporti i stafit akademik me studentë është në një nivel të kënaqshëm për sa i përket mundësisë që ky raport i jep cilësisë së mësimdhënies. Kështu po t'i referohemi statistikave rezulton se numri i pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimi është 10, prej të cilëve 2 janë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar në këtë program është 24, pra 1 pedagog për 2.4 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 3 studentë. Për sa i përket cilësisë së studentëve në hyrje vihet re që nota mesatare është 7.9, duke paraqitur kështu një nivel relativisht të mirë.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është mjaft i kualifikuar i përbërë nga pedagogë me grada e tituj (3 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc., 4 me gradën Doktor). Në program është angazhuar 1 asistent me Master nën drejtimin e një profesori.

Fakulteti Juridik

Programi i studimit Master i Nivelit të Parë në Drejtësi

Ky program synon t'i aftësojë studentët me nocionet dhe shprehitë, bazë teorike e praktike të profesionit të juristit të përgjithshëm, për të qenë të aftë të përballojnë detyra të zakonshme në administratën e gjykatave, prokurorive dhe institucioneve të tjera. Ky program studimi i jep mundësi studenteve që të profilizohen në tre drejtë: E drejtë administrative, E drejtë ndërkombëtare dhe E drejtë europiane. Ai është i organizuar në mënyrë të tillë që studentët të përvetësojnë, nëpërmjet aktiviteteve të larmishme formuese në auditor ose praktikës profesionale, formimin e duhur për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur.

MNP DREJTËSI

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	DREJTËSI	ECTS
1	Metoda kërkimi të avancuara	6

B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 5 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	DREJTËSI	ECTS
1	E drejta kushtetuese e krahasuar	6
2	Bazat, evolucioni i <i>acquis communautaire</i>	6
3	Të drejtat e njeriut (jurisprudenca & debati bashkëkohor)	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	E DREJTË ADMINISTRATIVE	E DREJTË NDËRKOMBËTARE	E DREJTË EUROPIANE	ECTS
1	Studime të avancuara në të drejtën administrative	Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare	E drejta private europiane	6
2	Kontrolli i ligjshmerise se aktit nga gjykatat administrative	Gjykatat ndërkombëtare	Europianizimi dhe përshtatja e të drejtave kombëtare	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	DREJTËSI	ECTS
1	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6
2	E drejta diplomatike dhe protokoli diplomatik	6
3	E drejta tatimore dhe doganore	6
4	E drejta e detit dhe e hapësirës	6
5	E drejta e pronësisë intelektuale në BE	6
6	Teknikë legjislative	6
7	Teknika të negocimit ndërkombëtar	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	8
---	-----------------------	---

F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

Në lidhje me këtë program studimi duhet thënë se kurrikula i përgjigjet plotësisht objektivave të programit pasi i ofron studenteve jo vetëm njohuri teorike, por mbi të gjitha njohuri praktike të cilat janë shumë të nevojshme për kualifikimin dhe punësimin e tyre.

Ky program studimi u hap në mars 2009 kur u regjistruan 18 studentë, me notë mesatare në hyrje 8.58 që dëshmon për një nivel të lartë cilësie. Këtë e konfirmojnë edhe rezultatet e këtyre studentëve gjatë studimeve në këtë program studimi. Kështu, niveli i kalueshmërisë është 100%, dhe nota mesatare në dalje është 9.1.

Në tetor të po këtij viti ky program nuk u arrit të aktivizohej, si rezultat i mungesës së kërkesave për regjistrim. Mendohet se rënia e interesit për këtë program ka ardhur si rezultat i hapjes së programeve Master i Nivelit të Dytë, pasi të interesuarit, duke pasur një diplomë të sistemit të vjetër 4-vjeçar, preferonin të ndiqnin një program të ciklit të tretë.

Në këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie 8 pedagogë, 2 prej të cilëve të jashtëm. Për sa i përket nivelit të tyre të kualifikimit, ai është staf me grada dhe tituj sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin mbi arsimin e lartë (3 Prof. Dr., dhe 5 me gradën Doktor). Raporti staf akademik student është në nivelin 1 pedagog për 2.2 studentë ose 1 pedagog i brendshëm për 3 studentë.


Programet e studimit Diplomë e Nivelit të Dytë

Duke nisur nga viti akademik 2009-2010, Fakulteti Juridik ofron këto programe DND:


1. E DREJTË PRIVATE DHE BIZNESI; ose e shoqëruar me një nga profilet:
 - a. E Drejtë Private
 - b. E Drejtë Biznesi
2. E DREJTË PUBLIKE DHE NDËRKOMBËTARE; me tre profile:
 - a. E drejtë publike dhe kushtetuese
 - b. E drejtë penale
 - c. E drejtë ndërkombëtare dhe evropiane.

Këto programe kanë për objektiv të formojnë juristë të specializuar, me dije të thelluara në fusha të ndryshme të së drejtës, të aftë të studiojnë dhe të përvetësojnë sa më mirë risitë juridike, analizën e doktrinë juridike dhe interpretimin e praktikës juridike (jurisprudenca). Ato japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike si dhe trajnim për kërkim të pavarur në fushën e së drejtës.

Për nga numri i studentëve të regjistruar në programet DND, ky fakultet zë vendin e dytë, me 56 studentë, ose rreth 31% të totalit të studentëve të regjistruar në nivel universiteti. Sikurse vihet re nga grafiku i mëposhtëm programi më i preferuar ka qenë ai në të Drejtë Private dhe Biznesi. Për nga cilësia e studentëve të pranuar, nota mesatare e studentëve të regjistruar është 8.3 për programin E drejtë Private dhe Biznesi dhe 7.76 për programin E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare.



Sa i takon shpërndarjes së studentëve sipas profilit të zgjedhur shohim se profili më i preferuar është ai në të Drejtë Biznesi, ndërsa më pak i preferuari profili në të Drejtë ndërkombëtare dhe europiane.



Mësimdhënia në këto programe është mbuluar kryesisht me pedagogë të brendshëm, të cilët përbëjnë rreth 74% të totalit të stafit akademik të angazhuar. Sa i përket cilësisë së këtij stafi akademik ai përbëhet nga 3 pedagogë me titullin Prof. Dr., 9 me gradën Doktor, 1 Magjistër, 5 pedagogë me Master, nga të cilët njëri në proces doktorature dhe një pedagog pa titull, por me eksperiencë të gjatë në institucionet më kryesore të sistemit gjyqësor.

Raporti pedagog-studentë është në nivelin 1 pedagog për rreth 3 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 4 studentë.

Programi i studimit E drejtë private dhe biznesi

Ky program ka për objektiv të formojë juristë të specializuar të cilët do të jenë të aftë të analizojnë, komentojnë, krahasojnë doktrinat e së drejtës civile mbarë europiane. Për këtë qëllim ofrohen lëndë të një niveli të lartë krahasimor. Ky program ofron mundësinë e thellimit të studimeve në dy profile kryesore: në të drejtën private dhe në të drejtën e biznesit. Veçanërisht në kushtet e ekonomisë së tregut shoqëria dhe ekonomia shqiptare ka nevojë për një kategori të caktuar punonjësish të pajisur me dije speciale dhe të thelluara në këto fusha. Profilizimi në këto drejtime nuk i privon të diplomuarit në këtë program studimi nga mundësia për t'u angazhuar edhe në institucione të tjera si në gjykata, në prokurori, në profesionet e lira (avokati apo noteri) si dhe në institucione të tjera qendrore e lokale, në sektorin publik ose privat.

DND E DREJTË PRIVATE DHE BIZNESI

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË) 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

Nr.	Viti	E DREJTË PRIVATE DHE E BIZNESIT	ECTS
1	I	Metoda kërkimi të avancuara & Teknikë legjislativë	12

B - DISIPLINA TE FORMIMIT KARAKTERIZUES TE PROGRAMIT 40% / 48 ECTS / 8 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	Viti	E DREJTË PRIVATE DHE E BIZNESIT	ECTS
1	I	Debate bashkëkohore	6
2		Procedurë administrative	6
3		E drejta tatimore dhe doganore	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Nr.	Viti	E drejta private	E drejta e biznesit	ECTS
1	I	E drejta civile e krahasuar	E drejta e biznesit, norma dhe praktika	6
2		E drejta private europiane	E drejta bankare dhe e sigurimeve	6
3	II	Procedurë civile e krahasuar	E drejta e falimentimit dhe arbitrazhi	6

III -LËNDË OPSIONALE TË PËRBASHKËTA / 2 lëndë

Nr.	Viti	E DREJTË PRIVATE DHE E BIZNESIT	ECTS
1	I	E drejta e pronësisë intelektuale në BE	6
2		Studime të avancuara në të drejtën administrative	6
3	II	Studime të avancuara në të drejtën e punës dhe sigurimeve	6
4		E drejta e manaxhimit të territorit	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE 10% / 12 ECTS / 2 lëndë

1	I	Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare	6
2		Europianizimi dhe përshtatja e të drejtave kombëtare	6
3		Gjykatat ndërkombëtare	6
4		Drejtësi kushtetuese	6
5	II	E drejta e migracionit dhe refugjatit	6
6		E drejta e mjedisit	6

D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TE LIRA 7-8% / 6 ECTS / 1 lëndë

1	I/II	Sociologji politike	6
2		Teknikat e advokimit dhe lobimit	6
3		Menaxhim dhe vlerësim projektsh	6
4		Praktikum i marrëdhënieve publike	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

1	II	Praktikë / internship	12
---	----	-----------------------	----

F - PUNIMI I DIPLOMËS 10-25% 12-30 C

1	II	Punimi i diplomës	30
---	----	-------------------	----

Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është kryesisht i brendshëm, në masën 69%. Sa i takon nivelit të kualifikimit, shpërndarja e pedagogëve sipas gradave dhe titujve është: 3 Prof. Dr. 8 me gradën Doktor, 1 Magjistër, dhe 4 asistentë me gradën master, të cilët janë angazhuar në mësimdhënie nën drejtimin e një pedagogu me gradë ose titull.

Raportit pedagog-student është mjaft i kënaqshëm dhe i jep cilësi mësimdhënies. Po t'i referohemi statistikave në program janë angazhuar 11 pedagogë të brendshëm dhe 5 të jashtëm. Nisur nga numri i studentëve të regjistruar, 33 të tillë, raporti pedagog-student është 1 pedagog për 2 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 3 studentë.

Programi i studimit E drejtë publike dhe ndërkombëtare

Ky program ka për objektiv të formojë juristë me njohuri të thelluara profesionale e shkencore. Programi ofron mundësinë e profilizimit në tre drejtme: E drejtë penale, E drejtë publike dhe kushtetuese, dhe E drejtë ndërkombëtare dhe europiane.

DND E DREJTË PUBLIKE DHE NDËRKOMBËTARE

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË) 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

Nr.	Viti	E DREJTË PUBLIKE DHE NDËRKOMBËTARE	ECTS
1	I	Metoda kërkimi të avancuara & Teknikë legjislative	12

B - DISIPLINA TE FORMIMIT KARAKTERIZUES TE PROGRAMIT 40% / 48 ECTS / 8 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 3 lëndë

Nr.	Viti	E DREJTË PUBLIKE DHE NDËRKOMBËTARE	ECTS
1	I	Debate bashkëkohore	6
2		Europeanizimi dhe përshtatja e të drejtave kombëtare	6
3		Studime të avancuara në të drejtën administrative	6

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Nr.	Viti	E drejta penale	E drejta publike & kushtetuese	E drejta ndërkombëtare dhe europiane	ECTS
1	I	E drejta penale e krahasuar	E drejtë publike e krahasuar	E drejta e migracionit dhe refugjatit	6
2		Procedurë penale e krahasuar	E drejta kushtetuese e krahasuar	E drejta diplomatike dhe protokolli diplomatik	6
3	II	E drejta penale ekonomike	E drejta e mjedisit	E drejta e detit dhe e hapësirës	6

III -LËNDË OPSIONALE TË PËRBASHKËTA / 2 lëndë

Nr.	Viti	E DREJTË PUBLIKE DHE NDËRKOMBËTARE	ECTS
1	I	Gjykatat ndërkombëtare	6
2		Procedurë administrative	6
3		E drejta humanitare & e luftës	6
4	II	Të drejtat e njeriut (jurisprudenca & debati bashkëkohor)	6

C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE 10% / 12 ECTS / 2 lëndë

1	I	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	6
2		Organizatrat dhe institucionet ndërkombëtare	6
3		E drejta e pronësisë intelektuale në BE	6
4	II	E drejta e manaxhimit të territorit	6
5		E drejta tatimore dhe doganore	6
6		E drejta e falimentimit dhe arbitrazhi	6

D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TE LIRA 7-8% 6 ECTS / 1 lëndë

1	I/II	Sociologji politike	6
2		Menaxhim dhe vlerësim projektesh	6
3		Praktikum i marrëdhënieve publike	6
4		Teknikat e negociimit ndërkombëtar	6

E - VEPRIMTARI FORMUESE 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

1	II	Praktikë / internship	12
---	----	-----------------------	----

F - PUNIMI I DIPLOMËS 10-25% 12-30 ECTS

1	II	Punimi i diplomës	30
---	----	-------------------	----

Veçanërisht në kushtet aktuale, të avancimit të proceseve integruese në BE dhe në struktura të tjera ndërkombëtare e rajonale, mendohet se administrata shqiptare ka nevojë për një kategori të caktuar

punonjësish të pajisur me dije të veçanta në këto fusha. Ata mund të angazhohen gjithashtu edhe në profile të tjera, si në gjykata, në prokurori, në profesionet e lira (avokati apo noteri) si dhe në institucione të tjera qendrore e lokale, në sektorin publik ose privat.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program është mjaft i kualifikuar, i përbërë nga pedagogë me tituj dhe grada (3 Prof. Dr., 6 me gradën Doktor). Pedagogët me Master, 5 të tillë (nga të cilët një në proces doktorature), janë angazhuar si asistentë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e pedagogëve me grada e tituj. Në këtë program është angazhuar edhe 1 pedagog pa gradë e titull, por me eksperiencë të gjatë profesionale në organet më të larta të sistemit gjyqësor. Për nga statusi i tyre, 67% e anëtarëve të stafit të angazhuar në këtë program përbëhet nga pedagogë të brendshëm.

Raportit pedagog-student është mjaft i kënaqshëm, në nivelin 1 pedagog për 1.5 studentë, ose një pedagog i brendshëm për 2.3 studentë, faktor që i jep cilësi mësimdhënies.


Programet e studimit Master i Nivelit të Dytë - MND

Fakulteti Juridik për vitin akademik 2009-2010 ka ofruar dy programe studimi të ciklit të tretë të studimeve:

1. E DREJTË PRIVATE, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. E drejtë ekonomike
 - b. E drejtë financiare, fiskale dhe bankare
 - c. E drejtë civile
 - d. Qeverisja e korporatave
2. E DREJTË PUBLIKE, shoqëruar edhe me profilet:
 - a. E drejtë kushtetuese dhe administrative
 - b. E drejtë europiane dhe ndërkombëtare
 - c. Kriminalogji
 - d. E drejtë penale

Këto programe synojnë zgjerimin, thellimin apo edhe plotësimin e njohurive që studentët kanë marrë në nivelet e mëparshme të studimit, si dhe aftësimin e studentëve në teknikat e kërkimit shkencor. Programet kanë karakter të thelluar si profesional ashtu edhe kërkimor-shkencor për formimin e juristëve me kualifikim, trajnim dhe njohuri profesionale të avancuara në fushën e së drejtës.

Edhe për këto programe studimi Fakulteti Juridik renditet i dyti për nga numri i studentëve të regjistruar, duke numëruar 184 studentë, me notë mesatare në hyrje 8.37, e cila përbën një nivel të kënaqshëm të cilësisë së studentëve në hyrje.



Masteri E Drejtë Private ka një shpërndarje të pabarabartë sipas profileve. Profili më i suksesshëm rezulton ai i të Drejtës Civile me pothuaj gjysmën e numrit të studentëve të regjistruar në këtë program.

Përsëritet mospërkrahja e profilit E Drejtë Ekonomike. Juristët u shprehën se profili ende nuk perceptohet i volitshëm në tregun e punës. Gjithsesi, duke u konsultuar edhe me ekspertë të ndryshëm të fushës, mendojmë që profili është interesant dhe që qasja e studentëve mund të ndryshojë në të ardhmen. Në këtë pikë, do të ndihmojë shumë edhe krijimi i një gjykate administrative në shërbim të biznesit. Kjo pritet të ndodhë së shpejti, dhe në këtë mënyrë fluksi i interesit në drejtim të këtij profili mund të rritet. Masteri E Drejtë Publike regjistroi shumë më tepër studentë. Edhe ky është një element interesant që mund të ketë disa interpretime që lidhen me kontekstin e tregut shqiptar të punës dhe orientimin e tij nga sektori publik. Edhe më domethënës është fakti që profili me numrin më të madh është E drejta Kushtetuese dhe Administrative. Natyrisht, këtu nuk mund të bëjmë dot një analizë të thellë cilësore, por nga vëzhgimet dhe komunikimet me studentët e këtij profili, rezulton se një pjesë e madhe e tyre është e orientuar drejt fushës akademike. Profili i Kriminalogjisë, i huazuar nga Masteri në Sociologji, nuk pati asnjë kërkesë nga studentët e juridikut. Duke folur me ta, kjo erdhi edhe prej faktit që ndërdisiplinariteti shihet ende si një e metë nga disa prej tyre dhe jo si një pasuri; konsiderohet si mungesë fokusi dhe pa një mundësi reale për tregun e punës.

Programi i studimit E drejtë Private

Ky program synon t'u ofrojë studentëve njohuri dhe aftësi të avancuara akademike në fushën e së drejtës private, duke ndërthurur të drejtën private shqiptare me të drejtën private europiane dhe atë ndërkombëtare. Synohet që studenti të marrë një formim të lartë shkencor, në mënyrë që t'i përgjigjet proceseve integruese që ka nisur legjislati shqiptar, dhe t'i përgjigjet sa më mirë kërkesave të tregut të punës. Ky program ofron mundësinë e profilizimit në 4 drejtime: E drejtë civile, Qeverisja e korporatave, E drejtë financiare, fiskale dhe bankare, si dhe E drejtë ekonomike.

E drejta civile: Ky profil e sheh të drejtën civile në këndvështrimin e ri që sot trajtohet gjerësisht në Europë. Studentëve synohet t'i jepen njohuri të thelluara në dy fusha, përkatësisht atë të së drejtës familjare dhe trashëgimore, duke i parë këto dy institute të së drejtës në një këndvështrim krahasues, si dhe përpjekjet e sotme të legjislatorit evropian për unifikimin e së drejtës në fushën e marrëdhënieve familjare dhe trashëgimore.

Qeverisja e korporatave: Ky profil synon formimin e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë si në aspektet teorike e kërkimore ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e teorisë financiare, menaxhimit ekonomik e financiar të korporatave, sigurimi i njohurive sa më të plota në fushën e të drejtës së korporatave si dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare në qeverisjen e korporatave në përgjithësi.

E drejta financiare, fiskale dhe bankare: Profili është parë si një ndërthurje e së drejtës shqiptare me atë europiane dhe ndërkombëtare, ku një trajtim të posaçëm do të kenë dy degë të rëndësishme të së drejtës, pikërisht e drejta financiare dhe fiskale, si dhe trajtimi i së drejtës fiskale nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, si në këndvështrimin e institucioneve të sotme ndërkombëtare, ashtu edhe të normave juridike që veprojnë sot në arenën botërore. Studentët, të cilët zgjedhin këtë profil, do të jenë të aftë të përballojnë angazhimet e ndryshme profesionale në organet shtetërore që operojnë sot në Shqipëri në fushën e financave, taksave dhe tatimeve, si dhe në sektorin bankar.

E drejta ekonomike: Në këtë profil studentëve synohet t'u jepen njohuri të thella shkencore në fushën e të drejtës së konkurrencës, konsumatorit, tregtare dhe pronësisë intelektuale si dhe në trajtimin e të drejtës private të krahasuar dhe asaj europiane. E drejta ekonomike shihet në këndvështrimin e rregullimit që bën legjislati aktual shqiptar për shoqëritë tregtare, ashtu edhe në këndvështrimin e problemeve më tipike në këtë fushë, siç janë e konkurrencës, e konsumatorit, e pronësisë intelektuale sot në BE. Këndvështrimi krahasues i së drejtës private, synon të sjellë një informacion të detajuar, për rregullimin që kjo degë e së drejtës ka në shtete të ndryshme, si dhe të shihet tendenca e sotme për

europianizimin e saj.

Nr.	MND / E DREJTË PRIVATE				ECTS
1	Metoda kërkimi 1				6
2	Metoda kërkimi në shkencat juridike				6
3	Studime të avancuara në të drejtën private				6
4	E drejta private e krahasuar dhe harmonizimi i së drejtës				6
PROFILI	Kërkimor	Kërkimor	Kërkimor	Profesional	ECTS
	E DREJTA EKONOMIKE	E DREJTË FINANCIARE, FISKALE DHE BANKARE	E DREJTA CIVILE	QEVERISJA E KORPORATAVE	
5	E drejta ndërkombëtare tregtare	Studime të avancuara në të drejtën financiare dhe fiskale	E drejta familjare e krahasuar	E drejta e korporatave	6
6	Çështje të së drejtës ekonomike	E drejta e tregjeve dhe ndërmjetësimit financiar	Zhvillime aktuale në të drejtën civile	Analiza financiare e korporatave	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga pedagogë të brendshëm në masën 55%. Ai përbëhet nga pedagogë me grada dhe tituj (2 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 4 Doktorë). Në program janë angazhuar si asistentë edhe 4 pedagogë me Master, një prej të cilëve në mbyllje të studimeve të doktoratës, dhe kjo e realizuar nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e pedagogëve me grada dhe tituj. Raporti pedagog-studentë është në nivelin 1 pedagog për 6.4 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 11.6 studentë.

Programi i studimit E drejtë Publike

Ky program synon të ofrojë specializim dhe njohuri të thelluara të studentëve në lidhje me nocionet, shprehjet dhe formimin në ciklet e mëparshme të studimit, si dhe përgatitje të avancuar të juristit, për të qenë të aftë të përballojnë nivele të kualifikuara punësimi në administratën publike, gjykatave, prokurori dhe organe të tjera të drejtësisë. Një drejtim tjetër i angazhimit të tyre mund të jetë përfshirja në sektorë të ndryshëm, ku kërkohen njohuri të posaçme për të drejtën ndërkombëtare dhe atë europiane. Veçanërisht në kushtet aktuale, të avancimit të proceseve integruese në BE dhe në struktura të tjera ndërkombëtare e rajonale, pasi administrata shqiptare ka nevojë për një kategori të caktuar punonjësish të pajisur me dije të thelluara në këto fusha. Programi ofron mundësi profilizimi në 4 drejtime:

E drejtë kushtetuese dhe administrative: Studentët në këtë profil pajisen me njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi të drejtën kushtetuese dhe të drejtën administrative, si të vendit, ashtu dhe të huaj, të trajtuara në plan krahasues.

E drejtë europiane dhe ndërkombëtare: Studentet që zgjedhin këtë profil pajisen me një përgatitje dhe kualifikim të shtuar dhe cilësor profesional në mbulimin e çështjeve të së drejtës europiane e ndërkombëtare. Ata nëpërmjet kësaj kurrikule përgatiten gjithashtu për të përballuar angazhime profesionale jo vetëm në organe që mbulojnë fushën e marrëdhënieve me jashtë në administratën vendase, por edhe në struktura të ndryshme të organizatave ndërkombëtare apo të përfaqësive të tyre në vendin tonë.

Kriminallogji: Ky profil fokusohet në studimin e thelluar të faktorëve ekonomikë, socialë, kulturorë dhe politikë që prodhojnë sjellje devijante dhe kriminale në shoqëri si edhe në mundësitë e parandalimit dhe luftës efektive ndaj tyre. Ky profil mundëson marrjen e njohurive të thelluara bashkëkohore

ndërdisciplinore në fusha të tilla si sociologjia e sjelljes devijante, kriminologjia dhe çështje të së drejtësisë penale, antropologjia, psikologjia sociale, problemet sociale. Synimi është që të përgatisë studiues dhe punonjës të kualifikuar me njohuri dhe ekspertizë, të cilat mungojnë në institucionet e administratës publike, në institucionet që merren me veprimtari studimore në fushën e problemeve sociale dhe ato të ruajtjes së rendit.

Nr.	MND / E DREJTË PUBLIKE				ECTS
1	Metoda kërkimi 1				6
2	Metoda kërkimi në shkencat juridike				6
3	Zhvillime aktuale në të drejtën europiane				6
4	E drejta publike e krahasuar dhe harmonizimi i së drejtës				6
PROFILI	Kërkimor	Kërkimor	Kërkimor	Profesional	ECTS
	E DREJTË KUSHTETUESE DHE AMINISTRATIVE	E DREJTA EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE	KRIMINALOGJI*	E DREJTË PENALE	
5	E drejta kushtetuese e krahasuar (kurs i avancuar)	Zhvillime aktuale në të drejtën ndërkombëtare	Sociologji e sjelljes devijante dhe kriminologji	E drejta ndërkombëtare penale	6
6	Çështje të drejtësisë kushtetuese - administrative (zhvillime bashkëkohore)	E drejta diplomatike dhe konsullore	Antropologji Juridike	E drejta penale europiane	6
7	Opsionale (një nga lëndët e profileve të tjera të programit)				6
8	Punimi i diplomës + Seancat metodologjike				14+4

E drejtë penale: Studentet që do të zgjedhin këtë profil pajisen me njohuri të thelluara dhe me një kompetencë të shtuar në mbulimin e çështjeve të së drejtës penale. Synohet që ata të aftësohen për të përballuar angazhime dhe kualifikimin profesional kryesisht në organe të drejtësisë penale, por duke u punësuar edhe në sektorë apo pozicione të caktuara të administratës shtetërore që lidhen me hartim politikash apo legjislacioni penal si dhe në përfaqësimin e legjislacionit të brendshëm me atë ndërkombëtar. Një rëndësi të veçantë merr ky profil është në lidhje me analizimin dhe interpretimin e praktikës gjyqësore.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 9 pedagogë të brendshëm dhe 3 të jashtëm, nga të cilët 3 me titull Prof. Dr., 3 me gradën Doktor, 3 në përfundim të studimeve të doktoratës, dhe 3 pedagogë me Master, si asistentë nën drejtimin e pedagogëve me grada dhe tituj. Raporti pedagog-studentë është në nivelin 1 pedagog për 9.5 studentë, ose 1 pedagog i brendshëm për 12.6 studentë.

Dokumentacioni përkatës

1. Dosja e aplikimeve dhe e pranimeve dhe Udhëzimi mbi kriteret dhe procedurat e pranimi;
2. Statistikat për kalueshmërinë;
3. Dosja e proces verbaleve të provimeve;
4. Tabela e shpërndarjes së pedagogëve sipas lëndëve brenda programit të studimit;
5. Tabela e shpërndarjes së lëndëve sipas pedagogëve.
6. Tabela e shpërndarjes së lëndës sipas pedagogëve;
7. Udhëzim mbi Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore;
8. Rregulloret e programeve të studimit;
9. Udhëzimi mbi rekomandimin e literaturës;
10. Dosja e formularëve për zgjedhjen e lëndëve;
11. Programet e kurseve të studimit;
12. Programet mësimore të lëndëve.

IV. Mësimdhënia

Organizimi dhe format e mësimdhënies: raporti midis tyre

Procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, punë laboratorike, praktika profesionale, detyra praktike, ese/detyra kursi, provime të ndërmjetëm, provime përfundimtare dhe punim diplome. Mësimdhënia sigurohet nëpërmjet leksioneve dhe seminareve.

Leksioni: Qëllimi kryesor i leksionit është shpjegimi i materialit mësimor nga ana e pedagogut. Përgjithësisht një grup leksioni përfshin disa (rreth tre) grupe seminari; nxitet zhvillimi i leksioneve interaktive.

Seminari: shërben për vlerësimin e procesit të nxënies nga ana e studentit. Gjatë seminarit pedagogët pyesin, nxisin, aktivizojnë dhe ndërveprojnë me studentët. Ata mund t'i organizojnë studentët në grupe, mund t'u caktojnë atyre prezantime individuale apo në grup, mund të zgjidhin ushtrime me studentët gjatë orës së seminarit etj. Në thelb seminari shërben për të nxitur dhe aktivizuar studentët në mënyrë që ata mos të pozicionohen thjesht në rolin pasiv të nxënies, por të mësojnë në mënyrë aktive, duke përdorur të menduarin kritik.

Praktika profesionale: Qëllimi i praktikës është i dyfishtë. Në nivelin akademik ajo synon që studenti të arrijë që njohuritë teorike t'i shohë të zbatuara në praktikë. Për këtë qëllim UET-i garanton që institucioni apo pozicioni ku studentët do të kryejnë praktikën të jetë sa më i lidhur me fushën e studimit. Në nivelin me konkret praktika profesionale synon të shkathtësojë studentin në ambientin e punës dhe t'i ofrojë atij një mundësi për të krijuar njohje, kontakte dhe njohuri në lidhje me tregun e punës, gjë e cila do të lehtësojë përpjekjet e tij për punësim pas diplomimit.

Eseja: përbën një tjetër komponent kyç të procesit të mësimdhënies. Synimi kryesor është zhvillimi i aftësive analitike të studentit, duke e nxitur atë jo vetëm të përfitojë njohuri në një fushë të caktuar, por edhe të jetë i/e aftë t'i zbatojë këto njohuri konkretisht për të argumentuar pro apo kundër një teze konkrete. Esetë e kërkuara në programet e studimit të ciklit të parë ndahen në tre kategori:

1. *Esetë Argumentuese*, zakonisht kërkohen në vitin e parë dhe veçanërisht në semestrin e parë të vitit të parë të programeve të ciklit të parë. Në këtë fazë studentëve iu kërkohet hartimi i eseve që mund të shkruhen thjesht duke u bazuar tek materialet (leksionet dhe leximet) e kursit, apo duke iu referuar disa të dhënave dhe statistikave bazë që mund të gjenden lehtë. Studenti parashtron dhe argumenton pro apo kundër një teze të caktuar, e cila jepet nga pedagogët ose në ndonjë rast mund të identifikohet nga vetë studenti.
2. *Esetë Akademike*, janë një version më i zhvilluar i eseve argumentuese; argumentimi bëhet jo vetëm më i zgjeruar, por edhe duke iu referuar literaturës përkatëse që mund të dalë edhe jashtë leksioneve të lëndës.
3. *Esetë Kërkimore*, nuk është asgjë më shumë sesa një ese akademike e zgjeruar që përveç literaturës përkatëse i referohet edhe të dhënave empirike. Për programet e ciklit të dytë dhe të tretë të studimit përdoren kryesisht këto lloj esesh.

Ngarkesa mësimore e personelit akademik merr disa forma:

- § Orë mësimore në auditor;
- § Këshillim akademik (për pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm)
- § Tutoriat (vetëm për pedagogët e brendshëm)
- § Botim artikujsh shkencorë në revistat e botuara nga fakultetet e UET-it;
- § Drejtim dhe opionencë temash diplome.

Format dhe sasia e ngarkesës për çdo anëtar të personelit akademik përcaktohet në kontratën e lidhur me tij dhe UET-it. Përgjithësisht vihet re se pjesa më e madhe e pedagogëve të brendshëm dhe senior arrijnë të plotësojnë ngarkesën e orëve mësimore në auditor sipas përcaktimeve të kontratës. Si përfundim, rritja e raportit të pedagogëve të brendshëm ndaj atyre të jashtëm është realizuar shumë më mirë se një vit më parë. Kjo ka ardhur si rezultat i hapjes së programeve të ciklit të dytë e të tretë. Vëmendje i kushtohet edhe shpërndarjes së lëndëve për çdo pedagog për semestër, ku respektohet ekspertiza profesionale e çdo pedagogu, si dhe sigurohet që në çdo semestër ai/ajo të mos japë më shumë se dy lëndë të ndryshme.

Cilësia e mësimdhënies: Në rritjen e cilësisë dhe bashkëkohësisë së mësimdhënies rëndësi i kushtohet lidhjes së dijeve të transmetuara me praktikën dhe eksperiencën ndërkombëtare. Kjo qasje e tillë realizohet nëpërmjet ftesës në auditor të lektorëve me eksperiencë të spikatur vendas dhe të huaj, si dhe të praktikienëve të njohur kombëtarisht e ndërkombëtarisht për të përçuar dijet dhe eksperiencën e tyre në auditor. P.sh., për Fakultetin e Shkencave Sociale është praktikë e njohur ftesa që i behet çdo vit akademik profesorëve të universiteteve franceze për të dhënë module të veçanta në kuadrin e një lënde të caktuar, apo ftesa e ekspertëve të BE-së, organizatave të tjera ndërkombëtare dhe joqeveritare, si dhe ekspertëve të medias, për të ndarë ekspertizën dhe praktikën e tyre me studentët. Kjo eksperiencë është përshëndetur dhe inkurajuar edhe nga vetë studentët, krahas angazhimit që tregon stafi akademik në këtë drejtim.

Në të njëjtën kohë në vitet e fundit stafi akademik i universitetit ka botuar 15 tekste për studentë; 37 libra të botuar brenda vendit, 6 libra të botuar jashtë vendit; dhe 66 artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit dhe 69 jashtë vendit. Anëtarët e stafit janë pjesëmarrës të rregullt në konferenca e workshope kombëtare e ndërkombëtare, gjë që reflekton një punë të vazhdueshme të tij në drejtim të një përditësim të vazhdueshëm të dijeve që jepen në auditor dhe veprimtaritë e tjera akademike dhe shkencore të organizuara në UET.

Përzgjedhja e literaturës Filozofia e formimit akademik e profesional të studentëve të UET-it bazohet në përdorimin preferencial të literaturës së huaj, veçanërisht të teksteve bazë të universiteteve ose të editorëve universitarë më prestigjiozë perëndimorë. Për këtë arsye:

- Pedagogu i lëndës duhet të përzgjedhë midis manualeve të huaja, text-book ose handbook, të afirmuara për vlerat e tyre doktrinare, akademike e profesionale, tekstin që i përshtatet më mirë bindjeve dhe formimit të tij akademik dhe t'ia rekomandojë për miratim departamentit dhe këshillit të fakultetit, për t'u përkthyer dhe për t'u përdorur si tekst bazë në lëndën e tij. Punimet monografike të pedagogëve të UET-it ose të pedagogëve të tjerë shqiptarë inkurajohen në kuadrin e literaturës plotësuese dhe të rekomanduar. Punimet monografike të pedagogëve të UET-it ose të autorëve shqiptarë, depozitohen në bibliotekën e UET-it në sasi të mjaftueshme, për t'u përdorur nga studentët dhe vihen në shitje në librarinë e UET-it dhe në librari të tjera, sipas dëshirës së autorit dhe/ose shtëpisë botuese përkatëse.
- Përfshihen nga zbatimi i kërkesave të mësipërme:
 - Ø Lëndët që trajtojnë zhvillime, fenomene ose disiplina tipike shqiptare, për të cilat janë të domosdoshme punimet e autorëve vendas, që çmohen rast pas rasti nga departamenti dhe dekani i fakultetit përkatës. Tekstet bazë që do të përdoren në këto lëndë duhet të marrin parasysh që së bashku të plotësojnë aspektet e përgjithshme doktrinare, evidentimin e veçantive vendase dhe trajtimin e elementeve krahasuese. Për arritjen e këtij qëllimi studentëve do t'u vihen në dispozicion së paku tri tekste (i) Tekste me natyrë doktrinare nga autorë/ botues të mirënjohur ndërkombëtarë, (ii) Tekste nga autorë shqiptarë, pedagogë të UET-it ose të universiteteve të tjera shqiptare, që përmbajnë specifikat vendase të lëndës dhe

(iii) Tekste bazë të natyrës krahasuese për lëndën përkatëse nga autorë/ botues të mirënjohur ndërkombëtarë.

Ulja e numrit të studentëve në klasë: Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies është ulur numri i studentëve në klasë, nga 120 studentë në 90 studentë për orët e leksionit dhe 25 studentë për grup seminari, nga 30-35 studentë që ishte një vit më parë, duke rritur shkallën e ndërveprimit mes pedagogut dhe studentëve.

Përdorimi i mjeteve didaktike: është një tjetër element ndihmës për përçimin e dijes tek studentët. Kështu klasat e leksionit janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë, të cilët lejojnë përdorimin gjerësisht të prezantimit me PowerPoint, apo shfaqjen e filmave për qëllime didaktike që rezulton në kombinimin e paraqitjes vizuale me atë verbale, me qëllim përforcimin e informacionit të ofruar dhe nxitjen e debatit.

Reflektimi për metodat e mësimdhënies: merr rëndësi të veçantë në garantimin e standardeve bashkëkohore të mësimdhënies. Për këtë qëllim në mënyrë të vazhdueshme pedagogët trajnohen, informohen dhe inkurajohen të shkëmbejnë eksperiencat e tyre pozitive për metodat e reja të mësimdhënies në leksione e seminare. Inkurajohen metodat interaktive dhe të menduarit kritik, krahas asaj të lidhjes së teorisë me praktikën.

Tutoriat dhe këshillimi akademik: Në këto veprimtari është përmirësuar shërbimi ndaj studentit ku çdo pedagog i brendshëm ka 30 studentë nën kujdestarinë e tij. Pedagogët e brendshëm qëndrojnë 2-3 orë në javë në dispozicion të studentëve që kanë nën kujdestari, për t'i këshilluar dhe ndihmuar në mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Gjithashtu çdo pedagog i jashtëm qëndron një orë në javë në dispozicion të studentëve, për të sqaruar çdo paqartësi që ata mund të kenë lidhur me lëndën, apo detyrimet ndaj saj.

Vlerësimi i performancës: Garantimit të cilësisë së mësimdhënies i shërbejnë gjithashtu edhe vlerësimi në disa nivele i procesit të mësimdhënies së një pedagogu, i cili është subjekt i vlerësimit nga studentët, kolegët dhe titullarët e fakultetit, dekanit apo përgjegjësit të departamentit. Rezultatet e vlerësimit i bëhen prezent pedagogut, i cili reflekton për atë çka duhet bërë në përmirësim të procesit të mësimdhënies, qoftë në leksione apo seminare.

Kontrolli i njohurive, format e kontrollit, objektiviteti në vlerësimin e studentëve

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Një nga synimet e vlerësimit të vazhdueshëm është që ta vendosë studentin në punë përgjatë të gjithë vitit. Ky vlerësim i tregon pedagogut nëse studentët janë duke i arritur objektivat e vendosura. Vlerësimi i vazhdueshëm rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit.

Kontrolli i njohurive ka pasur dhe vazhdon të ketë një qëllim të dyfishtë: (i) vlerësimin e studenteve dhe (ii) nxitjen e aftësive argumentuese dhe njohurive të studentëve. Të dy qëllimet janë zbatuar në mënyrë të ndërlidhur me njëra - tjetrën. Në këtë mënyrë të tillë testohet edhe informacioni që studenti ka, por edhe aftësia e tij/saj për të argumentuar/analizuar. Krahas pyetjeve që testojnë aftësitë analitike, jepen edhe pyetje që testojnë informacionin që studenti ka marrë gjatë lëndës, pasi një testim vetëm i aftësive analitike rrezikon të penalizojë ata studentë që mësojnë në mënyrë mekanike dhe riprodhuese. Rekomandohet që:

1. 20- 30% e vlerësimit përbëhet me pyetje që kontrollojnë njohuritë;
2. 40 - 50% me pyetje që testojnë aftësinë analitike; dhe
3. 20 – 30% me pyetje me zhvillim në formën e esesë argumentuese.

Sa më shumë studenti avancon në vite akademike, aq më shumë provimi duhet të reduktojë komponentin e kontrollit dhe të zgjerojë komponentin analitik.

Tezat e provimit janë të sekretuara me barkode, në mënyrë që të ruhet anonimati i studentit deri në korrigjimin e provimit nga pedagogu, për të shmangur ndikimin e vlerësimit të pedagogut nga faktorë që nuk kanë lidhje me cilësinë e zhvillimit të tezës. Çsekretimi kryhet nga sekretaria mësimore pas dorëzimit të tezave të korrigjuara.

Provimi përfundimtar ka qëllimisht vlerën 40% të notës përfundimtare, në mënyrë që një student, i cili nuk ka punuar gjatë semestrit, ta ketë të pamundur të marrë notë kaluese bazuar vetëm në këtë komponent të vlerësimit. Pra, synohet që studenti të nxitet të punojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, gjë shërben për të vënë në funksionim kujtesën afatgjatë të tij dhe për të shmangur përgatitjen vetëm gjatë sezonit të provimeve.

Në sezonin e riprovimeve në vjeshtë, për lëndët teorike provimi ka 80% të vlerësimit dhe 20% përcaktohet nga vlerësimi i marrë për esenë e dorëzuar gjatë semestrit. Për lëndët praktike provimi ka 100% të vlerësimit. Teza e riprovimit synohet të jetë e një vështirësie më të lartë, për të dekurajuar lënien e provimeve për këtë sezon provimesh, por gjithashtu i jep mundësi studentëve që për ndonjë arsye kanë humbur pikë gjatë semestrit të mund të rifitojnë pikët e humbura nëse si përfundim kanë realizuar një përvetësim të mirë të lëndës.

Pas marrjes së rezultatit për komponentë të veçantë të vlerësimit, ose/dhe notën përfundimtare, studentit i krijohet mundësia për të sqaruar çdo paqartësi apo pretendim lidhur me vlerësimin, fillimisht me pedagogun e lëndës dhe, në rast se, edhe pas takimit sqarues me pedagogun, studenti ka ankesa për vlerësimin e marrë, mund të kërkojë ngritjen e një komisioni shqyrtues nga Departamenti. Vendimi i komisionit është përfundimtar.

Përdorimi i teknologjive të reja të mësimdhënies: kompjutera, mjete audiovizive etj.

Në shërbim të mësimdhënies Universiteti European i Tiranës ka vënë në dispozicion pajisje të ndryshme të teknologjisë së informacionit si:

- Smart Dashboard Touchscreen, pajisje kjo e fjalës se fundit të shkencës dhe teknologjisë. Mjaft e përshtatshme për mësimdhënie interaktive.
- Kompjutera.
- Videoprojektore.
- Skanera
- Printera
- Servera
- Firewall
- Swiches
- Sisteme audio
- Wireless access point

Gjendja e auditorëve dhe zyrave në shërbim të stafit akademik, ndihmës dhe studentëve paraqitet si më poshtë:

1. 8 salla leksionesh të pajisura me 1 PC, 1 projektor si dhe sistem audio dhe 12 salla seminaresh me video projektor secila.

2. 1 sallë interneti e pajisur aktualisht 70 PC dhe një printer rrjeti. Aty qëndron vazhdimisht një person i cili ndihmon studentët për printimet, si dhe i asiston për probleme të ndryshme gjatë punës së tyre; gjithashtu kujdeset për ruajtjen e pajisjeve.
 3. 1 sallë informatike me 17 PC ku zhvillohet mësimi i lëndës Informatikë, si dhe lëndë të tjera sipas nevojës.
 4. 4 salla pedagogësh me rreth 27 PC, 4 printera rrjeti dhe 2 printera të zakonshëm.
 5. Çdo pedagog i brendshëm ka një PC që e përdor vetëm ai. Për pedagogët e jashtëm ka një PC në çdo sallë pedagogësh që mund të përdoret prej tyre.
 6. Zyrat e Administratorit, Rektorit, Dekanëve, janë të pajisura me PC dhe printer. Koordinatorët pranë fakulteteve janë të pajisura me PC, ndërsa për printime përdorin printerat e rrjetit të pedagogëve.
 7. Dy sekretaritë, si ajo e Masterave dhe ajo e Ciklit të parë janë pajisur me PC për çdo sekretare, si dhe tre printera.
 8. Zyra për zhvillimin e tutoriatit është e pajisur me 2 PC dhe një printer.
 9. Biblioteka është e pajisur me 2 PC për stafin, si dhe 5 PC të tjerë në shërbim të studentëve.
 10. Në katin e parë ndodhet zyra e fotokopjes, e pajisur me tre fotokopje, njëra prej të cilave profesionale e blerë në vitin 2009, shumë e përshtatshme për printime dhe fotokopjime masive.
 11. Lidhja e internetit, e cila është shumë e shpejtë, ofrohet në çdo PC me përjashtim të sallave të leksioneve ku nuk është parë e arsyeshme të ofrohet.
 12. Çdo pedagog ka një email të ofruar nga UET-i. Emaili ka këtë standard: emer.mbiemer@uet.edu.al. Fjalëkalimi u është nisur individualisht secilit prej tyre.
 13. Sistemi kompjuterik mbrohet nga ndërhyrjet e jashtme me anë të një sistemi mbrojtës të fjalës së fundit të teknologjisë. Gjithashtu në çdo PC është instaluar McAfee Antivirus, i cili menaxhohet në mënyrë qendrore nga zyra e IT-së.
 14. Katër servera, prodhim i viteve 2008-2009 mbulojnë shërbimin Email, Fileserver dhe Domain Controller.
 15. Ruajtje qendrore e dokumenteve ne server dhe backup i rregullt i tyre për çdo punonjës për arsye sigurie.
 16. Një central telefonik me 26 numra ofron shërbimin e komunikimit të brendshëm për stafin. Ekzistojnë katër numra fiks aktive, për komunikimin e UET me rrjetin e Albtelekom.
 17. Ambientet e brendshme dhe të jashtme të UET-it mbulohen nga sistemi i sigurisë me kamera. Pamjet aty ruhen për një periudhë 5 ditore. Pamjet e filmuara nuk mund të aksesoren përveçse nga stafi i IT dhe i shërbimit të sigurisë në UET, me miratimin e organeve drejtuese të UET.
 18. UET-i ka një faqe interneti: www.uet.edu.al dhe një email zyrtar info@uet.edu.al
 19. UET-i ofron shërbimin internet wireless falas për të gjithë studentët, si dhe për klientët që frekuentojnë lokalitë BAR UET.
 20. Janë printuar kartat e studenteve deri në vitin akademik 2008-2009, si dhe po finalizohet printimi i kartave për studentet e vitit akademik 2009-2010 si kartat dhe për stafin.
 21. Në fazë implementimi një mënyrë interaktive e mësimi të gjuhëve të huaja nëpërmjet kompjuterit, duke përdorur një sistem që përdoret tashmë në universitetet më të njohura në Europë.
- Të gjitha këto përbëjnë një infrastrukturë didaktike – mësimore të konsoliduar, e cila ndikon që studentit t'i sigurohet shërbimi i nevojshëm për realizimin e objektivave të tij akademike e kërkimore.

Dokumentacioni përkatës

1. Tabela përmbledhëse e cilësisë së stafit;
2. Dosja e shtypit;
3. Dosja e proces – verbaleve të mbledhjeve;
4. Libri i pedagogut;
5. Regjistri Themeltar;
6. Kontratat e studentëve;
7. Udhëzimi mbi Tutoriatin dhe Këshillimin Akademik.

UET - Raporti i Vetëvlerësimit 2010

Salla	PC	Printer / marka	Tel fix	UPS	Switch	TV	Projektor	Sistem Fonie	Wireles
205	2 Pc + 1 Lap Top	1 HP 1280 1 Brother 1 HP 1600 1 OKI 8600 1 Evolis Dualys 3	1 copë	1 copë	1 / 8 porta				
204	3 PC								
203	1 PC	1 HP 1020		1 copë					
202	1 PC	1 HP	1 copë	1 copë					
201	3 PC + 1 Lap Top	1 Hp 4050 1 Samsung 4200	1 copë	3 copë	1 / 8 porta				
210	1 PC + 1 Lap Top	1 Samsung 4200		1 copë					
211	2 PC	1 Brother							
212/ financa	3 PC + 1 Lap Top	1 Samsung 4200 1 Samsung 2570	1 copë	2 copë					
214/internet	84 PC	1 HP 4250							1 copë
215	6 PC	1 samsung 2010							1 copë
209	1 PC						1 copë	1 copë	
310	1 PC	1 Samsung 2010	1 copë	1 copë					
309	9 PC	1 Hp 2300 dn	1 copë		1 / 16 porta				
311	11 PC								
312	17 PC								
315	1 PC						1 copë	1 copë	
301	2 PC	1 Lexmark 1 Samsung	2 copë	2 copë		1 Copë / 42"			
302/ rektori	1 PC	1 lexmark	1 copë	1 copë		1 copë / 32"			
303	8 PC	1 Samsung 1 Lexmark		1 copë	1 / 16 porta				
308	1 PC						1 copë	1 copë	
401	1 PC	1 Samsung 4200	1 copë	1 copë		1 Copë / 32"			
402	11 PC	1 Hp 2300 dn	1 copë	1 copë	1 / 16 Porta				
408	1 PC						1 copë	1 copë	
409	8 PC	1 HP 2015	1 copë		1 / 16 Porta				
410	1 PC	1 Samsung	1 copë	1 copë					

UET - Raporti i Vetëvlerësimit 2010

Salla	PC	Printer / marka	Tel fix	UPS	Switch	TV	Projektor	Sistem Fonie	Wireles
416	1 PC						1 copë	1 copë	
	1 PC								
Fotokopja	2 PC	2 fotokopje BIZHUB 500 2 fotokopje BIZHUB 210	1 copë	1 copë					
Libraria	1 PC								
Aula Magna	1 PC						1 copë	1 copë	
Godina e Re	15 PC	6 PRINTERA, (2HP + 2 Samsung + 2 Lexmark)			2/ 16 porta				
Dhoma e Serverave • 3 PC, 1 SISTEM SIGURIE (22 kamera) • 5 Switche 48 Porta • 5 Switche 24 Porta • 2 Switche 16 Porta • 1 Firewall • 4 Servera • 3 RACK									

V. Kërkimi shkencor

Kërkimi shkencor është një prej dimensioneve më të rëndësishme të UET-it, i cili ashtu sikurse mësimdhënia, ndërtohet në zbatim të filozofisë dhe misionit të UET-it, në përputhje me interesat e universitetit, të stafëve akademike dhe studentore si dhe në përputhje me kapacitetet njerëzore dhe financiare që UET ka në zotërim. UET shërben si një qendër kërkimore - shkencore, në partneritet me të tretë, me institucionet, organizmat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të shoqërisë shqiptare, me të cilët universiteti është në bashkëpunim.

Objektivat e kërkimit shkencor

Mbështetja ndaj procesit pedagogjik, nëpërmjet:

- Nxitjes së veprimtarisë kërkimore dhe shkencore në funksion të orientimeve kryesore akademike në secilën fushë.
 - Nxitjes së stafit akademik për të rifreskuar njohuritë e tyre.
 - Mbajtjes së lidhjeve të fuqishme mes aspektit teorik me kërkimet empirike në terren nga ana e stafit.
- Përmirësimi i imazhit të universitetit në opinionin publik, nëpërmjet krijimit të imazhit të një universiteti pararojë në ndërthurjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien.
- Kontributi në zhvillimet e përgjithshme shkencore dhe sociale në vend, nëpërmjet realizimit të studimeve dhe aktiviteteve me impakt të rëndësishëm në jetën sociale.

Strategjia për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor:

- Përcaktimi i fushave përparësore të interesit në kërkimin shkencor.
- Orientimi i një pjese të angazhimit të pedagogut në kërkimin shkencor.
- Fuqizimi (ose edhe ngritja kur është e nevojshme) e strukturave që do të propozojnë, organizojnë dhe monitorojnë zhvillimin e kërkimit shkencor.
- Caktimi i një fondi të veçantë vjetor për realizimin e veprimtarive mbi bazën e një plani konkret pune.
- Afrimi i partnerëve vendas dhe të huaj, shkencorë dhe financiarë.

Revistat shkencore

Qëllimi i revistave shkencore të UET-it është publikimi i punës kërkimore shkencore të stafit akademik dhe më gjerë, nxitja e debatit shkencor në mes të komunitetit akademik të UET-it dhe atij shqiptar e të huaj. Çdo fakultet ka revistën e tij shkencore e cila botohet dy herë në vit në formatin B5, mes 120 – 150 faqe, nën drejtimin e Kryeredaktorit përkatës. Pedagogët e brendshëm kanë përparësi në botimet e tyre, për shkak të detyrimit kontraktor, gjithnjë duke ruajtur kritere të rrepta shkencore dhe standarde akademike. Inkurajohen numrat tematikë të cilat përpiqen të trajtojnë në mënyrë të veçantë një fenomen, çështje e dukuri me interes për fushat e studimeve të UET-it. Numrat tematike ose “Dosja e numrit” duhet të rakordohen me konferencat shkencore të fakultetit. Ato përmbajnë në themel punimet e konferencës. Dekurajohen përkthimet nga literaturë e huaj. Pedagogët dhe studentët e UET-it mund të shfrytëzojnë literaturën e huaj bashkëkohore në fushat përkatëse, e cila duhet të jetë gjerësisht në bibliotekën fizike dhe atë *on line* të UET-it.

Konferencat shkencore

Çdo fakultet duhet të organizojë së paku dy konferenca shkencore në vit. Rekomandohet që konferencat të kenë tematikë të njëjtë me revistat shkencore të fakultetit përkatës. Konferencat shkencore i përgjigjen fushave të studimit të fakulteteve përkatëse. UET i financon këto konferenca me një buxhet të posaçëm.

Botimet shkencore

UET inkurajon pedagogët e brendshëm të botojnë libra shkencorë në kuadrin e Shtëpisë botuese UET - Press dhe procedurave të saj. Këto punime shkencore duhet të jenë autentike, me kritere akademike të rrepta duke iu nënshtruar të gjitha kritereve perëndimore për botime të këtij lloji. Ato duhet të jenë me interes dhe vlerë për fushat e kërkimit të UET-it. Botimet shkencore mund të jenë të reja ose përshtatje e punimeve të mëparshme (Tema, Ese, mastera, doktratura etj). Fakulteti, Departamenti përkatës dhe UET - Press përcaktojnë, sipas kërkesës së pedagogut, vlerën shkencore, titujt dhe kalendarin. Këshilli i Fakultetit, në përputhje me specifikat e botimeve shndërrohen në Këshill Botues. Personeli akademik i UET-it, me grada e tituj, ka të drejtë që çdo 5 vjet punë të pandërprerë, për periudha kohë deri në 6 (gjashtë) muaj, të punojë për përparimin e tij akademik për të kryer një studim/monografi autentike e cila botohet nga UET – PRESS. Kjo periudhë kohe do të jetë e paguar. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje. Në këtë rast projekti i tij i kërkimit miratohet nga këshilli shkencor i fakultetit dhe nga UET - PRESS.

Grupet e kërkimit

Në UET inkurajohet krijimi dhe veprimtaria e grupeve të kërkimit, të strukturuar përreth pedagogëve me tituj dhe grada, brenda departamentit ose bashkëpunime midis departamenteve. Këto veprimtari duhet të kenë një tematikë të caktuar, me interes për fushat e studimit, për projektet e kërkimit dhe të zhvillimit të UET-it. Kjo bëhet në rakordim me punimet e diplomave të studentëve, projektet me të tretë etj. Grupet e kërkimit mund të jenë të përhershme ose të përkohshme. Grupet e kërkimit rakordohen dhe me tematikat e revistave dhe konferencave. Kryetarëve të këtyre Grupeve u zbriten 2 orë në javë nga ngarkesa e tyre përkatëse. Anëtarëve të këtyre grupeve u hiqet 1 orë në javë mësimdhënie nga ngarkesa përkatëse. Drejtuesit administrativë nuk përfitojnë nga ky zvogëlim i ngarkesës mësimore.

Qendrat e kërkimit

Për organizimin, bashkëveprimin dhe drejtimin cilësor dhe efektiv të kërkimit shkencor dhe në funksion të përmbushjes së filozofisë dhe misionit të UET-it krijohen njësi bazë të quajtura Qendra kërkimore. Ato organizohen në grupe kërkimore - shkencore me karakter të përhershëm ose të përkohshëm. Qendra është në funksion të njërive kryesore dhe bazë duke nxitur, bashkërenduar dhe administruar veprimtarinë kërkimore-shkencore. Veprimtaria kërkimore-shkencore e çdo Qendre realizohet mbi bazën e një plani vjetor dhe një plani afatgjatë, të konsultuar me njësinë kryesore si dhe organet drejtuese të UET-it. Buxheti i veprimtarive të planifikuara miratohet nga Administratori i UET-it mbi propozimin e Qendrës.

Punimet e diplomës së studentëve

Punimet e diplomës së studentëve, duke respektuar lirinë akademike të stafit akademik dhe interesat e studentëve, mund të inkuadrohen në politikat shkencore të UET-it dhe konkretisht brenda tematikave të grupeve të kërkimit. Punimet e studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, mund të inkuadrohen në politikat e qendrave dhe grupeve të kërkimit. Nuk përjashtohen as punime cilësore të studentëve të programeve të DNP-së. Dhjetë punimet më të mira të diplomës, çdo vit akademik, të vlerësuara nga një komision akademik i ngritur nga rektori i UET-it, botohen në një libër të veçantë.

Numri i botimeve nga stafi i qëndrueshëm

Nga UET-PRESS janë botuar deri tani 23 tituj dhe shumë të tjerë janë në proces përkthimi, redaktimi shkencor, redaktimi gjuhësor, faqosjeje si dhe janë dërguar për shtyp. Për sa i përket revistave shkencore janë botuar 8 Revista Polis, 4 revista Economicus dhe 3 Jus & Justicia. Punimet e pedagogëve të brendshëm zënë pjesën më të madhe të botimeve në këto revista.

Në vitin akademik 2008 – 2009 janë botuar gjithsej 7 tituj dhe në vitin akademik 2009 – 2010 janë botuar deri tani 16 tituj. Përpara mbylljes së këtij viti akademik mund të botohen dhe tre tituj të tjerë që

janë në proces faqosjeje (Hyrje në biznes) dhe janë dërguar për shtyp (Trashëgimtarët – Një botim tepër interesant nga një ish-studente e UET-it) dhe Akademikë të rinj, ide të reja (Përmbledhje e punimeve shkencore të një grupi pedagogësh të rinj të UET-it, të shkolluar jashtë vendit dhe të rikthyer me ide të reja, plot ambicie e përkushtim).

Në proces përkthimi, redaktimi shkencor dhe redaktimi gjuhësor janë shumë tituj të tjerë si me poshtë:

- *Vullneti për dije*
- *Demokracia e lashtë dhe demokracia moderne*
- *Sociologjia e komunikimit*
- *Osman Myderrizi - Studime.*
- *E drejta e BE*
- *Teori të marrëdhënieve ndërkombëtare*
- *Arti i të folurit publik*
- *Financat Publike*
- *Marrëdhëniet Publike. Guidë komplete (Marconi)*
- *Komunikimi ndërkulturor*
- *Manual i shkruesit të marrëdhënieve publike*
- *Politika e Jashtme e SHBA*
- *Politika e Jashtme*
- *Politikat e BE*
- *Ekonomiksi*
- *Menaxhimi*
- *Ekonomiksi ndërkombëtar*
- *Hyrje në të Drejtën dhe arsyetimi ligjor*
- *E drejta kushtetuese krahasuese*
- *Bazat e menaxhimit*
- *Parimet e marketingut*
- *Sociologjia e sjelljes devijante dhe e krimit*
- *Menaxhimi i burimeve njerëzore*
- *Manual i ri i shkencave politike*
- *E drejta publike krahasuese*
- *Teori të demokracisë*
- *Një vështrim në teorinë e komunikimit*
- *E drejta publike ndërkombëtare*
- *Dinamika e komunikimit masiv*
- *Strategjia në botën e sotme*
- *Statistika*
- *Shteti i së drejtës*
- *Esse për dhurimet*
- *Matematika*
- *Paraja dhe banka*
- *Ecja shqiptare*
- *E drejta kushtetuese (Temistocle)*
- *Bazat e financave*
- *Kuptimi i komunikimit njerëzor*

Botimet e UET-PRESS-it janë të ndara në disa kolana:

KOLANA I Tekste universitare – Përkthime

Numri më i madh i titujve të botuar deri më sot nga UET-PRESS dhe i atyre që janë në proces përkthimi ose redaktimi, i përket pikërisht kësaj kolane. Është synuar që të pajisen studentët me tekste bazë dhe literaturë plotësuese sa më cilësore, për shumicën e lëndëve që zhvillohen, dhe kjo ka çuar në përqendrimin e botimeve të UET-PRESS të përkthimeve të teksteve universitare. Shumica e titujve të botuar i përkasin Fakultetit të Shkencave Sociale. Në proces përkthimi dhe redaktimi janë shumë tituj që i përkasin Fakultetit Ekonomik, si dhe atij Juridik, të cilëve ju jemi "borxhli" për sa i përket botimeve. Titujt e kësaj kolane plotësojnë nevojat e studentëve duke krijuar për herë të parë një standard, të krahasueshëm me nivelet universitare perëndimore. Janë 10 tituj të botuar deri më sot që i përkasin kësaj kolone, shumica e të cilëve janë përkthyer ose redaktuar nga pedagogët tanë të brendshëm ose të jashtëm:

- *Hyrje në komunikimin politik*
- *Semiotika e tekstit*
- *E drejta romake*
- *Partitë politike*
- *Hyrje në shkencën politike*
- *Nocione të logjikës*
- *Marrëdhënie ndërkombëtare të Lindjes së Mesme*
- *Studime të sigurisë bashkëkohore*
- *Komunikimi organizativ. Qasje dhe prirje*
- *Mërfi për provën*

Këto janë tekste mësimore për studentët e Universitetit tonë ose dhe të jashtëm.

KOLANA II: Monografi shkencore, studime / Ese – Autorë shqiptarë

Autorët e pothuajse të gjitha botimeve që i përkasin kësaj kolane janë pedagogë të brendshëm të UET-it. Cilësinë e këtyre punimeve e ka demonstruar vetë tregu i librit, pasi shumë prej këtyre titujve ka pasur nevojën e ribotimit. Një fakt që e dëshmon këtë është dhe marrja e çmimit Kult si "Botimi studimor më i mirë" ndërmjet 183 librave studimorë, i librit "Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare" që s'ka si të mos jetë dhe një krenari e UET-PRESS. Tematika e këtyre studimeve ka variuar nga studimet historike, ato juridike, sociologjike, publicistike, si dhe studimet ekonomike duke dhënë kështu një kontribut domethënës në fushat përkatëse. Kështu rektori i UET-it z. Adrian Civici ka botuar dy tituj duke sjellë një kontribut të çmuar shkencor në fushën e ekonomisë. Titujt që i përkasin kësaj kolane janë:

- *Globalizmi ante portas - Adrian Civici*
- *Fitimi i pronësisë mbi pasuritë e patundshme - Besnik Maho*
- *Kriza financiare ...apo globale - Adrian Civici*
- *Kërkimi i legjitimitetit dhe venitja e utopisë - Fatos Tarifa*
- *Edi Rama politikan pop(ulist) star - Belina Budini*
- *Shekujt osmanë në hapësirat shqiptare (studime dhe dokumente)- Ferit Duka*
- *Hinterlandi i kuq. Njëzetë vjet më pas - Mustafa Nano*
- *Profile të diplomacisë europiane në Ballkan - Shaban Murati*
- Këto janë tekste kërkimore.

KOLANA III: "Scripta manent" – Autorë shqiptarë

Thprehja latine "Verba volant, scripta manent" (Fjalët fluturojnë, e shkruara mbetet) tregon rëndësinë që i është kushtuar këtyre botimeve. Vetë natyra e këtyre studimeve ka kërkuar një kohë të gjatë për botim, pasi ato do të shërbejnë si një dëshmi me vlera për brezat e ardhshëm. Tre prej katër botimeve të deritanishme që bëjnë pjesë në këtë kolanë janë vetëm fillimi i botimit të 20 titujve që janë

parashikuar dhe projektuar nga UET-PRESS për të dëshmuar periudhën post-komuniste në Shqipëri dhe pikërisht tranzicionin me ngjarjet e personazhet e tyre.

- *Letërsia moderne shqipe- Sabri Hamiti*
- *Intuicionet e tranzicionit 1- Preç Zogaj*
- *Jeta ime Intervistë me Blendi Fevziu - Blendi Fevziu*
- *33 Tranzicioni në intervistë - Sokol Balla*

KOLANA IV Albume

Një tjetër fakt që dëshmon diversitetin e botimeve të UET-PRESS janë dhe botimet e albumeve të piktorëve të njohur shqiptarë si: Rakip Shabani, Fate Velaj, Arben Theodhosi, të cilët I kanë dhënë dhe ngjyra dhe ambientit të Universitetit me tablotë e tyre. Po kështu së shpejti do të botohet albumi fotografik I publicistit dhe koleksionistit të mirënjohur Artan Lame, që përbën një dëshmi shumë interesante të fotove ekskluzive të shoqërisë shqiptare që prej viteve 30.

- *Memories from the future (sponsorizuar nga UET - Fate Velaj)*
- *Në stacionin e shtatë (sponsorizuar nga UET - Arben Theodhosi)*
- *Album me piktura (botim i UET-PRESS) - Rakip Shabani*

KOLANA V Revistat shkencore

Qëllimi i revistave shkencore të UET-it është nxitja e debatit shkencor në mes të komunitetit akademik të UET-it dhe atij shqiptar e të huaj, si dhe publikimi i punës shkencore të stafit të UET-it. Çdo fakultet ka revistën e tij shkencore e cila do të botohet dy herë në vit në formatin B5, mes 120 – 150 faqe, nën drejtimin e Kryeredaktorit përkatës. Pedagogët e brendshëm kanë përparësi në botimet e tyre, për shkak të detyrimit kontraktor, gjithnjë duke ruajtur kritere të rrepta shkencore dhe standarde akademike. Inkurajohen numrat tematikë të cilat përpiqen të trajtojnë në mënyrë të veçantë një fenomen, çështje e dukuri me interes për fushat e studimeve të UET-it. Janë dekurajohen përkthimet nga literaturë e huaj.

- *Revista Polis 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8*
- *Revista Economicus 1, 2, 3, 4*
- *Revista Jus & Justicia 1, 2, 3*

Numri i projekteve të zbatuara në pesë vitet e fundit

Në strukturën e mirëorganizuar të Universitetit European të Tiranës ekziston edhe një zyrë e veçantë (Zyra e Aktiviteteve), e cila merret posaçërisht me kontaktimin, organizimin, zhvillimin, mbikëqyrjen, monitorimin, dokumentimin, si edhe arshivimin e të gjitha aktiviteteve të zhvilluara. Po t'i referohemi edhe pasqyrës së aktiviteteve të organizuara (bashkangjitur këtij Raporti), do të vemë re një larmi aktiviteteve dhe pjesëmarrësish. Llojet e aktiviteteve i klasifikojmë në këto grupe:

Nr	Lloji i aktivitetit	Viti 2009	Viti 2010	Totali
1	Aktivite shkencore (Konferenca)	4	7	11
a.	Seminare me lektorë të jashtëm, vendas ose të huaj (Auditorium)	3	31	34
b.	Pjesëmarrje si partnerë në projekte (Aktivite publike)	17	16	33
2	Aktivite të studentëve si edhe Lectio (Studentore)	11	19	30
3	Aktivite me/për të tretë.	0	6	6

Për periudhën tetor 2009-maj 2010, janë organizuar 11 (njëmbëdhjetë) aktivitete shkencore të organizuara nga UET (Konferenca) , ku ndër më të "rëndësishmet" përmendim:

1. Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Ligji, shoqëria në kuadrin e shtetit-komb” – Rasti i shoqërisë shqiptare, 10 nëntor 2009

Sesioni i I: “Legjitimiteti moral ose moralet e legjitimit të ligjit, qeverisjes dhe politikave” Dr. Nebi Bardhoshi (moderator), Italo Pardo, (Honorary Reader in Social Anthropology in the Department of Anthropology at the University of Kent and a Member of Eliot College University of Kent) Prof. Ksenofon Krisafi, Ma. Elona Rizo, (Universiteti Europian i Tiranës). Prof. Asoc. Dr. Vasilika Hysi (Fakulteti i Drejtësisë, UT), Dok. Amanda Kodra, (kërkuese shkencore pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë), Dr. Nada Dollani, UET-it, Mag. Besnik Maho, Pedagog i UET-it. *Sesioni i II:* “Zbatimi dhe moszbatimi i ligjit shtetëror dhe sfidat në kuadër të integritetit në Bashkimin Europian” Prof. Dr. Ksenofon Krisafi (moderator), Dr. Giuliana Prato, (Universiteti i Kentit UK), Dr. Nebi Bardhoshi (UET, Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë), Dr. Artan Hoxha, (UT Fakulteti i Drejtësisë)

Sesioni i III: “Shoqëria dhe individë në mes Modernes dhe Tradicionales apo/ose Lokales: Ligjet dhe politika në një shoqëri në “tranzicion”. Dok. Migena Leskoviku (moderatore). Dr. Sonila Omari, (UT, Fakulteti i Drejtësisë), Dr. Argita Maltezi, (UT, Fakulteti i Drejtësisë), Dr. Eralda (Methasani) Cani, (UT, Fakulteti i Drejtësisë).

2. Konferencën me temë: “Pastoralizmi mesdhetar: Trashëgimia kulturore dhe zhvillimi i qëndrueshëm” 12-13 nëntor 2009

Organizuar në bashkëpunim me Agjensinë për Zhvillimin e Zonave Malore dhe CIHEAM, (Qendra Ndërkombëtare e Studimeve të Avancuara Mesdhetare Agronomike), nën kujdesin e Ministrisë Franceze të Ekologjisë, energjisë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe administrimit të territorit dhe Ministrisë Shqiptare të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Qendra e trashëgimisë kulturore, UNESCO.

Sesioni i I: Identitete pastorale dhe shoqërore: agro-pastoralizmi prodhues i një kulture specifike të përfshirë në identitetet moderne. Drejt agro-pastoralizmit si trashëgimi. Znj. Pierre-Marie Tricaud (IAURIF, Francë). Konsiderimi i agro-pastoralizmit si trashëgimi dhe një mekanizëm për zhvillimin e qëndrueshëm. Znj. Mechtild Rossler (UNESCO/CLT/CPM). Problemet dhe sfida për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e një agro-pastoralizmi të qëndrueshëm. Z. David Boema (SIPAM, FAO)

Sesioni i II: Zhvillimi i qëndrueshëm dhe agro-pastoralizmi: si të mbështet trashëgimia kulturore dhe peisazhere? Z.Tahar Berchiche (INA EL Harrach, Komisioni Kombëtar i Algjerisë). Badiya, zonë e beduineve, instrumentalizimi i identiteteve dhe pastoralizmit. Z.Roland Jaubert (IUED Geneve) dhe Z. Mohamed Al Dbiyat (IFPO).

3. Konferencën me temë: Roli i SHBA-së në shek. XXI (The U.S. on the Global Stage in the 21st Century), Tiranë, 21 maj 2010

Studiues të njohur ndërkombëtare u mbledhën në Tiranë në konferencën shkencore të organizuar nga Universiteti Europian i Tiranës (UET) për të diskutuar më kolegët e tyre shqiptarë probleme të gjeopolitikës botërore dhe veçanërisht rolin që SHBA-të luajnë në të. Pjesëmarrja e emrave të tillë si psh Prof. Amitai Etzioni i Universitetit të Kolumbias, Prof. Pierre Hassner nga Franca dhe Prof. Paul Hollander nga Universiteti i Masaçusetsit, e bënë këtë konferencë një ndër veprimtaritë më me nivel të organizuara ndonjëherë nga universitetet shqiptare. Në fjalën e tij, prof. Etzioni, ish këshilltar i Presidentit Xhimi Karter, u përqëndrua në rolin që luan dhe do të luajë SHBA në arkitekturën globale të 21-të, duke theksuar se politika e jashtme e SHBA-së duhet të orientohet para së gjithash nga interesat kombëtare të sigurisë së saj dhe forcimit të sigurisë në shkallë globale.

Prof. Pierre HASSNER, i cili u dekorua nga Presidenti Topi për kontribut në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, foli mbi dilemat në politikën e jashtme amerikane në një botë që po bëhet gjithnjë e më e ndërvarur dhe gjithnjë e më pak e kontrollueshme. Prof. Paul Hollander diskutoi mbi ndjenjat anti-amerikane në rajone të ndryshme të botës dhe të ardhmen e këtij fenomeni në dekadat e ardhshme. PhD Fatos Tarifa në diskutimin e tij u fokusua në fenomenin e modernitetin dhe të

globalizmit dhe të sfidave që ato paraqesin për të ardhmen e politikës globale dhe rolin e SHBA-së. Prof. Asoc. Enika Abazi shtjelloi temën mbi arkitekturën e re të sigurisë në Europë dhe rolin e SHBA-së në të, ndërsa PhD Odeta Barbullushi shtjelloi marrëdhënien midis SHBA-së dhe Britanisë së Madhe. Problemet e sigurisë në Ballkan ishin në qendër të punimit të Dr. Luan Hoxhës, ndërsa Petrit Nathanaili trajtoi çështje të marrëdhënieve transatlantike. "Kjo konferencë është dëshmi e arritjeve të shkencave sociale shqiptare dhe nivelin e tyre të krahasueshëm me akademikët në botë"- tha drejtori i Institutit i Studimeve Sociale dhe të Politikave në UET, PhD. Fatos Tarifa. Punimet e konferencës do të botohen në numrin e ardhshëm të revistës "Sociological Analysis".

4. Duhet përmendur si një veprimtari e gjere shkencore me karakter ndërkombëtar, 6th EuPRA bi-annual Congress, European Peace Architecture: Integration – Cooperation – Engagement, zhvilluar me 23–25 korrik 2009, ne Tirane.

Po ashtu meritojnë te veçohen si mjaft te rëndësishme edhe disa konferenca ndërkombëtare te organizuara nga Instituti i Studimeve Sociale dhe te Politikave ne Universitetin European te Tiranës si dhe Qendra *Ligji, Norma, Tradita* e Fakultetit Juridik se UET-it, ku ka pasur një pjesëmarrje mjaft te gjere dhe cilësore lektoresh te huaj. Te tilla kane qene:

5. *Politika dhe Historia* (15 maj 2009), me pjesëmarrjen e Adam MICHNIK, Jay WEINSTEIN, Anthony OBERSCHALL, Jeff GOODWIN, Obrad SAVIC, Bernd FISCHER etj.

6. *Demokracia, Universiteti, Tregu* (6 nentor 2009) me pjesëmarrjen e Bas DE GAAY FORTMAN, Netherlands, Gerard DELANTY, UK, Nico STEHR, Germany, Jason MAST, Yale University etj.

Ligji dhe Shoqëria në Kuadrin e Shtetit-Komb, Rasti i Shoqërisë Shqiptare, me (10.11.2009) ne bashkëpunim me Universitetin e Kentit, me pjesëmarrjen e pedagogeve angleze Giuliana Prato dhe Italo Pardo nga Universiteti i Kent-it, UK.

Pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë shtetit

Ka pasur një pjesëmarrje shume te gjere te pedagogeve te UET-it ne konferenca shkencore ndërkombëtare jashtë shtetit si ne Itali, France, Zvicër, Britaninë e Madhe, Izrael, Vietnam, Kili, SHBA, Turqi, Kosove, Bosnje-Hercegovine, etj.

Pjesëmarrja si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare

Gjatë periudhës tetor 2009-maj 2010, Universiteti European i Tiranës ka marrë pjesë në 1 (një) projekt me financim të përbashkët të UET me agjensinë Love & Dance, duke organizuar një ballo të veçantë me rastin e festës së Ditës së Shën Valentinit, në Citypark. Për përgatitjen e këtij eventit u trajnuan 11 çifte studentësh të UET-i nga profesionistët e agjensisë Love & Dance. Çiftet e trajnuara performuan 2 vallëzime në hollin e Citypak-ut.

Aktivitete Publike të organizuara nga të tretë në mjediset e UET-it

Gjatë periudhës tetor 2009-maj 2010, në mjediset e UET janë organizuar rreth 33 aktivitete të tilla. Ndër më të rëndësishmet përmenden:

Prezantimi i librit me titull: "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë". *Autore Znj. Nathalie Clayer*

Prezantimi i një grup-filmash me metrazh të shkurtër: "Shenja mbi Ekran." Një grup personash me aftësi të kufizuar, të ndarë në 3 grupe, persona që nuk dëgjojnë, që nuk shikojnë dhe invalidë paraplegjikë, për 3 muaj me radhë nën drejtimin e 3 regjisorëve kanë marrë disa leksione mbi gjuhën audio-vizuale, kinematografike. *Organizuar nga organizata AKT me financimin e ambasadës Holandeze. Z. Kledi Kapexhiu*

Organizimi i seminareve me lektorë të jashtëm, vendas ose të huaj

Nga tetori i 2009 – maj 2010 janë zhvilluar 34 (tridhjetë e katër) të tilla. Ndër to përmenden:

"Negocimi I marrëveshjes me Greqinë për përcaktimin e Shelfit kontinental dhe hapësirave detare përkatëse" me pjesëmarrjen e Z. H. Cili, Z. Ferit Hoxha, Z. Kristaq Gerveni etj.

"POLITIKAT E KONKURRENCES" organizuar nga Ambasada Franceze dhe UET-I, me pjesëmarrjen e Z. A. Civici, Znj. B. Hyska, Prof Jean-Yves Letessier.

"Të ardhmen e mediave në epokën digitale", me pjesëmarrjen e Z. Remzi Lami, Z. H. Cili.

"Prespektiva e Ballkanit Perendimor në BE". Organizuar nga UET-ja në bashkëpunim me Initiative Group Alpbach Tirana. Me pjesëmarrjen e Znj. Moza Gjika, Z. Henri Cili, Dr. Erhard Busek.

"IDENTITETE, INTERESAT DHE PREFERENCAT E EVROPIANËVE TË RINJ BRENDË BE-së". Organizuar nga Znj. PhD Odetta Barbullushi, Z. Nathaniel Copsey.

"Disa Probleme të Gjeo-Energjisë në Ballkan". Organizuar nga Z. Luan Hoxha, studentët e Marrëdhënieve Ndërkombëtare DND dhe M1

"Sfidat e globalizimit dhe dixhitalizimit si dhe impakti i tyre në zhvillimin e medias" organizuar nga Instituti Shqiptar i Medias dhe UET-ja. Me pjesëmarrjen e Z. Adrian Civici, Z. Remzi Lami, Znj. Ilda Londo

"Probleme të historiografisë dhe të filozofisë së historisë" (Filozofia e historisë në mendimin e Hegelit) organizuar nga Instituti i Historisë Bashkëkohore pranë UET-së. Me pjesëmarrjen e Z. Klementin Mile, Prof Ardian Ndreca.

"Asgjë personale? Vetë-rrëfimi si akt publik" Organizuar nga Znj. Belina Budini.

"Kina në arkitekturën e sistemit të sotëm global" Organizuar nga Z. Fatos Tarifa

"Një këndvështrim i përgjithshëm mbi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe disa raste nga Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut" Organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit Znj. V. Meçaj.

Lidhja e kërkimit shkencor me procesin mësimor

Synimi kryesor i veprimtarisë kërkimore shkencore është t'i vijë në ndihmë pasurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së procesit mësimor, si edhe ngritjes së vazhdueshme të standardeve akademike në UET. I gjithë stafi akademik është i angazhuar në procesin e integritetit të rezultateve të punës së tyre kërkimore - shkencore veçanërisht në procesin e mësimdhënies, duke përfshirë jo vetëm në leksione, por edhe seminare, publikimet e tyre në monografi shkencore dhe në revistat që boton UET-i. Shpesh për këtë qëllim organizohen edhe seminare dhe tryeza diskutimesh akademike, me pjesëmarrjen e gjerë të stafit akademik dhe studentëve. Në të gjitha këto veprimtari anëtarët e stafit akademik përditësojnë njohuritë e studentëve me të reja të rezultuara nga puna e tyre hulumtuese, në përputhje me fushat e ekspertizës.

Një mënyrë shumë efektive përmes së cilës realizohet lidhja e kërkimit shkencor me procesin mësimor është organizimi periodik (çdo javë) i tryezave të debatit në fusha të tilla si filozofia, sociologjia, shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto tryeza drejtohen nga pedagogët dhe tërheqin një masë të madhe studentësh dhe anëtarësh të stafit akademik. Prezantimet dhe debatet që zhvillohen në to janë një mënyrë e sigurt dhe mjaft efektive për të informuar studentët dhe kolegët mbi çështje teorike dhe rezultate të kërkimeve shkencore në fushat e sipërpërmendura, për të nxitur

mendimin e tyre racional krijues, si edhe për të rritur angazhimin e vetë studentëve në veprimtarinë kërkimore të instituteve dhe të departamenteve.

Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor

Ndër aktivitetet shkencore ku janë përfshirë edhe studentët përmenden:

A. Sondazhet e organizuara nga Qendra e Studimeve Politike pranë UET-it. Studentët u angazhuan në një studim mbi aftësitë e kuptimit të gjuhës së politikanëve. Studimi mbështetej në një sondazh të realizuar me 760 votues të Tiranës dhe synonte të kuptonte dhe maste aftësinë e tyre për të kuptuar fjalorin dhe metaforat kryesore të përdorura nga politikanët tanë, kryesisht nga liderët. Në sondazh u angazhuan 25 studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale. Studimi u realizua në maj 2007.

B. Universiteti Veror European: “Përdorimet e normës: politika, shoqëria dhe pushteti” Sarandë 1-11 shtator 2008, Organizuar nga Universiteti European i Tiranës, në kuadër të rrjetit ndërkombëtar të studiuesve OFFRES.

Universiteti Veror European i Sarandës u zhvillua në shtator 2008 në kuadrin e Universiteteve Europiane Verore të Organizatës Frankofone për Formim dhe Kërkim Shkencor European në Shkencat Humane (OFFRES), të cilat synojnë zhvillimin afatgjatë të një rrjeti « Europë Qendrore dhe Lindore » që konsiston në kërkim shkencor, specifikisht në atë frankofon në fushën e shkencave humane dhe sociale. Shqipëria kishte për herë të parë ekskluzivitetin organizativ të këtij aktiviteti ndërkombëtar.

Përveç qëllimit shkencor Universiteti Veror European i Sarandës kishte si prioritet thelbësor edhe promovimin e pasurive kulturore shqiptare në jug të vendit, si Kakome, Finiq, Butrint, Ksamil, Sarandë (Kala e Lëkurësit etj), Syri i Kaltër, Gjirokastrë. Ky aktivitet pati referues dhe audiencë të përzgjedhur, midis tyre profesorë, doktorantë, persona me tituj të lartë shkencorë, me akses në universitetet më të mira të Europës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore, botues të një sërë studimesh dhe refleksionesh shkencore, si dhe opinionbërës të njohur në mediat europiane.

Partnerë të UET-it në organizimin e këtij aktiviteti ishin:

- § Agjensia Universitare e Frankofonisë (Zyra e Europës Qendrore dhe Lindore, Zyra e Europës Perëndimore dhe e Magrebit)
- § Ambasada Franceze në Tiranë
- § Ministria Franceze e Punëve të Jashtme (DRIC)
- § Ministria Franceze e Arsimit Kombëtar
- § Ambasada Franceze në vendet respektive
- § Ambasada Greke në Shqipëri
- § Bashkia e Sarandës
- § Fondacioni Soros, Tiranë
- § Universiteti i Tiranës

C. Studimi i Institutit të Studimeve Sociale dhe Politikave: “Realiteti politik, kulturor dhe ekonomik – social i Shqipërisë, 20 vjet mbas fillimit të procesit të tranzicionit demokratik”.

Klubi studentor i çështjeve sociale aktualisht përbëhet nga mbi 30 studentë, të cilët vullnetarisht kanë zgjedhur të përfshihen në aktivitete kërkimore – shkencore, në kuadër të Institutit të Studimeve Sociale dhe Politikave, pranë UET. Ky klub është pjesëmarrës në studimin me temë: *Realiteti politik, kulturor dhe social – ekonomik i Shqipërisë, 20 vjet mbas fillimit të procesit të tranzicionit demokratik*”.

Roli i studentëve në këtë studim është ndërmarrja e kërkimeve empirike, veçanërisht si intervistues dhe anketues.

D. Botimi i një përmbledhje aktesh e dokumentesh të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe, për periudhën e viteve 1922 – 1938.

Instituti i Historisë Bashkëkohore pranë UET-it, ka filluar punën për përgatitjen e një Përmbledhjeje dokumentesh të Foreign Office për Shqipërinë në periudhën e viteve 1922-1938. Përgatitja e këtij botimi do të mbështetet në Raportet Vjetore (Annual Reports) të Foreign Office për Shqipërinë.

Çmime kombëtare ose ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor

Studentët e UET-it kanë arritur të vlerësohen me çmime të ndryshme kombëtare ose ndërkombëtare, si më poshtë:

1. Studentja Dikensa Topi fitoi çmimin e parë për esenë më të mirë në konkursin e organizuar nga Ambasada e SHBA-së në vitin 2008.
2. Studentet Jonilda Hoxha dhe Elona Shehu fituan vendin e parë në konkursin kombëtar që u zhvillua në Sarandë me pjesëmarrjen e studentëve të fakulteteve ekonomike të disa prej universiteteve më të rëndësishme të vendit.
3. Një formë tjetër inkurajimi dhe motivimi për studentët e UET-it është organizimi mbi bazë vjetore e “Çmimit të Rektorit” për esenë më të mirë.

Dokumentacioni përkatës

1. Bazë të dhënash mbi veprimtarinë kërkimore – shkencore të stafit;
2. Udhëzimi mbi politikën e kërkimit shkencor në UET dhe Planin e punës shkencore 2008 – 2009 dhe 2009 – 2010;
3. Udhëzimi mbi Institutet dhe Qendrat e Kërkimit Shkencor dhe Planet e Instituteve;
4. Dosja e veprimtarisë së qendrave;
5. Revistat shkencore dhe botimet e monografive, botimet në proces;
6. Dosja e aktiviteteve shkencore, akademike, social-kulturore të zhvilluara.

VI. Studentët

Politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve dhe pasuniversitarëve

Në lidhje me politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve në të dy ciklet e studimit janë hartuar udhëzime të veçanta.

Programet Master i Nivelit të Parë dhe të Dytë

Informimi dhe ndërgjegjësimi i studenteve dhe individëve të tjerë të interesuar për të ndjekur programet Master realizohet nëpërmjet këtyre formave:

- Organizim, në mjediset e UET-it, i takimeve informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjësuere me grupe studentësh që shfaqin prirje për vijimin e studimeve në ciklin e dytë dhe të tretë.
- Takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e këtyre programeve.
- Përgatitje e materialeve informuese – sqaruese – ndërgjegjësuere si: fletëpalosje, postera, broshura etj., dhe të atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promocionale etj.
- Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të UET-it të “Javëve të Regjistrimit” gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve për ciklin e dytë, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe pajisen me dokumentacionin përkatës.

Parimet e pranimit të studentëve

- Pranimi i studentëve me aftësi akademike për t'u angazhuar seriozisht në projekte studimi individuale ose grupi, për të arritur së bashku krijimin e një mjedisi intelektual ku mësohet, debatohet dhe lindin ide të reja zhvillimi.
- Krijimi i një komuniteti me interesa dhe background të shumëllojshëm, me bindjen se diversiteti e bën procesin e mësimi më të pasur dhe i ndihmon studentët që t'i formulojnë idetë e tyre më mirë në perspektivë.
- Inkurajimi i aplikimeve edhe prej studentëve që kanë kryer studime universitare në fusha të ndryshme nga ato të ofruara në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në UET.

Kriteret e Pranimit. Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formularin e pranimit (ky dokument mund të jetë edhe online)
- Kopjen e noterizuar të diplomave të nivelit pararendës që studenti ka fituar.
- CV-në e kandidatit ku të paraqiten të dhëna biografike dhe eksperiencat profesionale.
- Një Letër Interesi (afërsisht 300 fjalë) ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e nivelit Master.
- Një projekt- ide ku të paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit përkatës të Masterit
- Dy letra rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studime të nivelit Master.
- Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën një avantazh.

Procedura e pranimit

- Të gjithë dokumentet e mësipërme duhet të paraqiten në zyrën përkatëse të programeve.
- Pas një vlerësimi formal të listës së dokumenteve të nevojshme ato i kalohen Komitetit Shkencor përkatës, i cili i bën një vlerësim profesional kushteve të çdo kandidati me kriteret akademike e shkencore të programit dhe harton listën e kandidatëve të pranuar.
- Çdo kandidat zhvillon një intervistë me Komitetin Shkencor të programit rreth projektit të zhvillimit të karrierës, në përputhje me fushën e studimit. Intervista dokumentohet dhe mbahet në Dosjen e Studentit.

- d. Lista e kandidatëve fitues miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe shpallet dy javë përpara fillimit të procesit mësimor.

Programet Diplomë e Nivelit të Dytë (Master Shkencor)

Informimi dhe ndërgjegjësimi. Informimi dhe ndërgjegjësimi i studentëve dhe i individëve të tjerë të interesuar për të ndjekur programet DND realizohet nëpërmjet këtyre formave:

- a. Organizim, në mjediset e UET-it, i takimeve informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjëse me grupe studentesh të ciklit të parë të studimeve që shfaqin prirje për vijimin e studimeve në ciklin e dytë.
- b. Takime e biseda gjysmë formale në institucione dhe organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë.
- c. Përgatitje e materialeve informuese, sqaruese, ndërgjegjëse, si: fletëpalosje, postera, broshura etj dhe i atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promocionale etj.
- d. Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të UET të "Javëve të regjistrimit" gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve, mbi procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe pajisen me dokumentacionin përkatës.

Parimet e pranimit të studentëve

- a. Pranimi i studentëve me aftësi akademike për t'u angazhuar seriozisht në projekte studimi individuale ose grupi, për të arritur së bashku krijimin e një mjedisi intelektual ku mësohet, debatohet dhe lindin ide të reja zhvillimi.
- b. Krijimi i një komuniteti me interesa dhe background të shumëllojshëm, me bindjen se diversiteti e bën procesin e mësimi më të pasur dhe i ndihmon studentët që t'i formulojnë idetë e tyre më mirë në perspektivë.
- c. Inkurajimi i aplikimeve edhe prej studentëve që kanë kryer studime universitare të nivelit të parë në fusha të tjera nga ato të ofruara në UET.

Kriteret e pranimit. Kandidatët duhet të plotësojnë këto dokumente:

- a. Formularin e pranimit (ky dokument mund të jetë edhe online).
- b. Kopjen e noterizuar të diplomave të nivelit të parë që studenti ka fituar.
- c. CV-në e kandidatit ku të paraqiten të dhëna biografike dhe eksperiencat profesionale.
- d. Një Letër Interesi (afërsisht 500 fjalë) ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e nivelit të dytë.
- e. Një projekt-ide ku të paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit.
- f. Dy Letra Rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studime të nivelit të dytë.
- g. Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhë të huaj përbën një avantazh.
- h. Kur Rektorati e shih të arsyeshme vendos test seleksionimi. Në këtë rast pranohen ata kandidatë që kalojnë testin e zhvilluar nga Komisioni përkatës.

Procedurat e pranimit

- a. Të gjithë dokumentet e mësipërme duhet të paraqiten në sekretarinë përkatëse të programeve DND.
- b. Pas një vlerësimi formal të listës së dokumenteve të nevojshme ato do t'i kalohen Departamentit përkatës të programit, i cili i bën një vlerësim profesional kushteve të çdo kandidati me kriteret akademike e shkencore të programit dhe harton listën e kandidatëve fitues.
- c. Çdo kandidat zhvillon një intervistë me departamentin rreth projektit të zhvillimit të karrierës, në përputhje me fushën e studimit. Intervista dokumentohet dhe mbahet në Dosjen e Studentit.
- d. Lista e kandidatëve fitues miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe shpallet dy javë përpara fillimit të procesit mësimor.

Ngarkesa mësimore e studentëve në auditor dhe jashtë tij; sistemi i krediteve

Ngarkesa mësimore e studentëve parashikohet në përputhje me rregulloren e çdo programi studimi. Në këto rregullore pasqyrohet periudha kohore e organizimit të secilës nga disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit, ngarkesa e tyre në ECTS, në orë në auditor dhe orë pune individuale.

Ngarkesa konkrete mësimore për studentët kushtëzohet nga natyra e lëndëve (teorike ose praktike), nga kreditet që ka secila lëndë, si dhe nga mënyra se si përftohen këto kredite.

Lëndët teorike:

Me 6 kredite janë të barabarta me 150 orë pune të ndara si vijon:

Orë në auditor: 15 javë x (3 orë leksion + 1 orë seminar) = 60 orë

Orë pune individuale: 90 orë.

Lëndët praktike:

Me 6 kredite janë të barabarta me 150 orë punë, të cilat ndahen si vijon:

Orë në auditor: 15 javë x (2 orë leksion + 2 orë seminar) = 60 orë

Orë pune individuale: 90 orë

Punimi i diplomës: kriteret, kryerja e tyre, kapaciteti i UET-it

Tema e diplomës është forma përfundimtare e vlerësimit të studentit. Në mënyrë që studenti ta kryejë sa më mirë këtë detyrë, ai udhëhiqet nga një lektor i universitetit i brendshëm ose i jashtëm, i miratuar nga Këshilli i Fakultetit.

Udhëheqësi i diplomës zgjidhet duke pasur parasysh këto kriteret:

- duhet të jetë lektor i universitetit;
- ai/ajo duhet të ketë një diplomë të avancuar në fushën në të cilën studenti do të përgatisë temën e diplomës;
- të jetë ose ketë qenë lektor i lëndës apo lëndëve përkatëse;
- si edhe të ketë kryer punë kërkimore-shkencore në atë temë, qoftë gjatë përgatitjes së tezës së masterit dhe/ose doktoraturës, qoftë në projekte të tjera akademike.
- Drejtuesi i diplomës duhet të ketë një kualifikim jo më pak se Doktor

Specializimi i lektorit është i rëndësishëm, pasi ai/ajo do ta ndjekë studentin gjatë gjithë procesin të përgatitjes dhe shkrimit të temës së diplomës, si edhe do t'i japë udhëzime në lidhje me formulimin e një teze të qëndrueshme, strukturën e temës, si edhe burimet parësore e dytësore.

Punimi i Diplomes së Nivelit të Dytë

Punimi i diplomës duhet të jetë punë e pavarur dhe krijuese e studentit. Ky punim duhet të ketë një bazë të fortë teorike dhe të ketë patjetër një kapitull cilësor konceptual dhe teorik. Qëllimi i këtij punimi është shfaqë aftësitë e studentëve për të mbledhur dhe vlerësuar informacionin, për të analizuar në mënyrë teorike faktet e mbledhura, si dhe për t'i paraqitur përfundimet e arritura në një format akademik. Kjo nënkupton edhe studime të cilat synojnë të 'përmirësojnë/plotësojnë teorinë' ose studime që bëjnë një reflektim mbi 'gjendjen e debatit' teorik.

Punimi i diplomës Master i Nivelit të Parë

Punimi i diplomës në këto programe studimi duhet të trajtojë një çështje empirike që lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe fushën profesionale ku do të punojë studenti/ja. Tema mund të jetë studim i një rasti, ose studim krahasues. Kështu, ky lloj studimi ose hyn shumë thellë në problematikën e një rasti të veçantë studimi ('case study') që: a. është studiuar pak ose aspak, ose b. mbi të cilin gjykohet se literatura është e mangët, ose c. është një çështje emergjente që del nga debati apo eksperiencia në terren (empirike). Rrjedhimisht ky lloj studimi nuk merr përsipër të përmirësojë teori apo të hape shtigje të reja teorike apo/dhe të prezantojë modele të reja konceptuale.

Punimi i diplomës/mikroteza e Masterit të Nivelit të Dytë

Kjo diplomë nënkupton aftësi të thelluara të studentit në lëmin teorik, ashtu dhe atë empirik, në një disiplinë të caktuar ose në një rrafsh ndërdisiplinor. Tema specifike vendoset mes studentit dhe udhëheqësit, duke u bazuar në disa kriterë bazë si: interesi i studentit, ekspertiza e ofruar nga stafi akademik, interesi i kërkimor i pedagogut udhëheqës dhe mundësia reale e kryerjes së projektit.

Aktivitetet studentore

Ndër aktivitetet e zhvilluara me studentët nga viti 2006-2009 janë:

- § “Bursat e ekselencës dhe Çmimi i Rektorit”. Është i treti vit që në UET akordohen bursa për studentët me mesatare të lartë, si dhe për ESE-në më të mirë. Kjo është një formë e stimulimit e motivimit për studentët me rezultate të larta. Por, gjithashtu, bursa janë dhënë edhe për kategori më specifike, si bursa për fëmijët e policëve të vrarë, fëmijët e komunitetit Rom, bursa për talentet e reja, bursa për të rinjtë e forumeve politike, etj.
- § “Let’s Play Golf” Golf & Tennis Klub Tirana, Kompleksi i parë dhe i vetëm në Shqipëri që ofron mundësinë e lojës së golfit. Akademia e Golfit përgatit një brez të ri lojtarësh golfi në Shqipëri. Ndër temat që u trajtuan në këtë aktivitet nga Znj. Albana Veleshnja (Kryetare e Golf & Tennis Klub Tirana) ishin: familjarizimi me rregulloren e lojës së golfit, përdorimi i shkopinjve të golfit, mësimi i qëndrimit, gjuajta e topit, shënimi në distancë të shkurtër etj.
- § Mundësi studimi në Queen Mary, University of London “The Success of Your Future Studies is Our Mission”, një prezantim për studentët e vitit të fundit për mënyrën se si mund të aplikojnë për të studiuar në programet master pranë Queen Mary, University of London.
- § Shfaqja e filmit “Persepolis” me temë “Revolucioni Islamik i vitit 1997 në Iran”. Fitues i dy çmimeve në festivalin e filmit Kanë dhe kandidat për dy çmime OSCAR (2007).
- § “Takim me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale”, në lidhje me shqetësimet, problemet, sugjerimet etj, gjatë semestrit të parë akademik. Ky takim u zhvillua me iniciativë të Znj. Enika Abazi (Dekane e Fakultetit të Shkencave Sociale UET), për të qenë sa më pranë studentëve.
- § Që nga viti 2008 e në vazhdim aktivitete të tjera me studentët janë edhe Tryezat e Rrumbullakëta ose “LECTIO”-t. Këto takime kanë natyrë thelbësisht teorike. Ka një ndarje paraprake sipas fakulteteve apo çështjeve tematike, por pjesëmarrja e studentëve dhe pedagogëve nuk kushtëzohet nga kjo ndarje. Si të tilla, në këto tryeza pritet të zhvillohen analiza teorike të koncepteve themelore bazuar në autorët dhe veprat më të rëndësishme të mendimit njerëzor. Universiteti si vendi ku përpunohet fraza dhe ligjëratat, e bashkë me to dhe aftësia për leximin e teksteve me kompleksitet të lartë teorik, vendoset përballë studentëve në këtë hapësirë konceptuale “tryezë e rrumbullakët”.

Formati dhe aplikimi praktik i tryezave të rrumbullakëta:

- § “Lectio Philosophia”, në të cilën përgjithësisht trajtohen momente teorike të lidhura sidomos me filozofinë, por jo vetëm. Në këtë tryezë pjesëmarrës janë studentë nga të gjitha degët e studimit. Grupi i përhershëm përbëhet nga 25 studentë dhe 2 pedagogë. Në përputhje me temat dhe autorët ftohen edhe pedagogë referues dhe bashkëbisedues.
- § “Lectio Politicus”, në të cilën trajtohen teori dhe shkolla mendimi përgjithësisht të modernitetit dhe bashkëkohësisë, duke u integruar me aplikimet e tyre specifike në kontekste konkrete (vende, shtete, qeveri). Në këtë tryezë pjesëmarrës janë studentë nga degë të shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave të komunikimit. Grupi përbëhet nga 15-25 studentë dhe 2 pedagogë. Në përputhje me temat dhe autorët ftohen edhe pedagogë referues dhe bashkëbisedues, përgjithësisht nga Fakulteti i Shkencave Sociale.

Aktivitete të zhvilluara me studentët për periudhën tetor 2009- maj 2010 janë 30 (tridhjetë), ndër to përmendim:

- § Universiteti European i Tiranës dhe Instituti i Politikave Mjedisore shfaqin filmin me titull: “The Age of Stupid” Z. E. Pacara

- § Instituti i Studimeve Sociale dhe Politike "Soc-Club" njofton të gjithë studentët për ndërtimin e Klubit të Sociologëve të Rinj. Organizuar nga studentja Znj. E. Shehu
- § Filmi me titull: " Thank you for Smoking"
- § Zyra e Karrierës dhe Praktikave pranë UET-së në bashkëpunim me Raiffeisen Bank organizojnë takimin me temë të hapur : INTERSHIPI NE RAIFFEISEN BANK"
- § Prezantimi i kompanisë Eagle me temë: "Strategjitë e Punësimit dhe motivimit në Eagle Mobile"

Punësimi i të diplomuarve: aksesimi në tregun e punës dhe përputhja e tyre me këtë treg

Nëpërmjet mbajtjes vazhdimisht në vëmendje të zhvillimeve të tregut të punës, synohet të orientohet përmbajtja e kurrikulave që ofrohen, duke synuar përputhjen e tyre me dinamikën e tregut të punës. Nëpërmjet planifikimit dhe organizimit të praktikave, synohet që këtyre studentëve t'iu mundësohet një njohje e drejtpërdrejtë dhe konkrete e tregut të punës, vendosja e kontakteve me institucione publike dhe private, si dhe me individët drejtues të tyre, duke u kujdesur që zhvillimi i këtyre praktikave të kryhet në institucionet që i përgjigjen më mirë fushës së studimit të studentit.

Pjesëmarrja në panairin e punës, krijimi i kontakteve nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet publike, si dhe me operatorët e sektorit privat, janë disa nga mënyrat që po përdoren për të informuar studentët dhe mundësuar aksesin e tyre në tregun e punës, në përputhje me kërkesat e tij.

Studentët e diplomuar nxiten të pasurojnë më tej njohuritë akademike dhe aftësimin profesional, duke u dhënë mundësi të vijojnë studimet duke u bërë kështu më kompetitivë në tregun e punës.

Posaçërisht për këtë qëllim në datën 20 Maj në mjediset e UET u zhvillua Panairi i Parë i Punës i organizuar dhe ideuar nga Zyra e Karrierës së UET. Ky event kishte si qëllim t'i orientonte studentët drejt tregut të punës dhe vështirësive të tij aktuale. Ai gjithashtu iu dha studentëve mundësinë të testoheshin në situata konkrete nëpërmjet intervistave dhe t'u drejtonin kompanive prezente pyetje direkte mbi veprimtarinë dhe politikat e tyre të punësimit. Në këtë event studentët gjetën kompanitë më të rëndësishme që operojnë në Shqipëri dhe iu krijua mundësia që të takoheshin me stafin e burimeve njerëzore të këtyre kompanive. Kontakti me zyrat e burimeve njerëzore të kompanive prestigjioze përgjithësisht (dhe jo vetëm në Shqipëri) është i vështirë ndaj këtë proces u përpoq ta lehtësonte ky panair. Kompanitë që morën pjesë dhanë informacion mbi veprimtarinë e tyre, procedurat e rekrutimit të studentëve/stafit të ri si edhe për mundësi internshipi dhe/ose për mundësi punësimi.

Kompanitë që morën pjesë në panairin e punës:

- VODAFONE ALBANIA
- EAGLE MOBILE
- P & P
- DM CONSULTING
- AGNA GROUP
- COCA COLA
- TIRANA INTERNATIONAL
- AIRPORT "NËNË TEREZA"
- OPPORTUNITY ALBANIA
- BANKA KOMBËTARE TREGTARE
- RAIFFEISEN BANK
- C C S
- ANTEA CEMENT
- OGILVY
- ATLANTIK

- CREDINS
- UNION BANK
- COMPORT
- IC Bank
- SCAN TV
- SIGAL
- Etj.

Informimi i studentëve me të drejtat dhe detyrat, programet mësimore, udhëzues të kurseve të studimit etj.

Informimi i studentëve në lidhje me programet e studimit dhe kurrikulat realizohet që në momentin e parë të kontaktit të tyre me stafin akademik dhe administrativ të UET-it, kur ata interesohen rreth mundësive për ndjekjen në këtë institucion të arsimit të lartë ; gjatë javës së orientimit në fillim të çdo viti akademik, si dhe përmes njoftimeve të vazhdueshme që shpallen nga Sekretaria ose Dekanatet dhe përmes faqes së internetit të UET-it.

Në çdo fillim semestri, studentët informohen për mënyrën se si është konceptuar dhe organizuar lënda nga pedagogu përkatës, i cili u vë në dispozicion një kopje të programit të lëndës. Ky program përmban informacion të detajuar për temat që do të zhvillohen gjatë 15 javëve të semestrit, format e kontrollit dhe vlerësimit, si dhe literaturën e detyrueshme, plotësuese dhe të rekomanduar.

Gjithashtu studentët informohen gjatë orëve të Tutoriatit dhe Këshillimit Akademik, ku ata mund të sqarohen për çdo paqartësi që kanë në lidhje me sistemin e studimeve dhe programin mësimor dhe mund të marrin asistencën e nevojshme për mbarëvajtjen e studimeve të tyre.

Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programeve, të procesit të mësimdhënies dhe përfaqësimi i tyre në strukturat qeverisëse të UET-it

Gjatë periudhës 2009-2010, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit ka qenë një përpjekje konstante dhe e vazhdueshme. Studentët më aktivë dhe më të mirë në mbarim të vitit të parë dhe të dytë, përfaqësues të Këshillit Studentor, të rrjetit të bursistëve të UET-it, student të ardhur nga universitete evropiane e amerikane, apo dhe studentë në marrëdhënie pune që njohin më nga afër tregun e punës, etj., janë përfshirë në të gjitha etapat dhe fazat e diskutimit dhe miratimit të programeve.

Po kështu në grupin special të punës të ngritur nga Rektorati për hartimin e programeve të reja 2009-2010 u përfshinë në mënyrë konstante edhe katër student përfaqësues nga tre fakultetet, si dhe një përfaqësues i Këshillit Studentor.

Në mënyrë më të gjerë se kaq, janë organizuar dhe tre tavolina të rrumbullakëta me përfaqësues të studentëve për të vjelë mendimin e tyre për nivelin e programeve mësimore bazë, për tekstet mësimore, librat bazë për lëndët kryesore formuese, si dhe përmbajtjen e silabuseve të pjesës dërrmuese të lëndëve. Angazhimi i studentëve për të vlerësuar nivelin, përmbajtjen dhe cilësinë e mësimdhënies është zhvilluar në një masë shumë të gjerë. Çdo semestër janë organizuar anketime masive të studentëve, nëpërmjet një pyetësoi të standardizuar për të marrë vlerësimet e tyre për përmbajtjen e programit dhe lëndëve të veçanta, metodat dhe metodologjinë e zhvillimit të mësimi, nivelin e komunikimit të pedagogëve, efektivitetin e literaturës së përdorur, cilësinë e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, efikasitetin e aktiviteteve plotësuese, etj. Të gjitha të dhënat e nxjerra nga pyetësoi, duke ruajtur konfidencialitetin e studentëve, janë përpunuar dhe rezultatet e tyre janë bërë objekt i veçantë dhe i zgjeruar diskutimi në dekanate, Rektorat dhe Senat. Mbi bazën e rezultateve të përpunuara janë marrë të gjitha masat e duhura si për të thelluar akoma më tej rezultatet e mira, ashtu dhe për të eliminuar të metat e vëna në dukje nga studentët.

Përfaqësimi i studentëve në strukturat qeverisëse është realizuar nëpërmjet përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në këto struktura. Konkretisht, Kryetarët e Këshillit Studentor të secilit fakultet, përkatësisht tre, janë anëtarë të Senatit Akademik, si dhe anëtarë të dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu, Këshilli Studentor ka përfaqësues në Rektorat, Këshillin e Etikës dhe në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Rritja e partneritetit dhe konsultimi me studentët shprehet dhe në takimet e rregullta të Rektoratit dhe dekanateve me rrjetin e studentëve bursistë, me tavolinat e rrumbullakëta tematike që zhvillohen me grupe të zgjedhura studentësh, takime periodike të rektorit dhe dekanëve me grupe studentësh, etj.

Organizimi i zgjedhjeve për Këshillin e Studentëve

Çdo vit akademik studentët kanë pasur mundësinë të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Këshillin Studentor. Duke ecur në të njëjtën rrugë edhe për këtë vit akademik u zhvilluan zgjedhjet e reja për Këshillin e ri Studentor. I gjithë procesi u organizua nga vetë studentët. U krijua një Komision Zgjedhor, i përbërë nga Kryetari dhe 6 anëtarë, të cilët monitoruan gjithë procesin zgjedhor konform rregullave. Dita e zgjedhjeve ishte data 08.04.2010. Nga këto zgjedhje dolën fitues 29 përfaqësues të gjithë studentëve. Në një raund të dytë u zgjodhën dhe kryetarët e Fakulteteve. Ky vit akademik u pasua nga një sërë ndryshimesh krahasuar nga vitet e kaluara. Tashmë nuk ka më një President të Këshillit Studentor, por çdo Fakultet përfaqësohet nga Kryetari i tij i Këshillit Studentor, si dhe mandati i të zgjedhurve është 2 vjet.

Mbledhjet periodike të Këshillit Studentor që zhvillohen do muaj me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të njësive kryesore dhe/ose bazë, në lidhje me ecurinë e procesit akademik dhe me problematikën e hasur nga studentët, janë një mënyrë për të qenë sa më pranë interesave dhe kërkesave të studentëve.

h) Dokumentacioni përkatës

1. Udhëzimi i pranimeve në UET dhe dosja e aplikimeve;
2. Dosja e kontratave të studentëve;
3. Udhëzimi dhe dosja e internshipit;
4. Udhëzimi mbi diplomat dhe dosja përkatëse;
5. Dosja e aktiviteteve shkencore, akademike, social-kulturore të zhvilluara;
6. Dosja/paketa e Javës së Orientimit;
7. Dokumente të përfshirjes së studentëve në veprimtarinë e UET-it.

VII. Fasilitetet, burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Mjediset dhe asetet e duhura për kryerjen e procesit mësimor: sallat e leksioneve, laboratorët, mjetet e pajisjet për përgatitjen teorike dhe praktike

Sipërfaqja totale e godinës në të cilën zhvillon veprimtarinë e tij UET-i është 5600 metra katror.

Në total, në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor janë 21 salla leksionesh dhe seminaresh. Konkretisht, ka 5 salla leksionesh me kapacitet prej 100 vendesh secila, 1 sallë leksionesh me kapacitet 200 vende, 3 salla leksionesh me kapacitet 70 vende, 1 laborator informatike me kapacitet 30 vende, 1 sallë seminaresh me kapacitet 20 vende, si dhe 12 salla seminaresh me nga 35 vende secila. Çdo sallë leksioni dhe seminari është e pajisur me tabela porcelani, flip charter, lidhje internet me dhe pa kabëll, kompjuter, video projektor, si dhe për 6 nga sallat e leksionit ka sistem modern fonie fiks dhe të lëvizshëm. Numri maksimal i studentëve që mund të jenë në mësim në të njëjtën kohë është 1200.

Lidhjet me internet, pajisje kompjuterike për stafin e studentët

Lidhja me internetin ofrohet në çdo PC në UET, me përjashtim të atyre në sallat të leksionit, ku nuk është parë e arsyeshme të ofrohet. Në shërbim të studentëve është një sallë kompjuterash, ku aktualisht ndodhen 74 të tillë, të lidhur gjithashtu edhe me një printer rrjeti. Aty qëndron vazhdimisht një person, i cili ndihmon studentët për printimet, si dhe i asiston për probleme të ndryshme që mund të hasen gjatë punës së tyre. Edhe në bibliotekë, krahas 2 kompjuterave për punonjësit, ndodhen edhe 5 kompjutera të tjerë në shërbim të studentëve, edhe këta të lidhur me internet. Gjithashtu në ambientet e UET-it ofrohet edhe Internet ëreless falas për të gjithë studentët, si dhe për klientët që frekuentojnë lokalin BAR UET.

Zyrat e Administratorit, Rektorit, Dekanëve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kancelarit, si dhe çdo zyrë tjetër e stafit drejtues dhe administrativ, janë të pajisura me PC dhe printer. Çdo pedagog i brendshëm ka një PC që e përdor vetëm ai. Për pedagogët e jashtëm ka një PC në çdo sallë pedagogësh, në tre të tilla që janë aktualisht, nga një për pedagogët e secilit fakultet. Zyrat e koordinatorëve pranë fakulteteve janë të pajisura me PC, ndërsa për printime përdorin printerat e rrjetit të pedagogëve. Sekretaria qendrore është e pajisur me një PC për çdo sekretare, si dhe tre printera. Edhe zyra ku zhvillohet tutoriati dhe këshillimi akademik është e pajisur me 2 PC dhe një printer.

Sistemi kompjuterik mbrohet nga ndërhyrjet e jashtme me anë të një sistemi mbrojtës të fjalës së fundit të teknologjisë. Gjithashtu në çdo PC është instaluar *McAfee Antivirus*, i cili menaxhohet në mënyrë qendrore nga zyra e IT-së. Shërbimi *Email*, *Fileserver* dhe *Domain Controller* mbulohet me 3 servera, prodhim i fundvitit 2008. Dosja *My Documents* e çdo kompjuteri ruhet ne Server për arsye sigurie

Lista e Investimeve	Pershkrimi i Investimit	Vendi	Vlera (në 000 Lekë)	Viti i Investimit
Infrastruktura Mesimore (Godina, Klasa, Auditore etj)			375.87	
<i>Investimet</i>	Ambjenti me qera	Ish NPV2	22.834	2006 – 2009
<i>Godina e Rikonstruktuar</i>	Hartimi i ambientit funksional	Ish NPV2	217.754	2007 – 2009
<i>Godina e Re</i>	Ambjent me qera rikonstrukcion	Ne krah te Ish NPV2	16.332	2009
	Pajisje kompjuteri		62.45	
	Mobilje		56.5	2006-2009
Investime në Bazë Mesimore (Laboratore, Biblioteka etj)			35.897	
Labratori	Mobilje		6.15	2006-2009
Biblioteka	Librat, biblioteka online		16.7	2006-2009
	Perkthime librash, botime librash		3.793	2009

Lista e Investimeve	Pershkrimi i Investimit	Vendi	Vlera (në 000 Lekë)	Viti i Investimit
	Mobilje		9.254	2007-2009
Investime në Teknologjinë e Informacionit			34.551	
Sallat, zyrat, biblioteka, interneti	Pajisje kompjuterike, blerje licencash per programe		34.551	2006 - 2009
Të tjera			7.131	
Kondicionimi	Zyra, Laboratore, etj		5.616	2007-2009
Interneti	Interneti		1.815	2006-2009
	Gjenerator		1.4	2007
Totali			453.449	2006 - 2009

Libraria, biblioteka dhe kapaciteti i tyre në raport me stafin dhe studentët

Libraria universitare dhe biblioteka janë pjesë e rëndësishme e infrastrukturës mësimore e shkencore të UET-it.

Libraria plotëson përgjithësisht nevojat bazë për tekstet e domosdoshëm mësimorë të përkthyer në shqip dhe leksionet e shumëfishuar që jepen në auditor nga pedagogët, si edhe nevojat për literaturë suplementare pothuajse për të gjitha lëndët që përfshihen në programet mësimore.

Biblioteka përmban një fond që pasurohet vazhdimisht me tekste mësimore, libra dhe periodikë shkencorë në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht dhe italisht). Pjesa më e madhe e teksteve dhe monografive që përdoren si materiale bazë, apo rekomandohen në programet mësimore disponohen në disa kopje. Kur biblioteka e disponon një tekst bazë në një kopje të vetme, ai shumëfishohet përmes fotokopimit dhe vihet në dispozicion të studentëve në sasi të mjaftueshme. Biblioteka ka në fondin e saj mbi 1690 tituj librash (tekste, monografi, manuale, fjalorë, enciklopedi), një pjesë e madhe e të cilave disponohen në më shumë se 3 kopje, ndonjëherë edhe 5 ose 10 kopje. Këta tituj përfaqësojnë të gjitha disiplinat që përbëjnë programin akademik të UET-it në të tre fakultetet e tij. Numri i titujve të librave që disponohen dhe vihen në shërbim të stafit akademik dhe studentëve ka ardhur duke u rritur nga muaji në muaj. Për të përmbushur nevojat e stafit akademik dhe kërkimor-shkencor, biblioteka porosit vazhdimisht tituj të ndryshëm përmes shërbimeve në Internet si amazon.com dhe nga botues të ndryshëm në vende të ndryshëm të Europës dhe në Shtetet e Bashkuara.

Biblioteka e UET-it disponon gjithashtu një koleksion periodikësh shkencorë në fusha të ndryshme, në shqip dhe në gjuhë të huaj, një pjesë e të cilëve janë siguruar përmes abonimit vjetor e në vazhdimësi. Për t'u ardhur në ndihmë sa më mirë studentëve dhe pedagogëve me literaturë (libra dhe revista akademike) të arkivuar në sistemet e bibliotekave elektronike *Questia* dhe *Jstor*, biblioteka mundëson shfrytëzimin falas të fondeve të këtyre sistemeve.

Për të vënë në dijeni stafin dhe studentët për titujt e rinj që i shtohen fondit të saj, biblioteka organizon periodikisht vitrinën e librit të ri.

Biblioteka qëndron e hapur 12 orë në ditë, me përjashtim të të dielave. Po aty studentët mund të printojnë apo të fotokopojnë materialet përkatëse.

Në kuadër të Consorciut Universitar Shqiptar, në të cilin bëjnë pjesë: Universiteti European i Tiranës, Universiteti "Polis", Akademia e Filmit "Marubi" dhe Fakulteti i Drejtësisë "Luarasi", bibliotekat e tyre konsiderohen si asete për përdorim reciprok nga studentët që frekuentojnë këto institucione të arsimit të lartë.

Mbulimi i lëndëve e kurseve të studimit me literaturë shtesë nga fondi i bibliotekave qendrore apo të njësive (departamenteve)

Për të siguruar mbulimin e të gjitha disiplinave që zhvillohen në UET, biblioteka e këtij universiteti mban lidhje bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare, me bibliotekat e disa fakulteteve të Universitetit të Tiranës dhe të disa universiteteve jopublike. Kjo bibliotekë disponon listën e plotë të të gjitha botimeve (libra, tekste dhe monografi) që ndodhen në fondin e Bibliotekës Kombëtare, në bibliotekën e fakulteteve të drejtësisë dhe ekonomisë, në bibliotekën e Shkollës së Magjistraturës dhe në Librarinë Universitare, për fushat e ekonomisë dhe të drejtësisë, të cilat përbëjnë drejtimet e studimeve akademike në dy prej tre fakultete të UET-it. Për të përmbushur nevojat e stafit pedagogjik dhe të studentëve Biblioteka e UET-it huazon libra dhe tekste nga bibliotekat e sipërpërmendura dhe e pasuron fondin e saj me botimet e domosdoshme për këtë qëllim.

Shërbime të tjera për studentët: salla studimi, fotokopje, printim, kërkim literature, shërbim informacioni, stafi i shërbimit etj.

Në ambientet e bibliotekës studentët kanë mundësi të studiojnë në qetësi dhe të rrethuar nga shumë tituj librash. Biblioteka ka një sipërfaqe prej rreth 300 metra katror, 6 poste pune me kompjutera për stafin dhe studentët, mundësi lidhje me internet jo-kabllor, si dhe 120 vende studimi. Në ndihmë të studentëve punon një staf i kualifikuar dhe me përvojë.

Për studentët ofrohet shërbimi i fotokopjes, i cili mundësohet nga dy pajisje të avancuara të markës Konica Minolta me një shpejtësi prej 120 faqesh në minutë, si dhe nga dy fotokopje Samsung me kapacitet më të vogël. Studentët asistohen nga një staf i specializuar për këtë proces.

Salla e kompjuterave është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga ora 9:00 e mëngjesit deri në 20:00 të mbrëmjes. Studentët kanë në dispozicion 80 poste pune me kompjutera të markës HP, model i 2008, internet pa limit të një cilësie shumë të mirë, si dhe printerat për të printuar materialet mësimore. Këtu ata asistohen nga një staf i specializuar.

Mjedis tjetër ku studentët mund të kërkojnë literaturën e nevojshme është edhe libraria e UET-it, e vendosur në katin e parë. Aty gjenden pjesa më e madhe e teksteve bazë, si dhe tituj të tjerë ndihmës. Studentëve u ofrohet informacioni i nevojshëm nëpërmjet:

- Ø Stafit, i cili përbëhet nga 3 sekretare, 5 koordinatorë, tre punonjës të bibliotekës, tre specialistë të IT-së, koordinatorja e zyrës së aktiviteteve, nga punonjësit e zyrës së financës, si dhe nga çdo anëtar i stafit drejtues dhe akademik.
- Ø Rregullores, e cila i vihet në dispozicion studentit, si pjesë integrale e kontratës që lidh me UET-in. Nëpërmjet saj studentët njihen me mënyrën se si UET-i vepron, të drejtat dhe detyrimet përkatëse, si dhe me mënyrat se si funksionojnë marrëdhëniet mes palëve.
- Ø Faqes zyrtare në internet, ku afishohen të gjitha njoftimet përkatëse, si dhe komunikimi nëpërmjet postës elektronike.
- Ø Tabelave afishuese, ku shpallen njoftime të ndryshme; ka rreth njëzetë tabela të tilla.

Personeli administrativ dhe ai ndihmës mësimor përbëhet nga 39 vetë. Konkretisht, kancelari, sekretarja e përgjithshme, 3 sekretare, 5 koordinatorë, financierja, arkëtarja, specialistja e kurrikulave, specialistët e IT-së, punonjësit e bibliotekës, koordinatorja e zyrës së aktiviteteve, stafi i shtëpisë botuese UET Press, punonjësit e sigurisë, përgjegjësi i godinës, specialisti i fotokopjes, punonjësja e librarisë, katër punonjëse sanitare dhe lulishtari.

Shërbime të tjera për stafin dhe studentët: mjedise sportive, çlodhëse, argëtuese etj.

Për krijimin e një ambienti sa më komod dhe funksional, në ambientet e UET-it ndodhet një bar, i cili ofron shërbimet bazë për plotësimin e nevojave të stafit dhe studentëve. Këto ambiente janë të hapura dhe pa pagesë për studentet dhe stafin në rastin kur ata zhvillojnë evenimente argëtuese.

Në shërbim të studentëve dhe stafit është edhe restoranti i shkollës, i cili ofron ushqim cilësor dhe me kosto relativisht të ulët. Në total këto ambiente kanë një sipërfaqe prej 500 metra katrorë dhe një kapacitet prej 160 vendesh.

Në mjediset përreth shkollës ofrohet parkim me një kapacitet prej 130 vende parkimi.

Në oborr, me një sipërfaqe prej 850 metra katror, gjenden mjedise të këndshme me gjelbërim të përhershëm, si dhe janë vendosur edhe shumë stola në funksion të stafit dhe studentëve.

Në katin e parë të godinës ndodhet holli, i përshtatshëm për qëndrim dhe çlodhje, ku nuk mungojnë pikturat apo fotografitë e ndryshme, shoqëruar me një dekor shumë funksional, të përshtatshëm për organizimin edhe të aktiviteteve dhe ceremonive të ndryshme.

Dokumentacioni përkatës

1. Inventari i UET-it;
2. Udhëzimi mbi Bibliotekën dhe inventari.

VIII. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Burimet e financimit dhe statistikat e 5 viteve të fundit.

Shkolla e Lartë Universitare Private “Universiteti European i Tiranës”, “ U.E.T” shpk si burim financiar ka të ardhurat nga veprimtaria arsimore të cilat ndahen në dy kategori në të ardhura të vitit korent dhe të ardhura të mara në avancë, si dhe financimi me anë të kredisë nga banka dhe interesat bankare. Më poshtë është pasqyruar një tabelë në lidhje me burimet financiare të Universitetit.

Ref	Të ardhura	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Totali
1	Te ardhura nga studentet	8.917.454	56.790.772	189.764.886	346.776.917	602.250.029
2	Te ardhura nga interesat	17.448			637.889	655.347
3	Te ardhura ne avance	43.578.557	356.467.842	223.053.338	132.413.356	132.413.356
4	Financim nga kredi bankare		50.000.000	15.000.000	8.400.000	73.400.000
	Totali	47.513.459	413.308.614	427.818.224	488.228.172	808.718.732

Përdorimi i burimeve financiare dhe skema e përdorimit të financave për pesë vitet e fundit.

Përdorimi i burimeve financiare të “U.E.T.” shpk është kryesisht në funksion të zgjedhjes së një stafi akademik të aftë për të arritur misionin e vet, krijimit të një infrastrukture moderne dhe në përputhje me normat bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe krijimin e një data baze elektronik dhe fizike të të gjithë teksteve të duhura për procesin akademik. Janë pikërisht këto zëra që zënë peshën më të madhe të përdorimit të burimeve financiare. Më hollësisht detajohen në tabelën e mëposhtme.

Ref	Shpenzimet sipas Zërave në Lekë	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Totali
1	Pagat e personelit	200.000	12.648.157	45.540.505	104.427.016	162.815.678
2	Personeli i Jashtëm	1.146.976	5.660.943	21.535.043	76.694.286	105.307.248
3	Sigurimet shoqërore	43.400	932.710	4.347.692	7.473.635	12.797.437
4	Qera objekti	1.254.600	6.302.115	10.584.900	13.499.607	31.641.222
5	Tatime dhe taksa të tjera	1.362.699	21.800	3.442.195	2.389.471	7.216.165
6	Shpenzime në pritje përcjellje	287.500	470.075	3.535.200	3.194.767	7.487.542
7	Nentrajtime të përgjithshme (kancelari)	198.620	804.818	2.332.352	5.724.537	9.060.327
8	Poste / telefon (amc)	499.193	5.003.304	7.123.795	7.963.673	20.589.965
9	Udhëtim dhe dieta	0	0	233.147	212.430	445.577
10	Shpenzime administrative	59.456	7.439.805	6.136.032	26.048.018	39.683.311
11	Energji avull uje	0	0	3.654.804	3.580.402	7.235.206
12	Shpenzime të tjera (lëndë djegëse)	0	39.000	125.393	355.250	519.643
13	Instalim dhe mirëmbajtje interneti	156.400	383.616	761.276	629.797	1.931.089
14	Reklama dhe publicitet	2.423.410	8.097.055	11.301.542	21.213.101	43.035.108
15	Hartim spoti reklame	119.040	251.800	566.400	1.984.000	2.921.240
16	Transport	3.593	0		407.186	410.779
17	Shpenzime interesi	29.515	1.073.918	8.044.996	7.358.799	16.507.228
18	Amortizim	86.025	2.914.643	13.015.487	16.818.896	32.835.051

Ref	Shpenzimet sipas Zërave në Lekë	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Totali
19	Gjoha penalitet	40.000	0	457.884	5.371.078	5.868.962
TOTALI I		7.910.427	52.043.759	142.738.643	305.345.949	510.172.408
Lista e aseteve						
1	Libra (asete)	538.599	1.318.600	5.264.136	14.779.206	21.900.541
2	Pajisje të ndryshme (asete)	1.228.633	1.405.537	187.550	2.739.500	2.739.500
3	Instalime të ndryshme (asete)		8.320.649	14.034.292	9.352.573	9.352.573
4	Rikonstruksioni i ndërtesës		70.702.815	80.360.114	83.027.830	83.027.830
5	Pajisje zyre / informatike (asete)	3.495.055	28.611.762	44.412.458	54.844.180	54.844.180
TOTALI II		5.262.287	110.359.363	144.258.550	164.743.289	171.864.624
1	Tatim Fitimi	100.000	931.409	1.972.431	4.095.635	

Shpenzimet për studentët dhe kostot e studimit për student për vit akademik

Dihet që për vetë misionin e "U.E.T." shpik shpenzimet bazë janë pikërisht në lidhje me mësimdhënien, kërkimet shkencore si dhe krijimin e kushteve sa më komode për studentët. Pikërisht më poshtë detajohen shpenzimet bazë për të arritur këtë mision, dhe është përcaktuar kostoja për një student, e cila për vetë rritjen e vazhdueshme të numrit të studentëve ka ardhur në rritje nga viti në vit.

Nr.	Zërat	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Totali
1	Pagat e personelit	200.000	12.648.157	45.540.505	104.427.016	162.815.678
2	Personeli i Jashtëm	1.146.976	5.660.943	21.535.043	76.694.286	105.037.248
3	Sigurimet shoqërore	43.400	932.710	4.347.692	7.473.635	12.797.437
4	Qera objekti	1.254.600	6.302.115	10.584.900	13.499.607	31.641.222
5	Shpenzime në pritje përcjellje	287.500	470.075	3.535.200	3.194.767	7.487.542
6	Nëntrajtime të përgjithshme (kancelari)	198.620	804.818	2.332.352	5.724.537	9.060.327
7	Poste / telefon (amc)	499.193	5.003.304	7.123.795	7.963.673	20.589.965
8	Udhëtim dhe dieta	0	0	233.147	212.430	445.577
9	Shpenzime administrative	0	7.439.805	6.136.032	70.370.883	83.946.720
10	Energji avull ujë	0	0	3.654.804	3.580.402	7.235.206
11	Shpenzime të tjera (lëndë djegëse)	0	39.000	125.393	355.250	519.643
12	Instalim dhe mirëmbajtje interneti	156.400	383.616	761.276	629.797	1.931.089
13	Reklama dhe publicitet	2.423.410	8.097.055	11.867.942	21.213.101	43.601.508
14	Hartim spoti reklame	119.040	251.800	566.400	1.984.000	2.921.240
Totali i Shpenzimeve		6.329.139	48.033.398	117.778.081	317.323.384	490.030.402
Nr i studenteve për vit		160	574	1.334	2.954	
Kosto për studentë		39.557	83.682	88.289	107.422	

Shpenzimet për mësimdhënie, kërkim shkencor, administrim, pajisje etj.

Shpenzimet bazë janë pikërisht për mësimdhënien, kërkimet shkencore dhe krijimin e një mjedisi të standardeve bashkëkohore për studentët. Ndër zërat kryesorë përmendim shpenzimet për kërkimet shkencore, për përkthime të ndryshme për librat e studentëve, për fushatat publicitare etj.

Nr	Zërat	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Totali
1	Pagat	1.390.376	19.241.810	71.423.240	181.391.302	273.446.728
2	Pajisje Zyre informatike	3.495.055	28.611.762	44.412.458	54.844.180	54.844.180
3	Blerje libra	538.599	1.318.600	5.264.136	14.779.206	21.900.541
4	Shpenzime administrative	2.367.978	16.923.545	35.852.704	70.370.883	125.515.110
5	Instalim dhe mirëmbajtje rrjeti interneti	156.400	383.616	761.276	629.797	1.931.089
6	Reklamë dhe publicitet	2.542.450	8.348.855	11.867.942	21.213.101	43.972.348
7	Kancelari	198.620	804.818	2.332.352	5.724.537	9.060.327
8	Qera	1.254.600	6.302.115	10.584.900	13.499.607	31.641.222
9	Shpenzime lëndë djegëse		39.000	125.393	355.250	519.643
10	Energji elektrike + ujë			3.654.804	3.580.402	7.235.206
11	Rikonstrukcion ndërtesa		70.702.815	80.360.114	83.027.830	83.027.830
Totali		11.944.078	152.676.936	266.639.319	449.416.095	653.094.224

Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, auditimi dhe rezultatet.

Sipas ligjit çdo vit kalendarik bëhet mbyllja e bilancit i cili paraqitet pranë zyrave përkatëse. Për vetë faktin se "U.E.T" shpk përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për vitet financiar 2007, 2008 dhe 2009 Raporti i Ekspertizës është kryer nga Z. Kostaq Pesha, Ekspert Kontabël i Autorizuar. Raportet Financiare gjenden pranë Zyrës së Financës dhe organeve përkatëse.

Kapacitet menaxhuese financiare

Projekti financiar hartohet në muajin Nëntor të çdo viti dhe është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Për Zbatimin e këtij projekti Asambleja ka angazhuar Kancelarin e Universitetit. Për çdo blerje shitje ka urdhra për sektorin e financës, konsumimi i keshit bëhet vetëm me fatura të rregullta tatimore, lëvizjet bëhen me bankë mbi 90% të veprimeve. Asambleja e ortakëve ka vendosur që veprimet financiare çdo muaj bëhet auditimi i treguesve kryesor financiar. Në fund të vitit bëhet auditimi përmbledhës vjetor. Projekt buxheti hartohet në një mënyrë të tillë që gjithmonë të ketë rezervë të të ardhurave, duke mos përfshirë të ardhurat e vitit pasardhës në mënyrë të tillë që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij.

Gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton të dhënat e mësipërme ndodhet në zyrën e Financës

Dokumentacioni përkatës

1. Bilanci vjetor
2. Auditimi.

IX. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

UET-i ka plotësuar të gjitha strukturat drejtuese, si për sa i përket autoriteteve drejtuese, ashtu edhe organeve drejtuese, konform kërkesave të Ligjit Nr. 9741, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të datës 21.05.2007, i ndryshuar.

Dosja e pedagogut, e cila është plotësuar dhe ristrukturuar në paketën e re të emërtuar *Libri i pedagogut*, është një tregues shumë i rëndësishëm i vëmendjes që i është kushtuar informimit të pedagogëve në lidhje me standardet e cilësisë në mësimdhënie që synohen të arrihen, aspektet e vlerësimit të studentëve, transmetimin e filozofisë së UET-it, format e vlerësimit të pedagogut, si edhe elementë të tjerë me të cilët një pedagog përballlet gjatë angazhimit në procesin akademik.

Filozofia e përqafuar nga UET-i synon formimin e një studenti që:

- § ka opinione të forta;
- § di të argumentojë për këto opinione;
- § di të ofrojë informacion për argumentet mbi të cilat mbështet opinionet e forta që zotëron.

Cilësia e mësimdhënies është objekt i kontrollit dhe vlerësimit të vazhdueshëm, si nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar prej studentëve për të marrë mendimin e tyre në lidhje me mësimdhënien në të gjitha lëndët; sekretarisë mësimore, nëpërmjet ndjekjes së vazhdueshme të kryerjes së plotë të orëve mësimore, vlerësimit të drejtuesve, nëpërmjet kontrolleve gjatë zhvillimit të orëve të mësimit e formave të tjera.

Të gjithë pedagogët kanë detyrimin të përmbushin standardet e kontrollit të njohurive të studentëve, përmes realizimit të provimit të ndërmjetëm, detyrave të kursit dhe provimit përfundimtar, në varësi të llojit të lëndës që zhvillojnë. Për këtë qëllim janë konceptuar dhe krijuar standarde të cilat lehtësojnë dhe ndihmojnë në rritjen e cilësisë së vlerësimit dhe kontrollit të dijes.

Për hartimin e programeve të lëndëve që janë pjesë e programeve të studimit është konceptuar një format standard, ku theksi është vendosur në paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese, literaturë e cila përzgjidhet me kujdes pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse dhe diskutimit sipas grup-lëndëve dhe në departament. Duhet theksuar se konceptimi i programeve mësimore është i tillë që i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të studentëve, të cilët kanë kapacitete dhe interesa të shumëllojshme.

Seminaret zhvillohen në mënyrë interaktive, me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime, proces përmes të cilit ata arrijnë të qartësojnë dhe krijojnë ide, të bëjnë gjykime të vlefshme, të analizojnë situata dhe të marrin vendime të arsyeshme, të zgjidhin probleme, të arsyetojnë në mënyrë inteligjente, të formulojnë dhe realizojnë qëllime të caktuara.

Rëndësi e veçantë i është dhënë konceptimit dhe formatimit të detyrave të kursit, të cilat në UET zhvillohen në katër forma:

- ese
- komentari libri/leximi analitik
- detyrë në grup
- detyra praktike

Pedagogut i kërkohet të bëjë një vlerësim të detajuar dhe të argumentuar të cilësive të punimit të detyrës së kursit, sipas komponentëve dhe standardeve të përcaktuara të zhvillimit të saj. Ky vlerësim i shërben studentit për të kuptuar se si mund të përmirësojë punën e tij. Në vitet e para të studimit, temat propozohen nga pedagogu për dy arsye kryesore: së pari, për t'i orientuar studentët në mënyrën se si duhet konceptuar një temë detyre kursi, e cila të jetë e fokusuar dhe e realizueshme; së dyti, për të minimizuar problemin e dorëzimit të eseve të gatshme, të shkruara nga vetë studenti ose të tretë për synime jashtë lëndës.

Thelbësore në suksesin e misionit edukues të UET-it është përkushtimi ndaj parimeve të integritetit akademik. Çdo anëtar i komunitetit universitar është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë. Anëtarët e stafit të UET dhe studentët, si anëtarë të këtij komuniteti, janë përgjegjës për ndjekjen dhe respektimin e parimeve dhe frymës së Kodit të Integritetit të UET-it. Ky universitet është i vendosur të mbështesë standardet më të larta të integritetit, ndershmërisë morale dhe përgjegjësisë, të cilat janë baza e këtij institucioni. Ai pranon përgjegjësinë e tij për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm, pa diskriminim, të bazuar në meritat e secilit.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet qartësisë të studentëve, si për sa i përket çështjeve me karakter akademik, ashtu edhe atyre me karakter social; nxitjes së kuriozitetit intelektual, si dhe inkurajimit të studentëve për të përfituar nga mundësitë që ofrohen në UET, me qëllim që të bëhen vetë-udhëheqës të edukimit gjatë gjithë jetës, si dhe të aftësisë në vendimmarrje.

Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve të rëndësishme është edhe kërkimi shkencor, në përputhje me filozofinë, misionin e UET-it, interesat e tij, të stafit akademik dhe studentëve, si dhe me kapacitetet njerëzore dhe financiare që zotërohen. Kërkimi shkencor është institucionalizuar përmes krijimit të qendrave dhe grupeve të kërkimit.

Sistemi i brendshëm i menaxhimit të cilësisë

Sigurohet nëpërmjet (i) strukturave organizative të UET-it dhe (ii) Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC).

Të gjitha strukturat drejtuese (autoritetet dhe organet drejtuese), janë përgjegjëse për ndjekjen e përditshme të sigurimit të cilësisë nëpërmjet planifikimit, organizimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave drejt arritjes së vizionit të UET-it.

KSBC-ja, është ngritur me synim kryerjen periodike të vlerësimit të brendshëm të veprimtarisë së UET-it, të drejtimeve të caktuara të veprimtarisë së tij, ose të sektorëve të veçantë të tij. KSBC ka detyrimin të informojë të gjithë stafin e UET rreth kontrolleve, vlerësimeve dhe verifikimeve që realizon, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së performancës në të ardhmen.

KSBC-ja vlerëson efikasitetin e veprimtarive mësimore - kërkimore në momente të caktuara gjatë një viti akademik dhe udhëheq punën për realizimin e të gjithë procesit të Vlerësimit të Brendshëm duke përgatitur *Dosjen e Vetëvlerësimit*, pjesë e së cilës është edhe Raporti i Vetëvlerësimit.

KSBC është një entitet permanent në UET, i cili ngrihet nën përgjegjësinë e Rektorit, pasi ky i fundit merr mendimin e Senatit Akademik. KSBC përfaqësohet me një zyrë të veçantë në organigramën e UET dhe me një person përgjegjës. Drejtuesi i kësaj zyre kryeson çdo grup pune që ngrihet me urdhër të Rektorit, qoftë për të përgatitur *Dosjen e Vlerësimit të Brendshëm*, qoftë për të kontrolluar aspekte të caktuara të veprimtarisë mësimore e kërkimore në rang universiteti, fakulteti, apo programi studimi.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Me qëllim rritjen e nivelit të cilësisë dhe shkallës së përgjegjësisë për menaxhimin e cilësisë, është garantuar ndarja e qartë e roleve, përgjegjësi dhe kompetencave jo vetëm e organeve drejtuese, por edhe e autoriteteve drejtuese deri në nivel departamenti. Këto janë të shprehura në rregulloret dhe udhëzimet e UET-it, ku një numër i madh kompetencash dhe përgjegjësisish u janë dhënë dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve.

Këtë vit akademik po punohet për ngritjen dhe funksionimin e grup-lëndëve brenda çdo departamenti, gjë që do të forcojë edhe më tej cilësinë e programeve të lëndëve që zhvillohen brenda një programi studimi dhe do të garantojë më mirë harmonizimin e njohurive brenda të njëjtit grup-lëndësh duke u shtrirë si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht.

Dokumentacioni përkatës

1. Udhëzimin mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë;
2. Urdhri i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vetëvlerësimit;
3. Dosjet e kontrolleve të realizuara me urdhër të Rektorit
4. Dokumente themelore të UET-it;
5. Dosja e vlerësimit të studentëve;
6. Dosja e vlerësimit nga Dekanët;
7. Regjistrat e sekretarisë për prezencën e pedagogëve.

X. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun e tregun e punës

Bashkëpunimi kombëtar

- Kontaktet dhe bashkëpunimi me IAL brenda vendit dhe koordinimi i aktiviteteve

UET ka kontakte me pothuajse të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë brenda vendit. Kontaktet bazohen mbi aktivitete në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh apo shumëpalësh, kontakte për shkëmbim eksperience që lidhet me botimet universitare, programet e lëndëve dhe kurseve të studimit, realizimin e kërkimit shkencor dhe botimeve, udhëheqje diplomash DNP, diplomash Masteri apo doktoratura, promovim librash, revistash e botimesh të tjera të kësaj natyre, shkëmbim reciprok pedagogësh, bashkëpunim ndërmjet bibliotekave, promovim librash e studimesh, etj.

Një bashkëpunim i veçantë dhe i gjerë realizohet me tre IAL të tjera të organizuara në kuadrin e Concorsiumit Universitar Shqiptar, të krijuar më 21 shtator 2007 konkretisht me IAL-të "Polis", "Luarasi" dhe "Marubi," të cilat së bashku me UET-in janë të organizuara në një konsorcium universitar.

Koordinimi i këtyre aktiviteteve bëhet nga Zyra e Aktiviteteve, në përputhje me planet e departamenteve, dekanateve dhe rektoratit të UET-it. Çdo aktivitet dokumentohet dhe ruhet në arkiv.

- Mobiliteti i stafit dhe studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Mobiliteti i stafit akademik të UET-it brenda sistemit të arsimit të lartë të vendit tonë, është realizuar deri tani nëpërmjet angazhimit të tij në dhënien e cikleve të shkëputura të leksioneve apo kurseve të plota në disa universitete të vendit si p.sh., në Universitetin "Fan Noli" në Korçë, Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Tiranës, Polis, "Luarasi", etj.

Në bazë të një Rregulloreje të veçantë për transferimet dhe mobilitetin e studentëve, UET garanton mobilitetin dhe transferimin e studentëve nga/në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, qeveritare, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

UET-i si hallkë të parë të bashkëpunimit mes tij dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, ka aderuar dhe është një nga pjesët integrale të Consorciumit të Universiteteve Shqiptare, të përberë prej institucioneve arsimore të konsoliduara në arrijtjet e tyre akademike, si Universiteti Luarasi, Akademia e Filmit Marubi, Universiteti Polis. Në aktivitetet e tij ky konsorcium bashkërendon aktivitetet akademike dhe shkencore dhe duke qenë një faktor aktiv në arsimin e lartë shqiptar, synon të jetë pjesë aktive në politikëbërjen dhe rregullimin ligjor të kësaj fushe.

Pjesë e rëndësishme e aktiviteteve akademike të studentëve do të jenë dhe vizitat studimore në institucione publike e qeveritare, qendra kërkimore-shkencore, universitete dhe qendra të mëdha akademike, vizita në institucione ndërkombëtare jashtë vendit, etj. Në këtë kuadër po realizohet një vizitë në disa universitete në Tetovë, Shkup e Prishtinë për studentët e vitit të parë, një vizitë në institucionet e Bashkimit Evropian në Bruksel, të Parlamentit Evropian në Strasburg, në Bankën Qendrore Evropiane në Frankfurt për studentët e vitit të dytë dhe një vizitë në institucionet e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, Vjenë dhe Romë, etj.

UET-i mundëson me mjetet, ambientet dhe pedagogët e tij, organizimin e konferencave, takimeve, forumeve universitare dhe ndëruniversitare. Temat rreth të cilave janë mbajtur dhe do të mbahen këto

konferenca, janë të një interesi të përgjithshëm, dhe kanë përfshirë një audiencë shumë më të gjerë se thjesht atë universitare. Pedagogë shqiptarë e të huaj, me reputacion akademik e shkencor, janë ftuar dhe kanë mbajtur konferenca dhe leksione të hapura, të cilat në më të shumtën e rasteve janë bërë pjesë integrale e programit akademik të studentëve të UET-it sipas fushave përkatëse.

Ambientet e UET-it kanë qenë e vazhdojnë të jenë të hapura për ekspozita pikturë e fotografie, koncerte apo shfaqje të tjera artistike, si dhe aktivitete të organizatave të tjera të një profili me interes për fushat e studimit që përfshihen në UET.

Prania e komunitetit të biznesit synohet të bëhet gjithnjë e më e ndjeshme pranë strukturave të UET-it, si pjesë e rëndësishme në hartimin e politikave, e diktuar kjo dhe nga pjesëmarrja e tyre në hallkat e rëndësishme drejtuese të universitetit. Komunikimi me këta operatorë të biznesit, bëhet përmes memorandumeve të bashkëpunimit, si marrëveshjet dypalëshe ku përfshihen krijimi i kushteve të zhvillimit të praktikave, punësim të mëtejshëm të studentëve të diplomuar, bashkëpunime në fushata sensibilizuese në çështje të interesit të përbashkët, etj.

Komunikimi bëhet në disa forma, si ato të kontakteve të drejtpërdrejta, përmes strukturave të UET-it siç janë Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Zyra e Aktiviteteve, por dhe atyre promociionale, prej Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, ku aktivitetet dhe kërkesat e UET-it për bashkëpunim do të njoftohen përmes medias së shkruar dhe televizive.

Përfshirja e përfaqësuesve të këtyre institucioneve në konferencat, tryezat e rrumbullakëta, apo prania e tyre si lektorë në diskutime të temave të nxeha të momentit, është një qëllim tashmë i realizuar.

UET-i gjithashtu do të sigurojë lidhje në mes institucioneve, OJQ-ve lokale, Qendrave Rinore, Forumeve Rinore të subjekteve politike, organizatave dhe shoqatave të tjera të interesit publik, përmes studentëve të tij, lidhje të cilat do të jenë një urë komunikimi dhe bashkëpunimi në mes të studentëve dhe organizatave studentore me aktorët e lartpërmendur.

- **Mbajtja e kontakteve me studentët e diplomuar dhe ata të punësuar**

Për të qenë sa më afër realitetit dhe për të vlerësuar arritjet dhe vazhdimësinë e studentëve të diplomuar UET-i do të ndjekë një praktikë mbështetjeje dhe këshillimi për studentët e vet, duke filluar që nga informacioni i ofruar për gjendjen dhe sektorët e tregut të punës dhe duke vazhduar me praktikën mësimore.

Për të mbajtur statistika të sakta rreth ish-studenteve mbi vendndodhjen, gjendjen e punësimit, kryerjes së specializimeve dhe të kualifikimeve nga ana e tyre, UET-i ka hartuar formularë të veçantë, të cilët do të plotësohen nga studentët dhe informacioni do të përditësohet prej Zyrës së Karrierës dhe Punësimit, strukturë kjo që do të ngarkohet posaçërisht me monitorimin e këtij aktiviteti.

I diplomuari, do të nxitet të vërë në dispozicion të UET-it, informacione të tilla si:

1. punësimi aktual
2. kualifikime dhe specializime të mëtejshme
3. përditësimin e Curriculum Vitae me informacion të ri.

Synohet që të gjithë brezat e ish-studentëve të shërbejnë si pararojë e një gjenerate të përgatitur, që do të përçojë një frymë të re dhe do të shërbejë për të ngritur në nivele më të larta nivelin akademik të ofruar nga ndjekja e studimeve në institucionet arsimore të larta shqiptare. UET-i synon krijimin e rrjetit të ish-studentëve të tij, dhe për figurat më të spikatura mes tyre do të verë në dispozicion informacionin e duhur dhe do të mundësojë përfshirjen e tyre në vendimmarrje me synim ngritjen e nivelit akademik e shkencor të UET-it.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Misioni i bashkëpunimit ndërkombëtar

Dimensioni i veprimtarisë së UET-it në marrëdhëniet me jashtë, ka ekzistuar dhe është zbatuar me sukses. Por rrethanat në të cilat ai ndodhet tashmë, të kushtëzuara nga zgjerimi dhe rritja e pretendimeve për standarde të niveleve të larta, kërkojnë një rikonceptim tjetër.

Bashkëpunimi me jashtë përfshin vendosjen dhe mbajtjen e lidhjeve me institucione partnere në vende të ndryshme. Ai realizohet kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes në programe, projekte dhe veprimtari të tjera të përbashkëta akademike e shkencore.

Si rregull bashkëpunimi dhe lidhjet me jashtë do të mbështeten kryesisht në marrëveshjet kuadër të përfunduara me universitetet e tjera, si baza e qëndrueshme institucionale dhe juridike, pa përjashtuar mundësitë e marrëveshjeve midis departamenteve, instituteve, qendrave dhe fakulteteve.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i UET-i duhet t'i shërbejë:

- Promovimit të dimensioneve evropiane në arsimin e lartë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e kurrikulës, bashkëpunimin ndërinstitucional, skemat e mobilitetit dhe programet e integruara të studimit, trajnimit dhe kërkimit.
- Integritit sa më të shpejtë të studentëve të përgatitur nga UET-i në tregun vendas, rajonal e global të punës.
- Njohjes së UET-it në rrjetin ndërkombëtar të universiteteve dhe institucioneve akademike e shkencore.

Objektivat e bashkëpunimit ndërkombëtar të UET-it

1. Promovimi i dimensioneve evropiane në arsimin e lartë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e kurrikulës, bashkëpunimin ndërinstitucional, skemat e mobilitetit dhe programet e integruara të studimit, trajnimit dhe kërkimit.

Ky objektiv mund të arrihet ndër të tjera edhe nëpërmjet:

- tërheqjes në auditorët e UET-it, krahas pedagogëve më të mirë vendas edhe të pedagogëve të huaj ose shqiptarë që kanë kryer studimet dhe kanë marrë grada e tituj shkencorë në universitete prestigjioze të huaja.
- pjesëmarrjes dhe përfshirjes në reformimin e sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri në bazë të standardeve të Procesit të Bolonjës duke e bërë atë të krahasueshëm dhe të përputhshëm me sistemet e tjera evropiane të arsimit të lartë.
- përkrahjes së nismave të pedagogëve të UET-it për kualifikime periodike, sipas kushteve administrative dhe financiare të përcaktuara nga UET.
- aplikimit të saktë të sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), i cili bashkë me suplementin e diplomës, është kusht për njohjen e UET-it në rrjetin European.
- pjesëmarrjes së pedagogëve dhe studentëve të UET-it në veprimtari ndërkombëtare të organizuara brenda apo jashtë vendit dhe që kanë të bëjnë me çështje të kurrikulave, metodave të mësimdhënies, ngritjen e cilësisë akademike e shkencore në fushën e arsimit të lartë etj.
- institucionalizimit të procedurave të shkëmbimit të teksteve si dhe të literaturës periodike me universitete apo institucione të huaja akademike e shkencore.

2. Integrimi i shpejtë i studentëve të përgatitur nga UET-i në tregun vendas, rajonal e global të punës, që mendohet se do të mund të realizohet edhe nëpërmjet:

- përfitimit nga lehtësitë që krijohen nga institucionalizimi i bashkëpunimit me universitete apo institucione analoge vendase e të huaja me anë marrëveshjes apo memorandumesh mirëkuptimi.

- zgjerimit të lidhjeve të karakterit rajonal e më gjerë, duke u përfshirë në bashkëpunimin shumëpalësh me disa prej rrjeteve universitare në vende fqinje apo në rajonin adriatiko-ballkanik ose edhe europian.
 - përfitimit nga avantazhet që sigurohen prej mobilitetit të studentëve dhe të stafeve, i cili konsiderohet si një nga shtyllat bazë të Procesit të Bolonjës, për promovimin e lëvizjes pa barriera ose me sa më pak, për shkëmbimin e kulturave, rritjen e cilësisë në sajë të konkurrencës etj.
 - Do të synohet që ky proces të realizohet në të dy kahet e lëvizjes, si për studentët e UET-it drejt shteteve të tjera europiane ashtu edhe për studentët e huaj në UET.
 - përmirësimit të metodave të përvetësimit të gjuhëve të huaja, çka është *conditio sine quoi non* sepse mobiliteti i studentëve në hapësirën evropiane të arsimit të lartë realizohet kur ata zotërojnë gjuhët e huaja dhe komunikojnë pa vështirësi.
 - organizimit të udhëtimeve studimore të studentëve jashtë shtetit, duke e shndërruar atë në një prej avantazheve të përgatitjes së tyre në UET.
 - institucionalizimit të bashkëpunimit me sipërmarrje të huaja që operojnë në Shqipëri, për të ngjallur interesin rreth mundësisë së zhvillimit të praktikave mësimore dhe punësimit e ardhshëm të studentëve tanë, në bizneset e tyre në Shqipëri.
 - sensibilizimit të drejtuesve të bizneseve të huaja për dhënie bursash për studentë të veçantë për t'i përgatitur apo kualifikuar në UET ose jashtë vendit, për t'i punësuar pas studimeve në këto sipërmarrje.
3. Njohja e UET-it në rrjetin ndërkombëtar të universiteteve dhe institucioneve akademike e shkencore do të jetë një komponent që do të ndihmohet nga veprimtaritë me jashtë të organizuara prej tij. Në këtë mënyrë do të përmirësohet më tej imazhi i UET-it dhe do të sigurohen:
- mundësi të tjera për dërgimin jashtë shtetit të studentëve si dhe pjesëtarëve të stafit akademik e shkencor të UET-it për vazhdim studimesh apo kualifikime të mëtejshme.
 - lehtësi financiare dhe eventualisht bursa studimi.
 - mundësi për pjesëmarrje me kushte lehtësuese financiare në konferenca apo veprimtari të tjera kërkimore e shkencore jashtë vendit.

Bashkëpunimi i UET me jashtë kushtëzohet nga disa faktorë:

Së *pari* nga interesi i UET-it;

Së *dyti* nga interesi i palëve të tjera për lidhje dhe bashkëpunim me ne;

Së *treti* nga synimet që UET ka vendosur në strategjitë e veta afatmesme dhe afatgjata;

Së *katërti* nga mundësitë financiare të UET-it dhe të partnerëve të tij potencialë për të përballuar kostot e këtij bashkëpunimi;

Së *pesti* nga siguri i mundësive të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte apo programe të ndryshme ndërkombëtare apo rajonale bashkëpunimi, si p.sh. ERASMUS, DELTA, PETRA, LINGUA, TEMPUS etj. të cilat iu japin mundësinë studenteve dhe pedagogëve të regjistruar për të ndjekur studimet apo për të dhënë mësim në institucione të huaja të arsimit të lartë.

Strategjia që propozohet për t'u ndjekur:

- Tërheqja e mendimeve nga stafi akademik e shkencor i UET-it rreth mundësive, interesave dhe kushteve për bashkëpunim ndërkombëtar me universitete, institucione të arsimit të lartë apo rrjete universitare. (Në UET janë angazhuar një numër i konsiderueshëm pedagogësh që kanë kryer studimet universitare e pasuniversitare në vende të ndryshme në Europë apo në SHBA, të cilët kanë dijeni dhe lidhje të vlefshme me universitetet ku janë diplomuar.)
- Konkretizimi i disa prej fushave më prioritare të bashkëpunimit ndërkombëtar të UET-it.
- Caktimi në buxhetin e UET-it, i një fondi të veçantë për përballimin e disa veprimtarive ndërkombëtare të.

- Krijimi në perspektivë i një njësie të posaçme për bashkëpunimin ndërkombëtar.

Natyra e veprimtarive që mund të ndërmerren:

1. Institucionalizim i lidhjeve nëpërmjet përfundimit të marrëveshjeve dy e shumëpalëshe të bashkëpunimit akademiko-shkencor, në nivel universiteti, fakultetesh e institutesh dhe deri departamentesh.
2. Pjesëmarrje në organizata joqeveritare me karakter rajonal, që operojnë në fushën e arsimit të lartë për bashkëpunim akademiko-shkencor.
3. Organizim veprimtarish të përbashkëta kërkimore e shkencore ose edhe përkujtimore me universitete apo institucione të tjera homologe të huaja, me pjesëmarrjen e pedagogëve apo të studentëve të të dyja palëve.
4. Publikime studimesh apo librash nga pedagogë të UET-it në bashkëpunim me pedagogë të huaj.

Rreziqet dhe vështirësitë:

- Rënia në formalizëm;
- Pjesëmarrja në veprimtari ndërkombëtare me rëndësi periferike apo relative për UET-in.
- Pjesëmarrja në veprimtari ndërkombëtare që nuk kanë impakt në procesin akademik e shkencor të UET-it.
- Mungesa e fondeve.

Monitorimi:

Synohet që bashkëpunimi ndërkombëtar të mos mbetet një veprimtari formale dhe pa efekte konkrete. Për këtë do të bëhet kujdes që ai të:

- Fokusohet në veprimtari me rezultate të dukshme në procesin akademik e shkencor të UET-it, duke shmangur pjesëmarrjen në veprimtari që nuk kanë impakt për UET-in.
- Shërbejë për përmirësimin e vazhdueshëm të imazhit të UET-it.
- Nxisë interesin e bizneseve të huaja, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, që veprojnë në Shqipëri apo jashtë saj, ndaj UET-it

Zëvendësrektori për marrëdhëniet me jashtë

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar të UET-it është projektuar një rol i caktuar edhe për zëvendësrektorin për marrëdhënie me jashtë. Ai do të ketë si drejtim kryesor të punës së vet mbështetjen e kursit tashmë të konfirmuar si filozofi themelore të UET-it në drejtim të europianizimit të arsimit të lartë shqiptar. Është njohur dhe pranuar procesi i Bolonjës si një oportunitet i madh për pozicionimin e UET-it në fushën e arsimit europian të studentëve.

UET-i synon që të japë kontributin e vet përkatës në krijimin e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë nëpërmjet një koncepti të ri inovativ duke promovuar kështu ndërkombëtarizimin e procesit të të mësuarit dhe të kërkimit shkencor si dhe në fushën e shkëmbimeve akademike.

Misioni i përgjithshëm i zëvendësrektorit të ngarkuar për marrëdhënie me jashtë është të studiojë nismat e ardhura nga strukturat e ndryshme të UET-it për promovimin e procesit të ndërkombëtarizimit të tij, t'i bëjë ato objekt diskutimesh me drejtuesit e tjerë të UET-it dhe të ndjekë realizimin e tyre.

Në bashkëpunim me hallkat e tjera do të ndjekë ecurinë dhe realizimin e veprimtarive të parashikuara në projektet apo marrëveshjet e bashkëpunimit etj.

Në kushtet e mungesës së një njësie të veçantë që do të merrej me veprimtaritë e marrëdhënieve ndërkombëtare, ai do të bashkërendojë veprimtarinë e vet me njësitë dhe zyrat e tjera që veprojnë në UET.

Implementimi i objektivave dhe aktiviteteve në kuadrin e procesit të Bolonjës

Objektivat dhe aktivitetet kryesore të UET-it orientohen dhe zhvillohen në përgjigje të kërkesave themelore të procesit të Bolonjës.

- (1) Organizimi dhe strukturimi i kurseve të studimit është bërë mbi bazën e tre niveleve të diplomimit universitar, DNP, MNP, DND dhe MND.
- (2) Lëndët që zhvillohen në të gjitha kurset e studimit janë të diferencuara në disa kategori, në përputhje të plotë me frymën e procesit të Bolonjës, të tilla si lëndë teorike dhe lëndë praktike, lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje, etj;
- (3) Në themel të organizimit të cikleve dhe kurseve qëndron aplikimi i sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS), duke mbajtur parasysh ngarkesën me pikë krediti brenda dhe jashtë auditorit;
- (4) Vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet nëpërmjet sistemit të kontrollit të vazhdueshëm që nënkupton kontrollin dhe vlerësimin nëpërmjet disa komponentëve, të tillë si: provimi i ndërmjetëm, eseja ose detyra praktike, niveli i aktivizimit dhe performancës në seminare, pjesëmarrja në leksione dhe provimi përfundimtar.
- (5) Pa cenuar individualitetin dhe specifikat e çdo drejtimi të diplomimit, është bërë dhe ndërthurja e mjaft disiplinave në kurse të ndryshme studimi, duke garantuar një shkallë të lartë bashkëveprimi dhe integriteti në rang universiteti.
- (6) Në përgatitjen e strukturës së lëndëve për çdo drejtim apo nivel diplomimi janë ruajtur gjerësisht karakteristikat themelore dhe objektivat specifike të tyre duke respektuar nivelin e studimeve, shkallën e natyrës teorike e praktike të lëndëve, ngarkesën, kombinimet dhe kushtëzimet ndërmjet tyre, etj.
- (7) Lloji i diplomave dhe struktura e tyre është në përputhje të plotë me procesin e Bolonjës dhe legjislacionin shqiptar.

Kontaktet dhe bashkëpunimi me institucione analoge ndërkombëtare

Bashkëpunimi me jashtë i UET-it gjatë vitit akademik 2009-2010, ka synuar zgjerimin dhe institucionalizimin e lidhjeve nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve, protokolleve, memorandumeve të mirëkuptimit etj. si baza e qëndrueshme juridike për zhvillimin normal të bashkëpunimit midis strukturave universitare. Ky është konsideruar si element favorizues për përmbushjen e një prej komponentëve të rëndësishëm të veprimtarisë së UET-it, për shkëmbimet e stafëve dhe të studentëve, në kuadër të angazhimeve të Kartës së Bolonjës.

Gjatë vitit akademik që po mbyllet janë realizuar marrëveshje bilaterale bashkëpunimi me:

- Ø Universitetin "Via del Mar" (Kili) dhjetor 2008,
- Ø Universitetin e Barit, 18 dhjetor 2008,
- Ø Universitetin Fama, Prishtine, 26.04.2008,
- Ø Universitetin e Venecias, Ca Foscari, 13.01.2010,
- Ø Universitetin Montpellier I, 28.02. 2009,
- Ø Qendren nderdepartamentale të studimeve ballkanike dhe nderkombetare të Universitetit Ca Foscari të Venecias, 14 prill 2010,
- Ø Universitetin e Podgoricës, Mali i Zi, 24-27 11.2009,
- Ø Universitetin Bar Ilan University, Ramat-Gan –Izrael, 5 maj 2009,
- Ø Aston Centre for Europe, Aston University, Birmingham, 16 shkurt 2010,
- Ø Interfaculty Institute for Central and Eastern Europe (IICEE) të Universitetit të Friburgut – Zvicër, 27 shkurt 2010,
- Ø Universitetin Ndërkombëtar të Vjenës, 12. 01. 2010,

Mbi bazën e këtyre marrëveshjeve si dhe të lidhjeve të tjera UET-i ka kontakte të rregullta me disa institucione analoge ndërkombëtare si p.sh.,

- Ø Universitetin e Barit (Itali),
- Ø Universitetin e Leçës (Itali),
- Ø Universitetin Ekonomik të Athinës (Greqi);
- Ø Universitetin e Thesalisë (Greqi),
- Ø Universitetin e Tetovës (Maqedoni),
- Ø Universitetin e Ankarasë (Turqi),

- Ø CIHEAM-IAM Montpellier (France),
- Ø Universitetin Paris 8 (Francë),
- Ø Universitetin Paris 10 Nanterre (France),
- Ø Universitetin e Gjenevës (Zvicër),
- Ø Universiteti Riinvest (Kosovë),
- Ø Universitetin "Via del Mar" (Kili),
- Ø Universitetin e Podgorices- Mali i Zi,
- Ø dy universitete ne Ho Shi Minh Ville Vietnam, etj.

Në këto akte janë parashikuar shkëmbime pedagogësh nga stafi akademik, shkëmbime studentësh, pjesëmarrje në programe, projekte dhe veprimtari të tjera të përbashkëta akademike e shkencore.

Me një pjesë të institucioneve me të cilët nuk ka ende marrëveshje, ka filluar procedura e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok institucional me program dhe objektiva të përbashkëta disa-vjeçare.

Me disa prej tyre janë realizuar shkëmbime pedagogësh, vizita studentësh, konsultime për lëndë dhe botime të ndryshme, konferenca të përbashkëta shkencore, etj.

Pjesëmarrje në organizma ndërkombëtare

UET-i është pjesëmarrës dhe anëtar i Qendrës Ndëruniversitare për Kërkime dhe Bashkëpunim me Europën Lindore dhe Juglindore (CIRCEOS -Bari), maj 2010, në të cilën përfaqësuesi i tij është zgjedhur anëtar i Komitetit Drejtues.

Ai është pjesëmarrës në *Adriatic and Ionian Initiative, Sub-Round Table on inter-University Co-operation*, Università Politecnica delle Marche, Ancona, 19-20 April 2010 etj.

Pjesëmarrja në programe europiane

UET-i nuk ka akoma ndonjë angazhim apo pjesëmarrje në programe europiane (CARDS, ERASMUS, DELTA, PETRA, LINGUA, TEMPUS) të cilat iu mundësojnë studentëve dhe akademikëve të edukohen apo të japin dijet e tyre në institucione të huaja të arsimit të lartë. Aktualisht është aplikuar në disa projekte të tilla europiane, në kuadrin e të qenit pjesë e grupimeve universitare europiane.

Gjate këtij viti janë tërhequr në auditoret e UET-it, një numër relativisht i konsiderueshëm pedagogësh të huaj ose shqiptarë, por që kanë kryer studimet dhe kanë marrë grada e tituj shkencorë në universitete prestigjioze të huaja. Ka pasur te tille nga Franca, Anglia, Italia, SHBA, Zvicra, etj.

Bashkëpunimi me jashtë në të ardhmen do te ketë si drejtime kryesore çështjet e mëposhtme:

- Ø Institucionalizim i lidhjeve nëpërmjet përfundimit të marrëveshjeve dy e shumëpalëshe të bashkëpunimit akademiko-shkencor, ne nivel universiteti, fakultetesh e institutesh dhe deri departamentesh.
- Ø Pjesëmarrje në organizata joqeveritare me karakter rajonal, që operojnë në fushën e arsimit të lartë për bashkëpunim akademiko-shkencor .
- Ø Organizim veprimtarish të përbashkëta kërkimore e shkencore ose edhe përkujtimore me universitete apo institucione të tjera homologe te huaja, me pjesëmarrjen e pedagogëve apo edhe të studentëve të të dyja palëve.
- Ø Publikime studimesh apo librash nga pedagogë të UET-it në bashkëpunim me pedagogë të huaj.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar të UET-it është projektuar një rol i caktuar edhe për Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë dhe për zëvendësrektorin për marrëdhënie me jashtë.

Marrëdhëniet me tregun e punës

Për të qenë sa më afër kësaj problematike dhe për të marrë sa më tepër informacion, UET-i ka krijuar një strukturë të posaçme, e cila është e fokusuar vetëm në këtë proces, Zyra e Karrierës dhe

Praktikave. Nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Praktikave UET synon ti krijojë studentëve të saj një pikë kontakti me tregun e punës.

Kjo Zyrë fokusohet në shërbime të cilat e orientojnë studentin dhe e këshillojnë atë ti qaset tregut të punës në mënyrë sa më profesionale. Disa nga shërbimet e Zyrës janë: përgatitja e moduleve të Praktikave Profesionale, Këshillimi i Studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve, organizimi i praktikave profesionale apo internship-eve, organizimi i panairëve të karrierës apo ditëve të karrierës, organizimi i aktiviteteve që rrisin network-un (rrjetin e njohjeve) të studentëve tanë etj. Synimi final i zyrës është rritja e punësueshmërisë së studentëve dhe të diplomuarve të UET.

Të gjitha këto shërbime ofrohen për studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve të tyre, por jo vetëm. Një fokus të veçantë i kemi dhënë edhe të diplomuarve në vite të UET që i quajmë ndryshe UET Alumni. Ata ftohen të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet tona dhe iu ofrohet mundësia të përfitojnë nga të gjitha shërbimet e sipërpërmendura.

Menaxhimi i marrëdhënies me UET Alumni është një nga aspektet kryesore të Zyrës së Karrierës. Ne e konsiderojmë që janë pikërisht alumni-t të cilët e përfaqësojnë UET në tregun e punës dhe i promovojmë kontaktet midis alumni-t dhe universitetit e studentëve aktuale. Zyra mban kontakte të rregullta me alumni-t dhe për herë të parë në vitin 2010 është prodhuar Libri i Karrierës i cili prezanton alumni-t e parë të UET dhe pozicionet e punës që ata tashmë kanë zënë. Gjithashtu, këtë vit në bashkëpunim me alumni-t më aktivë të UET kemi krijuar edhe shoqatën UET Alumni. Ne konsiderojmë që studentët dhe alumni-t e UET janë një komunitet që rritet dhe zhvillohet, duke kontribuar përditë në zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Krijimi i shoqatës UET Alumni e promovon këtë mision dhe inkurajon mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme midis alumni-t dhe Universitetit.

Marrëdhëniet me publikun dhe komunitetin në tërësi

UET dëshiron të vendosë një model komunikimi me publikun e vet (studentë, prindër, akademikë, pedagogë, intelektualë, institucione të qeverisë apo shoqërisë civile) i cili të jetë i hapur dhe i dobishëm për të dy palët. Për këtë qëllim, UET ka krijuar një strukturë të posaçme si Zyra e Marrëdhënieve me Publikun (ZMP), e cila lehtëson këtë marrëdhënie duke siguruar informacion për të interesuarit nëpërmjet kanaleve tradicionale (broshura, fletëpalosje, udhëzues) dhe atyre bashkëkohorë (faqja e internetit, rrjetet sociale, etj) të komunikimit.

ZMP ka filluar funksionimin e saj më 1 prill 2010.

Veprimtaria e ZMP përqendrohet në katër shtylla kryesore:

- Organizim dhe menaxhim eventesh
- Marrëdhëniet me mediat
- Komunikim me publikun e synuar nëpërmjet botimeve dhe internetit
- Marrëdhëniet me komunitetin

Organizim dhe menaxhim eventesh

ZMP kujdeset për imazhin dhe reputacionin e UET-it në aktivitete të ndryshme të organizuara nga vetë institucioni ose në bashkëpunim me të tretë. Kjo përfshin zgjedhjen e kohës, vendit, të ftuarve, përgatitjen dhe shpërndarjen e ftesave, dekorin, skenarin, radhën e folësve, njoftimin për shtyp, komunikimin me gazetarët, etj. Këtu mund të përmendim: promovimet e librave të UET Press me autorë Adrian Civici, Fatos Tarifa e Sokol Balla, vizitën e Ministrisë të Jashtëm Bullgar, ekspozitën e piktorit Rakip Shabani, festën e stafit për mbylljen e vitit shkollor kombinuar me promovimin e klipit të Alban Skënderajt, mbështetur nga UET-i, etj. Për një vizualizim sa më të mirë të UET-it, mjediset kryesore të universitetit (holli, Aula Magna) janë pajisur letrë me logo, ndërkohë që janë prodhuar dhe dy versione elektronike dhe të lëvizshme për rastet kur aktiviteti organizohet jashtë UET-it.

Marrëdhëniet me mediat

ZMP shërben si pikë kontakti për mediat e shkruara dhe ato elektronike, të cilat interesohen për veprimtarinë e UET-it, duke iu përgjigjur interesit të tyre në kohë dhe duke adresuar kërkesat për intervista tek personat e duhur. Aktivitetet e UET-it kanë patur një mbulim të mirë mediatik, nisur nga tematikat interesante që trajtojnë dhe të ftuarit e rëndësishëm- personalitete të botës akademike dhe kulturore. Këtu veçojmë, konferencat shkencore : “Arritje te historiografisë shqiptare për periudhën para Pavarësisë”, “Roli i SHBA-së në shekullin XXI”, “ Kriza financiare dhe përballja me tregjet”, Dialogun me profesorët ambasadorë, forumin për integrimin në BE në bashkëpunim me ambasadën britanike, promovimet e librave të sipërpërmendur, intervistat televizive me Pierre Hassner dhe Amitai Etzioni, Panairin e Punës në UET, etj. ZMP ka vendosur lidhje me talk-showt më të ndjekur në vend për të promovuar disa nga figurat kryesore të UET-it si ekspertë të fushave përkatëse dhe kontribues në debatin publik.

Komunikim me publikun e synuar përmes botimeve dhe internetit

Faqja e internetit e UET-it www.uet.edu.al është riorganizuar duke lehtësuar lundrimin e vizitorëve për të gjetur shpejt dhe me cilësi informacionin e duhur. Faqja përditësohet rregullisht duke pasqyruar në kohë reale aktivitetin e ngjeshur të UET-it dhe duke krijuar ndërgjegjësim për aktivitetet e ardhshme. Përveç seksionit të lajmeve, është shtuar seksioni “Këtë javë” që është një përmbledhje e ngjarjeve kryesore të javës si dhe seksioni “Aktivitete te ardhshme”. Kërkimi shkencor ka dalë me vete me qendrat përkatëse, dhe botimet. ZMP kujdeset për profilin e UET-it në rrjetet sociale, si Facebook dhe po mendon për hapjen e një profili në YouTube.

Botimet. ZMP ka ndihmuar në rifreskimin e guidave të UET-it ashtu si dhe në konceptimin e guidave të reja (Guida e Burimeve Njerëzore). ZMP është duke përgatitur një broshurë për median, si dhe do të përfshihet në botimin e guidës së programeve të lëndëve. ZMP ka një rol në redaktimin përfundimtar të botimeve promovuese të UET-it.

Marrëdhëniet me komunitetin

Universiteti European i Tiranës është angazhuar që në fillimet e tij për të luajtur një rol të rëndësishëm në shërbimet ndaj komunitetit. ZMP lehtëson organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me dhe për komunitetin, duke nxitur shkëmbimin e eksperiencave me institucione të tjera që i shërbejnë profilizimit të UET-it si një kontribues në jetën komunitare.

Këto shërbime ndahen në disa kategori kryesore:

1. Mbështetjen e studentëve nga shtresat më të pafavorizuara dhe të diskriminuara të shoqërisë. UET-i ka ofruar bursa të plota për studentë romë dhe ballkano-egjiptianë.
2. Mbështetjen e studentëve që kanë vuajtur pasojat e tragjedive familjare ose kolektive. UET-i ka ofruar bursa të plota për fëmijë të policëve të rënë në krye të detyrës, fëmijë jetimë ose fëmijë të familjeve në gjendje të vështirë ekonomike. Dy bursa të plota studimi janë ofruar edhe për fëmijë të familjeve të dëmtuara nga tragjedia e Gërdecit.
3. Mbështetjen ndaj shkollave të mesme në rritjen e kapaciteteve të tyre mësimdhënëse. UET-i ofron trajnime për mësuesit e shkollave të mesme në lidhje me përmbajtjen e lëndëve specifike, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe trajnime të përgjegjësve të shkollave të mesme për zhvillimin e karrierës. Ky shërbim ofrohet dhe realizohet falas për të gjithë shkollat e mesme të Tiranës.
4. Orientimin e maturantëve për të kuptuar sistemin e arsimit të lartë, Procesin e Bolonjës si dhe përputhjen e studimeve të larta me tregun e punës. UET-i ofron sesione orientimi me maturantët për qëllimet e mësipërme. Ky shërbim ofrohet dhe realizohet falas për të gjithë shkollat e mesme të Tiranës.

5. Sponsorizim i veprimtarive kulturore: ekspozita pikturë, fotografie dhe instalacioni në mjediset e tij, qoftë për studentë të tij, qoftë për krijues jashtë universitetit. Gjithashtu UET-i ka sponsorizuar veprimtari kulturore specifike.
6. Dhurim vullnetar i gjakut për fëmijët talasemikë. Ky dhurim realizohet një herë në vit, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.

Në këtë kuadër disa nga veprimtaritë më të rëndësishme të zhvilluara gjatë vitit akademik 2009 – 2010 janë:

- organizimin e ditës së dhurimit të gjakut me Kryqin e Kuq,
- prezantimin e projektit të votimit elektronik,
- mbledhjen e ndihmave humanitare për fëmijët e Shqipërisë,
- pjesëmarrjen në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, etj

Dokumentacioni përkatës

1. Dosja e marrëdhënieve me MASH-in;
2. Dosja e shtypit;
3. Dosja e Consorciut;
4. Dosja e bashkëpunimit me universitetet/institucione brenda vendit;
5. Dosja e bashkëpunimit universitete/institucione jashtë vendit;
6. Dosja e bashkëpunimit me shoqërinë civile.

XI. Analiza SWOT

Mbas përfundimit të hartimit të Raportit të Vetëvlerësimit, në përputhje me udhëzimet e APAAL, Grupi i Punës për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm nën drejtimin e KSBC, ka bërë një analizë serioze sipas modelit SWOT, e cila pasqyron në mënyrë të përmbledhur gjendjen aktuale të Universitetit European të Tiranës – UET.

1. Anë të forta

- a. *Filozofia* e UET-it përmbledhet në një koncept të vetëm: *qasja analitike*. Misioni themelor është aftësimi i studentëve për të analizuar fenomene, ngjarje, koncepte, ligje, politika apo dukuri të caktuara. Produkti që UET-i synon të nxjerrë pas viteve të shkollimit është një student që ka tre karakteristika themelore: 1) ka opinione të forta, 2) di të argumentojë për këto opinione dhe 3) di të ofrojë informacion për argumentet mbi të cilat mbështet opinionet e forta që zotëron. Është ky produkt që do ta diferencojë studentin e UET-it nga studentët e universiteteve të tjerë.
- b. *Strategjia e zhvillimit* të UET-it e përcaktuar në tre nivele: (1) *Strategjia afat-shkurtër (1-3 vjeçare)* që synon konsolidimin dhe garantimin e funksionimit të gjithë sistemit; (2) *Strategjia afat-mesme (3-5 vjeçare)* që synon zgjerimin e mëtejshëm të UET-it; (3) *Strategjia afat-gjatë (6-10 vjeçare)* që synon profilizimin e universitetit dhe fakulteteve të tij si: (a) universitet/fakultet i specializuar në lidhjet me biznesin dhe tregun e punës, dhe (b) universitet elitë në fushën akademike dhe shkencore.
- c. *Dokumentacioni i UET-it*: UET-i ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për funksionimin normal të tij konform kërkesave të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore. I gjithë dokumentacioni përmbledhet në Broshurën e Dokumenteve Themelore të UET. Dokumentet themelorë të UET përbëjnë të gjithë sistemin mbi të cilin vepron UET.
- d. *Rekrutimi dhe cilësia e stafit*. UET-i i ka kushtuar rëndësi të veçantë cilësisë së stafit drejtues, mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ. Synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve/klientëve nga të gjitha njësitë përbërëse. Kriteret bazë të rekrutimit të personelit akademik janë (i) eksperiencia në mësimdhënien universitare, (ii) grada e titulli shkencor i kandidatit për pedagog dhe (iii) aktiviteti kërkimor shkencor e botues i tij.
- e. *Ndryshimi i raportit staf i brendshëm – staf i jashtëm*, nëpërmjet rritjes së numrit të pedagogëve të brendshëm dhe uljes së numrit të pedagogëve të jashtëm. Konkretisht në vitin akademik 2008 – 2009 ishin 35 pedagogë të brendshëm dhe 96 të jashtëm. Ndërsa aktualisht pedagogë të brendshëm janë 95 dhe të jashtëm 55. Ky është një indikator i rëndësishëm që tregon se stafi i tanishëm i UET është më i përkushtuar, ka mundësi t'i qëndrojë më afër studentit, e kupton më mirë filozofinë, rregullat dhe procedurat e UET dhe ka të gjitha mundësitë të performojë më mirë se një vit më parë.
- f. *Mësimdhënia*. Qëllimi themelor në fushën e mësimdhënies është transmetimi tek studentët i një informacioni cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik dhe praktik, duke realizuar ciklin «informacion-njohuri-dije-aftësi». Qëllimi bazë i mësimdhënies është përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të aftë që të debatojnë e marrin vendime të sakta, të aftë që të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.
- g. *Format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studenteve*. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa indikatorëve, me synim vlerësimin e vazhdueshëm për ta vendosur studentin në punë përgjatë të gjithë vitit. Vlerësimi i vazhdueshëm rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit dhe ka natyrë stimuluese e inkurajuese.
- h. *Kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik*. Në filozofinë e UET-it, kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik është në funksion të cilësisë së mësimdhënies. Ky

është një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë akademike, i cili synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore, që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive dhe zbatimin e metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve. Ky proces realizohet nëpërmjet (i) vlerësimit të çdo pedagogu dhe lënde nga vetë studentët, (ii) vetëvlerësimit të performancës nga çdo pedagog, (iii) vlerësimit prej eprorëve respektivë të punës së realizuar nga pedagogët dhe (iv) vlerësimit “teknik” prej sekretarisë mësimore për aspekte të tilla si disiplina në punë, respektimi i orarit, niveli i shfrytëzimit të orës së mësimi, respektimi i afateve, korrektesa e çdo pedagogu në plotësimin e dokumentacionit përkatës etj.

- i. *Kërkimi shkencor*, garanton pjesëmarrjen dhe aftësimin e pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor, angazhimit të tyre sa më të gjerë në botime e studime shkencore, organizimin periodik të konferencave shkencore nga çdo departament, botimin e katër revistave shkencore (“Polis”, “Jus & Justicia”, “Economicus”, “Sociological Analysis” (Studime sociologjike, në anglisht), botimin e monografive, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët, etj. Në UET funksionojnë qendra të mirëfillta kërkimore-shkencore, si edhe grupe kërkimore. Të gjitha këto realizojnë vënien e rezultateve të kërkimit shkencor në shërbim të studentëve, procesit akademik dhe mbarë shoqërisë.
- j. *Përfshirja e studentëve në vendim-marrje*. Gjatë periudhës 2006-2010, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, ka qenë një përprjekje konstante dhe e vazhdueshme. Studentët më aktivë dhe me rezultate të larta, përfaqësues të Këshillit Studentor, të rrjetit të bursistëve të UET-it, studentë të ardhur nga universitete evropiane e amerikane, apo dhe studentët në marrëdhënie pune, të cilët njohin nga afër tregun e punës, janë përfshirë në të gjitha etapat e diskutimit dhe miratimit të programeve të studimit, kurrikulave, si dhe në hartimin e dokumenteve themelore të UET-it.
- k. *Imazhi i mirë i UET-it në publik*. Sondazhe të organizuara nga vetë UET-i tregojnë se imazhi që ky institucion gëzon në publik është mjaft pozitiv. Ky imazh vjen si rezultat i punës cilësore në funksion të përmbushjes së misionit të UET-it.

2. Oportunitete

- a. Sondazhet tregojnë se UET-i gëzon një imazh pozitiv dhe të mirë në publik, imazh të cilin synon ta përforcojë dhe të ndërtojë mbi të, të ardhmen e tij si një ndër universitetet elitare në vend e më gjerë.
- b. Proceset integruese në të cilat është përfshirë vendi ynë, krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit të UET-it me institucione brenda rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor.
- c. Kuadri ligjor aktual, bazuar në vullnetin politik përgjithësisht pozitiv ndaj institucioneve private të arsimit të lartë, përbën një mundësi të mirë që UET-i të konsolidohet dhe zhvillohet në të ardhmen.
- d. Tendenca në rritje e besimit të publikut ndaj sektorit privat të arsimit të lartë përbën një mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të UET-it.
- e. Fryma aktuale përgjithësisht konstruktive midis institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në vend, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijes, teknologjish dhe burimesh njerëzore, por njëkohësisht ajo shërben edhe si një mundësi për reflektim e përmirësim të vazhdueshëm.
- f. Stabiliteti i politik i vendit tonë, dhe programet e veçanta të ndërmarra nga qeveritë shqiptare shtojnë mundësinë e kthimit gjithnjë e më të madh të “trurit”, duke krijuar mundësi për përzgjedhje të akademikëve dhe shkencëtarëve më të mirë dhe të atyre me perspektivë.

3. Rreziqe/Kërcënime

- a. Ndryshimet e shpeshta dhe kategorike të kuadrit ligjor që ndikojnë negativisht veprimtarinë e shkollave të larta private përbën një nga rreziqet kryesore të konsolidimit dhe jetëgjatësisë së UET-it.

- b. Domosdoshmëria për diversifikimin e burimeve të financimit dhe mosmarrja e veprimeve konkrete në këtë drejtim, mbart rrezikun e asfiksimit të UET-it si institucion i vetëfinancuar në tregun shqiptar.
- c. Mosndjekja e tregut të punës dhe e tendencës së zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, në rajon e më gjerë, dhe mosreflektimi i ndryshimeve në filozofinë, strategjinë, menaxhimin e institucionit, kurrikulat, programet e lëndëve, dhe gjithë dokumentacionin ku mbështetet veprimtaria e UET-it, rrezikon të vendosë në vështirësi rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të UET-it.
- d. Zgjerimi horizontal dhe vertikal i UET nëpërmjet programeve të reja në DNP, DND, MNP, MND dhe kërkesa për hapjen e programeve të Doktoraturës rrezikojnë cedimin e cilësisë së këtij universiteti. Këtyre sfidave ju duhet përgjigjur me konsolidimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe përballimit nga i gjithë stafi i UET i presioneve për nota dhe vlerësime të pamerituara.

4. Anë të dobëta

- a. Janë identifikuar probleme (megjithëse të shfaqura në raste sporadike) në lidhje me *kuptimin e njëjtë, dhe zbatimin e unifikuar* të procedurave, rregullave dhe standardeve të përcaktuara në dokumentet themelore të UET nga një pjesë e stafit të tij. Kjo edhe për faktin që një pjesë e konsiderueshme e këtij stafi i janë bashkuar UET-it një, ose dy vitet e fundit. Gjithsesi hartimi i Modullit Metodologjik dhe trajnimet e vazhdueshme, jo vetëm te stafit të ri, do të jenë disa nga masat që UET do të implementojë së shpejti.
- b. Pavarësisht nga synimi i vendosur, janë konstatuar vonesa në ngritjen, konsolidimin dhe funksionimin e *grup-lëndëve* në bazë departamentesh. Kjo ngelet sfidë për muajt në vijim.
- c. Ende mungon *një sistem (data base)* i unifikuar që do të lehtësonte identifikimin e plagjiaturave në rastet e esëve të përgatitura nga studentët. Kjo çështje ka ngelur ende në dorën dhe vullnetin e pedagogut të lëndës. Janë vërejtur raste kur pedagogë të veçantë nuk i kanë dhënë rëndësinë e duhur këtij verifikimi.
- d. *Përfshirja e studentëve*, veçanërisht e atyre të ciklit të dytë dhe të tretë në veprimtarinë kërkimore – shkencore të UET ende lë për të dëshiruar. Ngritja e qendrave të kërkimit dhe i grupeve të kërkimit përbëjnë një mundësi të mirë në këtë drejtim.
- e. Ende nuk është gjetur pika e duhur e takimit të *kërkimit shkencor me mësimdhënien*. Kërkimet shkencore të anëtarëve të stafit akademik të UET, pavarësisht se janë të lavdërueshme si për nga sasia edhe për nga cilësia nuk shihen gjithmonë me syrin e vënies së këtyre kërkimeve në funksion të mësimdhënies.
- f. Janë shfaqur vonesa në procesin e *informatizimit të sistemit*, gjë që do të ndihmonte mjaft informimin e studentëve dhe do të lehtësonte ngarkesën tepër të madhe (veçanërisht në periudha të caktuara të vitit) të sekretarisë mësimore dhe të koordinatoreve të fakulteteve.
- g. Pavarësisht nga puna e mirë e bërë nga UET – Press dhe punonjësit e bibliotekës UET, *pasurimi i Bibliotekës së UET* mbetet një ndër sfidat kryesore të këtij institucioni universitar. Kjo shfaqet veçanërisht në dy drejtime: (i) pasurimi me literaturë shkencore e akademike në gjuhën shqipe në përputhje me programet e lëndëve dhe (ii) shtimi i bibliografisë sidomos në mbështetje të programeve të studimit në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.

Konkluzione

Me cilësinë e anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm mund të themi se Universiteti European i Tiranës, UET, është pozicionuar midis institucioneve më serioze të arsimit të lartë të vendit e më gjerë.

Pavarësisht moshës relativisht të re, UET-i është duke ecur me hapa të shpejtë drejt konsolidimit si një institucion elitar i arsimit të lartë në vend, duke plotësuar me cilësi nevojat për dije në shërbim të shoqërisë.

Sidoqoftë, ky institucion ka nevojë të ndjekë përvojat më të mira në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të bashkëpunojë me institucione brenda dhe jashtë vendit, të bëhet më atraktiv për studiuesit e shquar në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor brenda vendit, por jo vetëm, dhe të ndjekë nga më afër të gjitha ndryshimet ekonomike, sociale e kulturore në Shqipëri e në mbarë botën. Vetëm kështu UET-i do të jetë në gjendje të garantojë gjithmonë e më shumë cilësinë e shërbimeve që ofron.

Emrat dhe Firmat e anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm

1. Tomi Treska – kryetar _____
2. Nevila Xhindi – anëtar _____
3. Elda Papa – anëtar _____
4. Dariel Sina – anëtar _____
5. Eriona Canaj – anëtar _____
6. Genti Beqiri – anëtar _____
7. Fatmir Guri – anëtar _____
8. Diana Leka – anëtar _____
9. Ermira Danaj – anëtar _____
10. Edvin Dule – anëtar _____